

ARSIM DHE PABARAZI

Sfida e perceptimit ndryshe

Valbona Nathanaili

Libra të tjerë nga Valbona Nathanaili

- Reforma dhe legjislacioni (arsimi parauniversitar). Çështje, praktika & politika. Rasti shqiptar.
- Copëza nga historiku i arsimit (në disa rrethe të vendit).
- Fizika 11 (si lëndë me zgjedhje). Për mësuesit e fizikës së klasës së 11.
- Albania Rock: Dokumenta politikë, zona europiane e arsimit të lartë. Vëll. 1.

Me parathënie nga Dr. Tomi Treska

Tiranë, dhjetor 2013



ARSIM DHE PABARAZI

Sfida e perceptimit ndryshe

Titulli i librit: **Arsim dhe pabarazi**. *Sfida e perceptimit ndryshe*

Autor: Valbona **NATHANAILI**

Foto e ballinës kryesore: © Armand Sallabanda

Art grafik: Besnik **FRASHNI**

Libri është pjesë e kolanës **“MONOGRAFI, ESSE, STUDIME”**.

© 2013 UET Press. Të gjitha të drejtat të rezervuara.

Asnjë pjesë e këtij botimi, mbrojtur nga ligji nr. 9380, dt. 28.04.2005 i Shtetit Shqiptar “Për të drejtat e autorit dhe të drejta të tjera lidhur me të”, nuk mund të riprodhohet, ruhet, transmetohet a përdoret me asnjë formë a mjet grafik, elektronik apo mekanik, përfshirë por jo kufizuar fotokopje, skanime, digjitalizim, rrjet web apo sisteme të tjerë, pa lejen me shkrim të botuesit.

Universiteti Europian i Tiranës

Shtëpia Botuese Universitare “UET Press”

Adresa: Bulevardi “Gjergj Fishta”, Nd.70, H.1, Kodi Postar 1023, Tiranë, Shqipëri.

uetpress@uet.edu.al

www.uet.edu.al/uetpress

Botimet UET Press certifikohen pranë Zyrës Shqiptare

për Mbrojtjen e të Drejtave të Autorit.

International Standard Book Number (ISBN) 978-9928-4193-3-0

Libri është kataloguar në datën e publikimit pranë Bibliotekës

Kombëtare të Shqipërisë dhe Bibliotekës së Universitetit Europian të Tiranës.

Ivës dhe Junës

Për ju, edhe një mijë herë të tjera, çdo ditë

“Gjuetari i balonave”, Khaled Hosseini



Shtëpia Botuese Universitare
“UET Press” është pjesë e
Universitetit Europian të Tiranës.

Tiranë, dhjetor 2013

PARATHËNIE

Dr. Tomi Treska

Kur merr në dorë një krijim të një autoreje si Valbona Nathanaili, natyrshëm të pushton ndjesia për t'i shkuar librit deri në fund. Ndoshta kjo ndodh sepse kushdo që e njeh Valbonën e di se ajo prej kohësh është njeri i librit, i çdo lloj libri, por veçanërisht i librit “racional” dhe “analitik”. Dhe një njeri i tillë mendohet mirë kur merr në dorë penën për të shkruar diçka të vetën.

Dhe besimi se Valbona do kishte bërë diçka të pjekur e të menduar, diçka që i duhej jo thjesht tregut, por publikut dhe ekspertëve të fushës, më konfirmoi atë që prisja.

Botimi “Arsim dhe pabarazi. *Sfida e perceptimit ndryshe*”, një përmbledhje e eseve, ideve dhe debateve që ngre Nathanaili ngërthen tematika sa interesante, aq edhe bashkëkohore, sa të dobishme, aq edhe praktike, sa të

njohura po aq ende të pazgjidhura. Botimi ndahet në tre pjesë, që përbëjnë edhe tre shtyllat përmbajtësore të tij.

Pjesa e parë, që i ka dhënë edhe titullin kësaj përmbledhjeje ka të bëjë kryesisht me problematika të mprehta të arsimit dhe sistemit arsimor në Shqipëri. Për lexuesin është lehtësisht i rrokshëm mendimi liberal i autores, mendim që zë fill, mbështetet dhe shumëfishohet në modelet, shkrimet, studimet dhe ekspertët më të spikatur të kohës. Mendimi kritik, fryma adaptuese në kushtet e vendit tonë dhe empatia, janë disa nga mesazhet kryesore që përcillen në shkrimet e kësaj pjese. Këto mesazhe, të trajtuara në frymën e të qenit “qytetar i botës”, i shtojnë vlerat 10 shkrimeve që ndryhen në këtë pjesë. Autorja nuk qëndron indiferente në debatin tashmë të njohur mes privates dhe publike. Qëndrimi i saj ndaj kësaj çështjeje ngrihet mbi interpretimet e zakonshme të avantazheve të njërit apo tjetrit sistem të financimit. Ajo ngre probleme që i takojnë sistemit arsimor shqiptar në tërësi, pavarësisht nëse ai financohet nga fondet publike, ose ato private. Autorja konstaton, analizon e kritikon, por jo vetëm kaq; ajo shkon përtej kësaj: rekomandon, madje deri në nivelet e politikëbërjes për thellimin e reformimit të sistemit arsimor në Shqipëri dhe për Ligjin “Për sistemin arsimor parauniversitar”. Mendimi i saj, jo thjesht si analiste, por në radhë të parë si eksperte dhe njohëse e mirë e fushës për të cilën flet, është i qartë dhe i argumentuar. Diskutimi i saj merr dimension më të gjerë kur në analizë përfshin edhe shoqërinë civile dhe rolin që ajo duhet të luajë në reformimin e sistemit arsimor shqiptar. Valbona rrit vlerat e punimit të saj kur analizon edhe problematika që duken më periferike se ato që na shqetësojnë të gjithëve. Ajo i

kushtohet edhe arsimit special në Shqipëri, apo edhe procesit të vlerësimit të shkollës si institucion jo thjesht njohuri-dhënës, por edhe edukues e formues të qytetarit të sotëm dhe atij të të ardhmes.

Pjesa e dytë e botimit, pavarësisht se ndryshon në tematikë, është po aq e rëndësishme dhe atraktive sa e para. Valbona në këtë pjesë tenton kah politika dhe analiza e situatave politike në Shqipëri dhe problemeve që lidhen me sociologjinë. Realizmi dhe objektiviteti i saj spikat në shkrimin “Kuç e blu”, ose edhe në atë vijues “Me këmbë të mbarë”. Nga një analizë politike për këto artikuj, mbresëlënës është koncepti i shndërrimit të demokracisë nga një term në funksion ose konkluzioni se asimetria e pushtetit e bën (atë, pushtetin) edhe detyrim asimetrik. Refleksioni i saj rreth librit “Pasojat e modernitetit” të sociologut të shquar Athony Giddens, ngrihet në lartësinë e vlerave të këtij libri. I të njëjtit nivel është edhe refleksioni rreth librit “Si qytetar global paqedashës. Dashuri, paqe botërore” e Reverendit Sun Myung Moon.

Pjesa e tretë e kësaj përmbledhjeje, e titulluar “Sale, Zuccherò e caffè!” përbëhet nga 8 shkrime. Disa nga shkrimet më të spikatura në këtë pjesë lidhen me personalitete dhe analiza të ideve dhe mesazheve që ata përcjellin në publikun e gjerë. Valbona bëhet një përcjellëse analitike e kritike e tyre, duke rritur në vetvete vlerën e mesazheve që përcjellin autorët. E fillon me Kadarenë duke analizuar tezat e tij në lidhje me Shqipërinë, Kosovën e gjuhën shqipe. E vijon analizën e saj me Spartak Ngjelen duke vënë në fokus librin e tij “Përkulja dhe rënia e tiranisë shqiptare”. Përkufizimi i saj se Ngjela është nxënës e mësues, lider dhe pjesë e turmës, të mbetet gjatë në kujtesë.

Dhe është e kujdesshme të kujtojë me nderim edhe figura të dalluara të mendimit shqiptar si ajo e Prof. Dr. Enver Faja, të cilit i kushton një “In Memoriam”, duke lartësuar punën dhe veprën e këtij urbanisti të shquar nëpërmjet promovimit të librit të tij “Urbanistika”.

Gjithsesi pjesa e tretë është pak më e lirshme, për nga tematika, krahasuar me dy pjesët e para. Brenda kësaj të trete futen, si “padashje”, impresione që tejkalojnë të qenit thjesht impresone, duke marrë më së shumti pamjen e refleksionit dhe të analizave të mirëfillta. Të kësaj natyre janë shkrimi për kryqëzimin tek “21 Dhjetori”, për Jesolon turistike pranë Venecias, apo “Dita e zakonshme e një shkolle publike”, sikundër reagimi-thirrje “Faleminderit djema”.

Jam i mendimit se mozaiku i menduar mirë i kësaj përmbledhjeje, krijon ndjesinë e një *puzzle*, brenda të cilit gjen mini-tematika, ndoshta disi të ndryshme për nga fabulat që trajtojnë, por që padyshim përcjellin një stil të veçantë shkrimi, analize dhe refleksioni, sa të unifikuar, aq edhe divers, sa të pasur në gjuhën e përdorur, po aq intrigues e të veçantë.

PËRMBAJTJA

1 ARSIM DHE PABARAZI

- 3 Emergjenca për arsim liberal në ditët e sotme
- 19 Arsime dhe pabarazi
- 23 Në vorbullën e privates dhe publike
- 29 Roli i ndryshuar i universiteteve shqiptare
- 35 Shkollimi në erën globale
- 43 Shkollat e shekullit XXI. Faktorë që ndikojnë në formatimin e politikave arsimore
- 55 Mendime për Projektligjin e ri “Për sistemin arsimor parauniversitar”
- 67 Sfidat të shoqërisë civile
- 71 Historiku i arsimit special në Shqipëri
- 77 Bashkëmatësia e sistemeve shkollore

81 SI TË NDRYSHOJMË PERCEPTIMET

- 83 Me këmbë të mbarë thotë populli
- 87 Si të ndryshojmë perceptimet
- 91 Kuq e blu
- 95 Hapësirë-koha në modernitetin giddensian
- 99 Uniforma shkollore, zgjedhje apo zgjidhje
- 103 Përtej horizontit

107 SALE, ZUCCHERO E CAFFÉ!

- 109 I penguari ...
- 115 Ish -“21 dhjetori”, përtej nostalgjisë
- 121 Jesolo. Aty ku turizmi është shndërruar në art
- 131 Ngjela dhe refleksionet e tij për “Parkun njerëzor shqiptar, 1991-1996”
- 137 Post panair: Sale, zucchero e caffè!
- 143 Dita e zakonshme e një shkolle publike
- 147 In memoriam Prof. dr. Enver Faja
- 151 Faleminderit djema
- 153 Arsimi në qeverisjen e dytë të Ahmet Zogut

ARSIM DHE PABARAZI

Emergjenca për arsim liberal në ditët e sotme

.....

Arsim dhe pabarazi

.....

Në vorbullën e privates dhe publikes

.....

Roli i ndryshuar i universiteteve shqiptare

.....

Shkollimi në erën globale

.....

*Shkollat e shekullit XXI. Faktorë që
ndikojnë në formatimin e politikave arsimore*

.....

*Mendime për Projektligjin e ri
“Për sistemin arsimor parauniversitar”*

.....

Sfida të shoqërisë civile

.....

Historiku i arsimit special në Shqipëri

.....

Bashkëmatësia e sistemeve shkollore

.....

EMERGJENCA PËR ARSIM LIBERAL NË DITËT E SOTME

Çfarë do të thotë të jesh njeri i arsimuar në shekullin e sotëm? Për shumë njerëz do të thotë të kesh një ose disa adresa e-mail, të përdorësh rrjete të ndryshme sociale apo të dish të kërkosh dokumenta me motorët e ndryshëm të kërkimit që ofron *world wide web*. Por ndërkohë që aftësitë që duhen për të bërë kërkime në rrjet mund të mësohen në pak orë, të vlerësosh rezultatet e kërkimit, të zgjedhësh ndërmjet mijëra dokumentave që të ofrohen atë që është e saktë dhe që duhet marrë në konsideratë, të ndash një referencë serioze nga një jo e tillë dhe ta përdorësh si burim për pasurim të mëtejshëm, të duhet një edukim i mirë që përftohet vetëm si rrjedhojë e viteve të tëra shkollim. Vetëm një njeri i pajisur me dijet e duhura është në gjendje të përpunojë më tej informacionin e marrë dhe ta përdorë për të ndërtuar dije të re.

Nga ana tjetër, duhet të pranojmë se dija ndryshon me ritme aq të shpejta dhe të pakontrolluara, sa ideja e edukimit me një dije që e përfshin të gjithën duket e pabazuar. Për më tepër, depërtimi i teknologjisë në çdo nivel e aspekt të jetës kërkon që në shkolla t'i kushtohet vëmendja e veçantë

jo vetëm përfshirjes së kësaj teknologjie, por edhe aftësimin në përdorimin e saj pasi është shndërruar në një mjet të domosdoshëm pune.

Edukimi liberal

Gjatë viteve të shkollës detyra e nxënësit është të përftojë dije nëpërmjet të cilave të jetë në gjendje të kuptojë se si funksionon kjo botë. Në një këndvështrim të gjerë, edukimi liberal synon të përdorë dijet për të ndërtuar aktivitetet kryesore në shkolla, jo vetëm për të përfshirë atë që të tjerët tashmë e dinë, por edhe për të zgjeruar kufijtë e asaj që dihet.

Aristoteli besonte se një edukim i mirë mund të arrihet nëpërmjet arsimimit liberal, ku dija vlerësohet për atë që është dhe jo për atë që të shpërblen. Një arsim liberal fokusohet në studimin e parimeve dhe të ideve themelore të njerëzimit. Promovimi i një arsimimi të tillë nga Aristoteli bëhej në funksion të formimit qytetar. Lëndët që duhet të mësohen janë artet dhe letërsia; në të kundërt, lëndë të tilla si tregtia e ato që lidhen me profesionet direkte absorbojnë dhe degradojnë mendjen dhe janë të përshtatshme vetëm për skllëvërit e njerëzit që punojnë për bukën e gojës. Shkollat fillore në Angli dhe gjimnazet në Gjermani janë strukturuar në përgjigje të këtij arsimi, karakteristikat kryesore të të cilit janë:

- Edukimi vlerësohet sepse duhet, jo sepse është i dobishëm
- Kurrikula duhet të ndërtohet në mënyrë të tillë që të nxisë zhvillimin e plotë intelektual dhe moral të nxënësit

- Disa lëndë janë më të vlefshme se të tjerat, sikundër janë artet e shkencat humane
- Mësimdhënia është një aktivitet human kompleks që kërkon karakteristika personale të caktuara
- Edukimi liberal u siguron nxënësve mundësinë të njihen me shumë disiplina e mënyra të menduari
- Në klasa inkurajohen debati e diskutimet e gjalla

Shkëputja nga arsimi liberal në ditët e sotme¹

Ne jetojmë në një botë që udhëhiqet nga motive përfitimi. Motivi i përfitimit u sugjeron politikanëve të shqetësohen më shumë për shkencën dhe teknologjinë, me pretendimin se janë të një rëndësie të veçantë për shëndetin e ardhshëm të kombeve të tyre. Të kuptuarit shkencor ka një rol të padiskutueshëm në zhvillimin qytetar të nxënësit dhe e njëjta gjë vlen edhe për mësimin e bazave të ekonomisë. Të gjithë e pranojmë se një edukim i mirë shkencor dhe teknik është i dobishëm për të ardhmen e një vendi dhe përpjekjet në funksion të përmirësimit të tij nuk duhet të rreshtin asnjëherë. Çështja nuk është vetëm të mësojmë përmbajtjen e shkencës, duke memorizuar tekstin e zgjidhur ushtrime, por ta mësojmë dijen me baza, ta kuptojmë e të shërbejë si përvojë për të prodhuar dije të reja.

Por përpos tyre dhe po aq të rëndësishme për shëndetin e demokracisë dhe krijimin e një kulture botërore për së mbari janë edhe aftësi të tjera, të cilat me shumë gjasa mund të humbasin në honin e konkurrencës me dy të parat, shkencën e teknikën. Bëhet fjalë për aftësi që fitohen gjatë

¹ *Shënim:* Trajtimi i temës mbështetet kryesisht në esenë e Martha Nussbaum (Siegel H., 2009. "The Oxford Handbook of Philosophy of Education": Oxford University Press, f. 52-64).

zhvillimit të shkencave humane e arteve, sikundër janë:

1. Aftësia për të menduar në mënyrë kritike;
2. Aftësia për të transhenduuar frymën lokale dhe për t'i trajtuar problemet botërore si “qytetar i botës”;
3. Aftësia për të parë me simpati gjendjen e vështirë të një personi tjetër.

Fillimisht është e rëndësishme të theksojmë se këto tri aftësi duhet të fillojnë të kultivohen që në sistemin arsimor parauniversitar. Në universitet, sado të flitet e punohet, nuk mund të arrijmë shumë nëse nuk kemi filluar kohë më parë.

Argumenti më tej do të trajtohet duke u bazuar, kryesisht, në idetë e Martha Nussbaum dhe në analizën që i bën praktikës mësimore dhe veprës së dy prej figurave më të shquara në zhvillimin e trajtimin e këtyre aftësive: Rabindranath Tagore dhe John Dewey, si dhe në veprën e Amartya Sen “Zhvillimi si liri”, AU Press 2011 dhe “The idea of Justice”, Harvard University Press 2009.

Rabindranath Tagore dhe John Dewey karakterizohen nga një indinjatë e thellë ndaj mësimin tradicional, mësim që nuk është në gjendje, sipas tyre, të frymëzojë e kultivojë simpati për tjetrin, të nxisë të menduarin kritik ose të dalë jashtë vijave të bardha që diktojnë metodat e një pedagogjie strikte.

Të menduarit kritik

Demokracia ka nevojë më shumë për njerëz që janë në gjendje të mendojnë ‘me kokën e tyre’, se sa për njerëz të gatshëm t'i nënshtrohen çdo lloj autoriteti; më shumë për

njerëz në gjendje të arsyetojnë së bashku rreth zgjidhjeve të mundshme, se sa për njerëz që vetëm pretendojnë e kërkojnë.

Te Tagore është e dukshme një dashuri e fortë për të menduarin në mënyrë të pavarur, por nuk e sheh si një parakusht për demokracinë. Sipas tij, ne përpiqemi thjesht t'i disiplinojmë fëmijët, duke mos marrë parasysh pothuaj fare individualitetin e tyre, një ndërmarrje e ngritur për të dhënë rezultate uniforme.² Për të shmangur këtë, është e rëndësishme të ushqejmë te fëmijët pavarësinë e mendjes dhe t'i inkurajojmë të bëjnë pyetje. Tagore u angazhua shumë veçanërisht në edukimin e femrës. Në një leksion mbajtur më 1936 ai u bën apel femrave “të hapin zemrën, të kultivojnë intelektin e të ndjekin me vendosmëri rrugën e dijes, duke pasur në vëmendje që e kundërta e kreativitetit është konservatorizmi i verbër”.³ Sen (2011)⁴ i referohet Tagore kur kërkon të theksojë se “Nacionalizmi dhe shovinizmi kulturor mund të jenë qasje seriozisht të dëmshme për të jetuar”:

Çfarëdo të kuptojmë dhe gëzojmë nga produktet njerëzore, në moment bëhet jona, kudo që ta kenë origjinën e tyre. Unë jam krenar për humanizmin tim kur më jepet mundësia të njoh personalisht poetë dhe artistë nga vende të tjera. Lermëni të shijoj këtë kënaqësi të paparë, se gjithë lavdia e njerëzimit është e imja.⁵

² “My school” in *Personality* (cituar: Amiya Chakravarty, 1961. “A Tagore reader”, Beacon Press, Boston: f. 218-24).

³ “Nari” (“Women”), extract translated in Sumit Sarkar, “Ghare Baire in its Times,” in *Rabindranath Tagore's The Home and the World: A Critical Companion*, ed. P. K. Datta (New Delhi: Permanent Black, 2003), pp. 143-73, at. 168.

⁴ Sen, A., 2011. “Zhvillimi si liri”, Albanian University Press: Tiranë, f. 268.

⁵ *Ibid*, f. 268 (cituar: Rabindranath Tagore “*Letters to a friend*”. London: Allen & Unwin, 1928).

Nga ana tjetër, Dewey e lidh, në mënyrë krejtësisht të qartë, rëndësinë e të menduarit kritik me demokracinë. Demokracia, thekson ai, “është më shumë se formë qeverisjeje; demokracia është, në radhë të parë, mënyrë shoqërizimi të të jetuarit dhe të ndarjes së përvojave të përbashkëta të komunikimit.”⁶

Një shoqëri që përpiqet të tejkalojë barrierat tradicionale të racës, klasës dhe pasurisë duhet “të shohë nëse anëtarët e saj janë edukuar për të marrë iniciativa personale dhe nëse kanë aftësinë për t’u përshtatur”.⁷ Për Dewey, kritika ndaj zakoneve është thembra e demokracisë. Që në kohërat më të lashta ky ka qenë çelësi i formimit të qytetarëve.⁸ Në Athinën e lashtë, ku njerëzit ishin skllevër të zakonit dhe të menduarit në mënyrë tradicionale, ata nxiteshin të mendonin në mënyrë sokratike, të përqendroheshin te argumenti në mënyrë racionale, të shihnin sa e papërshtatshme ishte tradita e ngurtë për një jetë demokratike.

Aftësia për të transhenduuar frymën lokale dhe për t’i trajtuar problemet botërore si “qytetar i botës”

Ne duhet t’i edukojmë të rinjtë ta shohin veten e tyre si anëtarë të një kombi dhe bote heterogjene, të kuptojnë historinë dhe grupet e ndryshme që jetojnë në të. Ndonëse për Dewey kjo nuk është në qendër të vëmendjes, përsëri është për t’u admiruar këmbëngulja e tij që edukimi duhet të prodhojë qytetarë fleksibël, në gjendje të përshtasin

⁶ Dewey, J. “*Democracy and education*” Chicago: University of Chicago Press, 1903, f. 83.

⁷ *Ibid*, f. 84

⁸ *Ibid*, f. 84. Shih edhe f. 251-52, 264-65.

mendimet e tyre me situatat aktuale në të cilat gjenden. Duke e krahasuar me Tagore, mund të themi se shkolla tagorane ishte më e fokusuar në këtë ide kozmopolitane. Për shembull, në shkollë jo vetëm që nxënësit mësonin rreth të gjitha besimeve kryesore, por edhe respektonin çdo festë të tyre.* Fillimisht nxënësit mësonin traditën, gjuhën e kulturën bengaleze dhe, më tej, e zgjeronin horizontin duke mësuar për botën në tërësi. Sot, për shkak të natyrës së ndarvarësisë që ka globalizmi dhe faktit që shumë nga ndërveprimet tona si qytetarë globalë ndërmjetësohen nga norma të diktuar nga një treg shkëmbimi, më shumë se kurrë kemi nevojë për këtë aftësi. Sipas Martha Nussbaum⁹ nxënësit duhet të mësojnë rudimentet e historisë botërore pasi i pasurojnë akoma më shumë, i ndihmojnë të kenë një të kuptuar që shkon përtej stereotipeve të së përditshmes, veçanërisht sa i takon besimeve kryesore. Ata duhet të studiojnë me thellësi të paktën një traditë jofamiljare, sepse aftësohen të fitojnë shprehje që u hyjnë në punë më vonë.

Shkëmbimi i programeve të studimit me shkolla të vendeve të tjera, veçanërisht kur u përkasin kulturave krejtësisht të ndryshme, është një ide e mirë pasi të ndihmon ta shohësh botën nga një këndvështrim tjetër, ta pranosh e përpunosh dijen e re në një frymë më empatike.

Në nivel lokal, në shkollë, nxënës e studentë duhet të njohin e studiojnë traditat kryesore të grupeve që janë pjesë e kombit të tyre, në maxhorancë a minorancë qofshin, të analizojnë se si diferencat në fe, racë e gjini janë bërë gjithmonë burim për diferenca në mundësi për të jetuar. Në ilustrim të kësaj ideje është dukuria e

* *Shënim*: E njëjta praktikë ndiqet edhe në vendin tonë.

⁹ Siegel H., 2009. “*The Oxford Handbook of Philosophy of Education*”: Oxford University Press, f. 57.

tmerrshme e vdekshmërisë së lartë femërore (fetuseve dhe bebeve femra) në shumë pjesë të botës, që për Amartya Sen (2011, Tiranë) është një “aspekt vulgar dhe i mprehtë i pabarazisë gjinore”.¹⁰

Akoma, grupet në klasa dhe në shkolla formohen kryesisht sipas përkatësive etnike ose identiteve përkatëse. Na duhet të edukojmë nxënës që njohin jetën e njerëzve të tjerë të ndryshëm nga ta, që janë në gjendje të dialogojnë me interes dhe dashuri për të ardhmen e njerëzimit

Amartya Sen në librin e tij “The idea of justice” (Harvard Press, 2009), shprehet se demokracia duhet të merret si me ligjet e maxhorancës, ashtu edhe me të drejtat e minoriteteve, edhe pse shpesh gjykohet krejtësisht vetëm në termat e votimeve. Në një kuptim më të gjerë, demokracia duhet të shihet si arsyetim publik që shkon përtej të drejtës së votës dhe mekanizmit të saj, pasi vetëm në këtë mënyrë mund të krijojë hapësirën e duhur për minoritetet dhe të drejtat e tyre. Sen është kundër idesë marksiste që ‘pakica mund të sakrifikohet për shumicën’. Një maxhorancë e pamëshirshme, të cilën nuk e bren ndërgjegjja për eliminimin e të drejtave të minoriteteve, ka tendencën ta ballafaqojë shoqërinë me zgjedhje të vështira. Formimi i një mënyre tolerante të sjelli është thelbësore në lëmin e funksionimit të sistemit demokratik.

Aftësia për të parë me simpati gjendjen e vështirë të një personi tjetër

Një aftësi e tillë do të thotë të jesh në gjendje të vendosësh veten në vend të tjetrit, të dëgjosh me vëmendje e lexosh

¹⁰ Sen, A., 2011. “*Zhvillimi si liri*”, Albanian University Press: Tiranë, f. 113-4.

me inteligjencë historinë e tij, të kuptosh emocionet e dëshirat që ka ose ëndërron. Kultivimin e simpatisë e gjejmë edhe në tragjeditë e grekëve të lashtë, që do të thotë se edhe në demokracinë e asaj kohe nixtej kjo aftësi. Sot, ajo është pjesë përbërëse e teorisë progresiviste të Dewey. Por jo vetëm. Edhe Tagore i kushton një rëndësi po aq të madhe. Për Dewey artet janë një mënyrë e mirë për të perceptuar në mënyrë inteligjente dhe përjetuar përvoja të pakrahasueshme. Ato luajnë një rol vendimtar në formimin qytetar. Dewey ngre zërin kundër atij lloj arsimit ku arritjet janë gjithshka. Sipas tij, arritjet duhen për të treguar vetëm ato gjëra që një makinë e mirë-planifikuar mund të bëjë më mirë se një qenie njerëzore. Në mënyrë të ngjashme në Indi, Tagore shkruan: Ne mund të bëhemi të fuqishëm nëpërmjet dijes, por formësohemi tërësisht nëpërmjet simpatisë ... Ndërkohë, janë jo të pakta rastet kur edukimi i simpatisë në shkolla jo vetëm injorohet sistematikisht, por edhe ndrydhet tërësisht. Si Tagore, edhe Dewey, theksojnë që kultivimi i simpatisë është një nga elementet kryesore në formimin qytetar. Në shkolla ne duhet të përpiqemi ta bëjmë sa më shpesh dhe në mënyrë sa më të sofistikuar.

Mësimi i arteve dhe i letërsisë mund të kontribuojë në shumë mënyra në kultivimin e simpatisë. Për shembull, në të gjitha shoqëritë dhe në të gjitha kohërat kanë ekzistuar gjithmonë grupe të lëna mënjanë, të stigmatizuara ose në pozita inferiore ndaj të tjerëve. Një ndihmesë në këtë drejtim jep edhe sfondi social ose paragjykimet që kemi, të cilat me ose padashje ndikojnë mënyrën tonë të të arsyetuarit rreth përkatësisë në grup, pavarësisht nëse jetojmë në qytet a në fshat, jemi të rinj a të vjetër. Gjykimi ynë për një grup të caktuar influencohet shumë nga faktorët e mësipërm. Ajo

që perceptojmë varet nga pozicioni ku jemi dhe nga ajo që shpresojmë ose jemi të bindur se do të shohim. Kështu sa i takon edhe grupit rom, identifikuar gjithmonë si një grup që nuk pëlqen edukimin e rregullat, i paqëndrueshëm dhe me vese të shumta. Në varietenë humoristike “Portokalli”, aktori Florian Binaj që luan rolin e Skrapit, përpiqet të evitojë këtë kulturë të përgjithshme negative që shoqërizon aftësinë për të ditur e komunikuar të këtij komuniteti. Duke na vënë në lëvizje imagjinatën, përmes lojës së tij, Binaj na mundëson të njohim përvojat aspak të këndshme të grupit rom, të cilat në jetën e përditshme ose i anashkalojmë, ose i marrim si të mirëqena. Personazhi i Skrapit është i ditur dhe i mençur, i komunikueshëm dhe i gatshëm të ndihmojë e mbajë familjen e tij. Pra, arti vë në lëvizje të menduarin ndryshe, nga këndvështrime të tjera, na ndihmon të kuptojmë sa e vështirë dhe diskriminuese është jeta e personave që u përkasin këtyre grupeve.

Artet janë një mënyrë shumë e mirë për të nxitur edhe lirinë e ndjenjën e komunitetit. Kur njerëzit luajnë së bashku, ata mësojnë të shkojnë përtej traditës dhe autoritetit, mësojnë të shprehen më mirë dhe të shoqërizohen me njëri-tjetrin. Lloji i komunitetit që krijohet gjatë aktiviteteve të tilla nuk është hierarkik, një karakteristikë që e bën një demokraci të mirë dhe gjen vend në proceset politike që e shoqërizojnë atë.

Së fundmi, artet janë një burim i mirë gëzimi jo vetëm për fëmijët, por edhe për të rriturit. Pjesëmarrja në lojë, këngë e vallzim i mbush fëmijët me gëzim dhe këtë gëzim ata e pasqyrojnë edhe në pjesën tjetër të ditës shkollore. Fëmijëve nuk u pëlqen të qëndrojnë ulur gjithë ditën. Nga ana tjetër, shprehja nëpërmjet këtyre aktiviteteve kreative i

jep hapësirë dëshirës së tyre për të qenë të lirë. Tagore veçon aktivitetin e kërcimit dhe e vlerëson si të domosdoshëm për vajzat, të cilat në natyrën e tyre shpesh herë janë të ndrojtura dhe e kanë të vështirë të shprehen.

Për Tagore, arti është po aq i rëndësishëm edhe për spektatorin, sepse gjeneron kënaqësi, i bën spektatorët të përjetojnë akte subversioni ose kritika kulturore pa frikë dhe pa masa vetëmbrojtëse, edhe kur dialogët që zhvillohen janë të mbushur me paragjykime të së shkuarës. Kujtoni komedinë “Diktatori” (2012) dhe batutën e Sacha Baron Cohen (njëri nga skenaristët dhe aktori kryesor), kur e dashura i thotë jam shtatzënë, përgjigjet: Çfarë do lindësh, djalë apo do abortosh?

Zbavitja nëpërmjet artit ofron shpresë e perceptime më të mira për jetën. Sigurisht, për demokracinë nuk është e rëndësishme vetëm argëtimi, por mënyra se si performanca ofron një hapësirë për eksplorimin e çështjeve të vështira pa u zhytur në ankth, është një vlerë e shtuar e këtij aktiviteti.

Edukimi demokratik në ditët tona

Për Nussbaum edukimi me aftësi qytetarie në ditët e sotme, në përgjithësi, në shumë shkolla, kolegje e universitete të botës lë shumë për të dëshiruar. Shkaqet mund të jenë të shumta, por po rendisim disa prej tyre. Edukimi liberal ka kosto të lartë financiare dhe pedagogjike pasi kërkon klasa të vogla, ku nxënës e mësues, gjatë gjithë kohës, japin e marrin mendime e bëjnë vlerësime, kërkon njerëz të përgatitur dhe të aftë të referojnë edhe në disiplina shumë të ngushta. Sipas Nussbaum, në

përgjithësi universitetet nuk janë të gatshëm të zgjerojnë kurrikulat e tyre me lëndë të kësaj natyre; ngurrojnë të fusin disiplina të reja që luajnë një rol të rëndësishëm në edukimin qytetar, si për shembull studime për gruan, fenë, islamizmin ose judaizmin dhe, edhe kur ofrohen, ndiqen kryesisht vetëm nga studentë që, ose dinë diçka për to, ose thjesht duan t'i fokusojnë studimet e tyre në këto disiplina. Pra, këto lëndë nuk kanë një vend të sigurt në strukturën kurrikulare. Në sistemin e edukimit liberal, përkundrazi, këto disiplina mund të ofrohen për të gjithë studentët e ciklit të parë të studimeve. Universitetet vërtet kanë merita të mëdha në edukimin e studentëve, por po aq të mëdha i kanë edhe problemet.

Nga ana tjetër, edhe në sistemin parauniversitar, aftësitë për qytetari në periudhën më të rëndësishme të jetës së fëmijëve janë shumë të varfëra. Kërkesat e tregut global kërkojnë nga të gjithë të fokusohen në aftësi teknike e shkencore, si aftësi kryesore, ndërkohë që aftësitë e tjera, ato që merren në shkenca humane e arte po trajtohen gjithmonë e më shumë si të padobishme dhe gjykohen që nuk ndihmojnë kombin të jetë kompetitiv në tregun global. Por edhe ato vende që i kanë në fokus lëndë të tilla, përsëri i kanë standardizuar aq shumë, sa që aftësitë për të imagjinuar dhe menduar në mënyrë kritike që gjenden në thelb të tyre, janë minimizuar jashtëzakonisht. Kohë më parë Dewey këmbëngulte për zbatimin e motos 'mësojmë duke bërë' dhe që 'arti duhet të jetë natyra e dytë e çdo shkolle fillore në ShBA'; sot jo vetëm që Shkolla Laborator e themeluar nga Dewey po devijon përditë e më shumë nga parimet e themeluesit të saj, por edhe vetë parimet po reduktohen në tekste dhe teste me shumë zgjedhje.

"Trainimi i papagallit" Rabindranath Tagore

Na ishte një herë një Raja që kishte një papagall që e donte shumë. Ai donte ta edukonte sa më mirë papagallin e tij, pasi të mos shkosh në shkollë është gjë e keqe. Gjëja e parë që i duhej për edukimin e papagallit ishte t'i siguronte një ndërtesë ku do të arsimohej. Kështu Raja ndërtoi një kafaz të mrekullueshëm prej ari. Gjëja tjetër që i nevojitej ishte sigurimi i teksteve të mira shkollore. Për këtë, thirri ekspertët më të mirë për këtë punë. Sipas ekspertëve, tekstet nuk janë kurrë tepër për synimin tonë. Ekspertët punuan ditë e natë dhe ja arritën qëllimit. Pastaj u punësuan mësuesit. Meqënëse mësuesit paguheshin mirë, me lekët që merrnin nga puna ndërtuan shtëpi për vete. Kur Raja vizitoi shkollën, mësuesit i treguan metodat që përdornin për mësimin e tij. Metodot ishin kaq të mira, sa vetë papagalli dukej krejtësisht i parëndësishëm përpara tyre. Raja dukej shumë i kënaqur që çdo gjë dukej perfekt – asnjë e metë. Sa i takon papagallit nuk kishte pse të qajej – nuk i mungonte asgjë. E kishte gurmazin të mbushur kaq shumë me gjethet e librave sa as nuk cicërrinte e as pëshpëriste dot.

Mësimet vazhdonin. Një ditë papagalli vdiq, por asnjë nuk kishte idenë më të vogël se kur kishte ndodhur kjo: sot, dje, apo para sa kohësh? Nipi i Rajës që ishte në krye të Ministrisë së Arsimit, mori përsipër të raportonte te Raja.

Zotëri, arsimimi i papagallit përfundoi.

Raja, kurioz, pyeti: Kërceu ndonjëherë?

Kurrë, ju përgjigj nipi

Po për të fluturuar, fluturoi ndonjëherë?

Jo, pasoi pothuaj e njëjta përgjigje.

Më sillni papagallin – ishte kërkesa tjetër e Rajës.

Sollën papagallin, i cili iu nënshtrua vështirime të rrepta të të gjithë të pranishmëve. Raja preku me gisht trupin e tij. Vetëm gjethet e librave lëshuan një shushurimë të dobët.

Jashtë dritares, fëshfërima e një ere të lehtë pranvere ndërmjet gjetheve të reja të asokas e bënin prillin edhe më të trishtë.

Komenti kryesor që mund t'i bëhet kësaj historie është se kur flasim për arsimin tentojmë të merremi me gjëra të mëdha dhe fokusohemi shumë pak në gjërat e 'vogla', sikundër janë fëmijët, kurioziteti e dëshira e të cilëve për të mësuar mund të shërbejë si një bërthamë e mrekullueshme rreth së cilës të vërtetësim gjithë punën tonë pedagogjike. Sipas Tagore, fëmijët janë më të shkathët se të rriturit pasi nuk rëndohen nga pesha e zakoneve të vjetra. Detyra e arsimit është të mbajë gjallë këtë kuriozitet, në respekt të lirisë e individualitetit të fëmijëve. Në shumicën e shkollave ne kërkojmë të imponohemi me dije e informacion, shpesh në mënyrë vertikale e hierarkike, nga mësuesi te nxënësi. Një karakteristikë tjetër që ndiqet në orën e mësimit është kërkesa për memorizimin e fakteve, teorive e informacioneve të ndryshme, veçanërisht në shkencat politike, histori e gjeografi. Pa nënvlerësuar rolin që ka ky lloj të mësuar, është e rëndësishme të theksojmë se edukimi fillon me mendjen e fëmijës. Synimi ynë duhet të jetë rritja e lirisë së mendimit në përputhje me mjedisin social pjesë e të cilit është. Artet dhe letërsia janë mënyra shumë të mira për të stimuluar kritikën ndaj atyre zakoneve e traditave që na mbajnë larg ndryshimit, që frenojnë iniciativën për të ecur përpara. Këto përpjekje duhet të fillojnë në moshë sa më të njomë.

Sot konstatojmë se një pjesë e mirë e trashëgimisë së

Tagore dhe Dewey po lihet mënjanë, për t'u zëvendësuar me atë lloj edukimi që është në funksion të suksesit ekonomik. Më tej, fëmijët ngarkohen me detyra shtëpie, që do të thotë se pesha e dëshira për sukses mbarten edhe në shtëpi, duke e zvogëluar akoma më shumë hapësirën për liri dhe vlarë çdo imagjinatë.

Çfarë do të bëjmë nëse këto trende do të vazhdojnë? Përditë e më shumë po hasim njerëz të trajnuar më së miri teknikisht, por që nuk dinë të kritikojnë autoritetin, njerëz me aftësi të mira tregu e shkëmbimi, por që nuk kanë imagjinatë.

Për Nussbaum, çdo njeri i përgjegjshëm, çdo intelektual, çdo qytetar që është i interesuar për lulëzimin e demokracisë, e ka për detyrë të flasë me zë të lartë, të përfshihet në përpjekjet e përbashkëta për të bërë diferencë.

Për Amartya Sen, në kontekstin e vendeve në zhvillim, nevoja për iniciativa në politikat publike për krijimin e mundësive sociale është shumë e rëndësishme. Aksionet publike që lidhen me arsimimin e kujdesin shëndetësor ndikojnë direkt në rritjen e popullsisë së gatshme për të marrë pjesë direkt në procesin e zgjerimit ekonomik. Për të, suksesi që po përjetojnë ekonomitë e Azisë Lindore (duke filluar me Japoninë disa dekada më parë) lidhen me rëndësinë që i kushtuan masivizimit të arsimit dhe, pak më vonë, edhe kujdesit shëndetësor. Zhvillimi njerëzor është aleati kryesor për të varfërit. Mundësitë sociale kontribuojnë direkt në zgjerimin e aftësive njerëzore dhe të cilësisë së jetës. Arsimiti ndihmon në pjesëmarrjen e masave të popullsisë për të qenë pjesë aktive në procesin e zgjerimit ekonomik. Mundësitë që ofron tregëtia globale

vërtet janë të rëndësishme për zhvillim, por vështirë se mund të kapen e përdoren nga një popullsi analfabete ose e paarsimuar.¹¹

Arritjet e demokracisë varen jo vetëm nga rregullat dhe procedurat që adoptohen e mbrohen, por edhe nga mënyra se si shtetasit përdorin mundësitë që u ofrohen. Fidel Valdez Ramos, ish presidenti i Filipineve, e shtroi çështjen shumë qartë në një fjalim të mbajtur më nëntor 1998 në Universitetin Kombëtar Australian:

Nën qeverisjen diktatoriale njerëzit nuk kanë nevojë të mendojnë, nuk kanë nevojë të zgjedhin, nuk kanë nevojë të diskutojnë ose të japin pëlqimin e tyre. Gjithshka që duhet të bëjnë është të binden. Ky është leksioni i hidhur që kam nxjerrë nga përvoja politike në Filipine jo shumë kohë më parë. Në kontrast, një demokraci nuk mund të mbijetojë pa virtytet civile ... Sfida politike sot, për njerëzit në të gjithë botën, nuk është thjesht zëvendësimi i regjimeve totalitare me ato demokratike. Përtej kësaj, ajo që duhet të bëjmë është që demokracia të funksionojë edhe për njerëzit e thjeshtë.

Për të siguruar një edukim demokratik, na duhet t'u kthehemi e kemi në vëmendje parimet e Tagore dhe Dewey, që bëjnë apel për një arsim që kultivon kapacitete për të kritikuar, që nxit një të kuptuar kompleks të botës dhe të njerëzve, që ushqen simpatinë. Me pak fjalë, kemi nevojë që shkolla jonë të nxjerrë qenie njerëzore me ndjenja humane.

¹¹ Sen, A., 2011. "*Zhvillimi si liri*", U.F.O Press, Tiranë: f. 158-9. Përkthyes V. Nathanailli & T. Verteniku.

ARSIM DHE PABARAZI

"Arsimi është shumë i rëndësishëm në përparimin e një kombi." Pothuajse të gjithë filozofët e pranojnë këtë, nga kohët e lashta në ato moderne. Ne i mësojmë fëmijët jo vetëm me besimin se do të jemi në gjendje të zhvillojmë e konsolidojmë dijet e formimin e tyre, por edhe me shpresën se do mund të influencojmë mundësitë e krijimit të një qytetari aktiv dhe të përgjegjshëm për të drejtat e detyrat e tij ndaj shoqërisë e vendit në përgjithësi; jo vetëm nga një mësues dhe në lëndë të caktuara, por nga e gjithë trupa pedagogjike dhe në çdo lëndë. Me supozimin se sado klishe të duken pohimet e mësipërme të gjithë jemi dakord, çështja në vijim lidhet me faktin se: si do mund të sigurojmë arsim cilësor për të gjithë, pra pavarësisht të ardhurave që kanë prindërit, qytetit ku merr mësim, zhvillimit mendor ose grupit etnik që i përket fëmija, pasi secili prej disavantazheve në të ardhura, në intelekt ose në grupin social ku bën pjesë është burim për pabarazi në arritje arsimore. Pra, pavarësisht startit, si të arrijmë që të gjithë fëmijët të kenë mundësi për arritje të barabarta, që

perspektiva individuale për arritje arsimore të jetë funksion vetëm i përpjekjeve dhe i talentit të individit dhe jo i sfondit social të tij.

Sa e plotëson arsimi shqiptar një mision të tillë? Pra, a është shkalla e mundësive që ofron sistemi ynë arsimor në përpjesëtim të drejtë me shkallën e disavantazheve? Për fat të keq, mund të sjellim më shumë shembuj kur “për më shumë disavantazhe ofrohen pak ose aspak mundësi.” Në vijim do të ndalem në një problematikë emergjente: shkollimi në zona që kanë dalë jashtë hartës së zhvillimit të vendit. Sipas logjikës së mësipërme, sa më e prapambetur të jetë zona, aq më të mëdha duhet të jenë investimet në arsim për të mbushur hendekun që krijon ky faktor dhe për të siguruar të njëjtin arsim cilësor që ofrohet edhe në qytetet e zhvilluara, ku problemet e kësaj natyre nuk janë kaq të mprehta. Disavantazhet në raste të tilla lidhen, kryesisht, me të ardhurat e vogla dhe shpesh të pamjaftueshme të prindërve, me mungesën e fondeve të bashkive dhe të njësive vendore që kanë përsipër mirëmbajtjen e shkollave dhe të fondit të vogël të MASH për stimulimin në mënyrë dinjitoze të atyre mësuesve që pranojnë të punojnë në këto shkolla, pra kanë sfond kryesisht ekonomik, por sigurisht jo vetëm!

Nga ana tjetër, të gjithë i kemi parë pamjet e transmetuara nga media të ndryshme sa u takon shkollave të rrënuara në shumë fshatra të vendit! Sigurisht që të kesh shkollë në çdo fshat dhe në çdo komunitet sado të vogël, përfshirë edhe në atë më të “humbur”, në kuptimin që është në majë të malit, ose matanë lumit dhe mungon ura, është baras me zhvillim, por për një vend të varfër sikundër jemi ne, përbën luks, në mos pamundësi, sepse përveç investimeve

në infrastrukturë, kërkon edhe mësues, pra kapital njerëzor. Ne i kemi me pakicë të dyja! Jemi të varfër dhe lëvizja e lirë ka bërë që të gjithë që kanë një diplomë të shkollës së lartë, të drejtohen për punë në qytetet kryesore. Nëse në kohën e diktaturës ekzistonin mekanizma, në pjesën dërrmuese shtrënguese, që hapnin shkolla në majë të malit dhe e çonin edhe mësuesin më të mirë për të punuar në të, duke siguruar arsim cilësor në të gjithë cepat e Shqipërisë, sot këta mekanizma ne kemi 20 vjet që i kemi nxjerrë jashtë loje, por mbajmë po të njëjtën skemë: shkolla edhe në zonat më të humbura, ndonëse e dimë se ‘as sa për të kaluar radhën nuk janë’!

Detyra kryesore për një teori politike të ndjeshme ndaj pabarazive është zhvillimi i metodave që bëjnë apel për barazi. Këtu barazi përkthehet në arsim cilësor edhe për fëmijët e këtyre zonave. Jo vetëm mungesa e metodave, por edhe vullneti i mirë për të iniciuar veprime politike me efekte konkrete, që për fat të keq jo gjithmonë janë të thjeshta, në mos mungesa e vizionit, është karakteristikë e menaxhimit të sistemit tonë arsimor. Sistemi ynë arsimor duhet t’i përgjigjet me efektivitet emergjencës për arsim cilësor në çdo zonë të vendit dhe një përgjigje mjaft e mirë është mundësia e shkollimit të këtyre fëmijëve, që në zona të veçanta nuk është më shumë se 20, pranë shkollave të qyteteve, nëpërmjet dhënies së bursave nga shteti (që shkojnë shumë më pak se paratë që duhen për mirëmbajtjen e shkollave dhe rrogat e mësuesve), ose gjetjen e mundësive për shkollim pranë shkollave private, në formën e një zëri që mund të futet në kushtet e licencimit të tyre (për shembull, për çdo 50 nxënës duhet të jepet një bursë etj.). Është shumë më e thjeshtë të gesh mundësi për të

shkolluar këta fëmijë në shkollat e qendrave se të çosh qendrën në këto zona! Për më tepër, ndërtesat ekzistuese mund t'i marrë pushteti vendor në administrim për t'ua dhënë në përdorim familjeve në nevojë.

Në fakt, mbyllja e shkollave të vogla, ka anë pozitive e negative; pozitive: kursime në fonde (një pjesë e mirë e fondeve të kursyera mund të përdoren për rritjen e pagave të mësuesve, si dhe për një shpërndarje më të drejtë të fondeve ekzistuese në drejtim të shpenzimeve kapitale) apo lehtësim në drejtim të gjetjes së një stafi të kualifikuar; negative: fëmijët e këtyre zonave duhet të arsimohen në zona të tjera, gjë që do të thotë probleme të integritetit të nxënësve me distancën dhe me nxënësit e tjerë apo probleme të performancës, pasi nxënësit performojnë më mirë në shkollat e vogla, ku kujdesi, nga ana e të rriturve, është më i ndjeshëm dhe i dukshëm për secilin prej tyre.

Por, sikundër shprehen politikëbërësit e edukimit, arsimi duhet të shpërndahet në mënyrë të tillë që të maksimizojë perspektivën për mirëqenie të përgjithshme edhe për ata perspektiva e të cilëve është varfëria. Do të vazhdojmë të bëjmë sehir pamjet e shkollave të frikshme dhe të dëgjojmë histori me mësues që nuk dinë të zgjidhin ushtrime nga aritmetika e klasës së katërt apo do të punojmë për skema arsimore, nga të cilat përfitojnë edhe ata me më shumë disavantazhe?

Gazeta "Shqip", 22 tetor 2013

NË VORBULLËN E PRIVATES DHE PUBLIKES

Nga shkollat kërkojmë shumë, në mos të gjitha! Kërkojmë të sigurojmë përgatitje akademike dhe profesionale; të formësojmë brezat jo vetëm në aspektin personal, por edhe social; të edukojnë qytetarë të gatshëm për të qenë pjesë e frontit të punës ose për të marrë përsipër përgjegjësitë e zhvillimit të vendit. Por a është në gjendje shkolla jonë publike të plotësojë këto pritshmëri që kemi ndaj saj? Vështirë të japësh përgjigje pozitive! Për më tepër, gjendja varion shumë jo vetëm nga qyteti në qytet, por edhe brenda një qyteti. Alternativë mbetet shkolla private. Dhe pyetja përsëri është po ajo: A është në gjendje shkolla jonë private, veçanërisht ajo me statusin e një organizate fitimprurëse, të plotësojë këto pritshmëri që kemi ndaj saj?

Duhet pranuar se hapja e shkollave private, fitimprurëse ose jo, u shoqërua me thyerjen e 'monopolit' të dijes dhe të edukimit që mbante shkolla publike. Për prindërit e pasur shqiptarë nuk u desh shumë kohë të kuptonin se shkolla publike që 'u kishte rënë për pjesë' në zonën ku jetonin nuk plotësonin pritshmëritë që kishin për edukimin e fëmijëve

të tyre. Zgjidhja: shkollë private. Në logjikën e tregut dhe të fitimit, shkollat private duhet të jenë më efektive: paga më të mira për mësuesit, më shumë motivim, kushte më të mira. Për më tepër, shkollat private, në kushtet e konkurrencës me njëra-tjetrën dhe me vetë shkollën publike, për të mbijetuar, duhet të jenë domosdo të mira.

Por standardi i pagesës dhe i ndjekjes së një shkolle private është kafshatë që nuk kapërdihet nga pjesa dërrmuese e shoqërisë sonë. Çështja që shtrohet nuk është thjesht se sa shumë fëmijë që vijnë nga familje ‘të varfra’ mësojnë në shkolla publike, por që shumica e fëmijëve tanë përsëri vazhdojnë të mësojnë në shkolla publike. Në vazhdim të kësaj ideje, duhet theksuar se dispozitat normative të MASH lejojnë regjistrimet e fëmijëve vetëm në shkollën që ndodhet pranë qendrës së banimit.¹ Të kërkojë të regjistrosh fëmijën në një

shkollë që bie ndesh me dispozitat e mësipërme ose është e pamundur, ose duhet të njohësh dikë në drejtorinë arsimore, mundësisht drejtorin. Duke përmbledhur dy argumentet e mësipërme, konkluzioni është i qartë: pavarësisht arritjeve që ka shkolla ose aftësive që mund të ketë fëmija, e vetmja shkollë ku mund të shkojë është ajo që gjendet te dera e shtëpisë. Konkluzioni mund të pasurohet tani me një argument të ri: nëse konkurrenca ndikon pozitivisht në përmirësimin e shkollave private, kjo nuk vlen për shkollat publike, sepse ndërmjet tyre mungon ky mekanizëm: e mirë ose e keqe (po përdor fjalor urban), shkolla do të vazhdojë të jetë po ajo, sepse çdo pallat rreth e rrotull, çdo shtëpi e ndërtim është një mundësi për kontingjent nxënësish. Sigurisht që mungesa e konkurrencës ndërmjet shkollave publike në sistemin tonë arsimor nuk është kushti i domosdoshëm që një shkollë të jetë e keqe, por është aq i mjaftueshëm sa ta mbajë atë (shkollën) në parametrat e të qenët e tillë. Në përfundim të një viti shkollor me rezultate jo të kënaqshme, në shkollë maksimumi mund të ndërrohen drejtuesit, por e gjithë ‘ngrehina’ mbetet po ajo: e njëjta kurrikul, të njëjtët mësues, e njëjta pagë, të njëjtat tekste, i njëjti shans edhe për fëmijët të vazhdojnë të studiojnë në një shkollë që nuk bën për ta, që i frenon, në mos i ç’edukon, pra në një shkollë ku ‘ajo që nuk shkon’ është vetë mënyra e konceptimit të shkollës. Viti i ri shkollor fillon sikur të mos ketë ndodhur asgjë, në një sistem tepër kokëfortë, që riciklon vetveten në të njëjtën mënyrë, me të njëjtat probleme dhe me të njëjtin vizion.

Pra, politikat arsimore të deritanishme në sistemin parauniversitar, i lënë shkollat publike ashtu si janë, ndërkohë që nxisin arsimin privat, me logjikën ‘sa më shumë shkolla private, aq më pak shpenzime për arsim’, pasi në një farë

¹ *Shënim:* Në ligjin nr. 10171, datë 22.10.2009 “Për profesionet e rregulluara në Republikën e Shqipërisë”, neni 17, “Kodi etik profesional”, jepen kriteret për përmbajtjen dhe për procedurat e krijimit të një kodi etike, si dhe përcaktohet autoriteti kompetent për hartimin e tij, që është Urdhëri Profesional. Po sipas nenit 17 të këtij ligji, një kod etik profesional duhet të udhëhiqet nga këto parime:

- i. mbrojtja e interesave publikë, nëpërmjet ushtrimit korrekt të profesionit;
- ii. mbrojtja e besimit dhe e zgjedhjes së lirë nga përfituesi i shërbimit;
- iii. sigurimi i cilësisë së shërbimeve profesionale;
- iv. sigurimi i të dhënave të duhura për përmbajtjen dhe mënyrat e ushtrimit të shërbimeve profesionale.

Dispozitat normative në arsim, në nenin 12, “Ndarja territoriale” pohojnë se regjistrimi i fëmijës në të gjitha ciklet e shkollimit, si rregull, bëhet në kopshtin dhe shkollën e përcaktuar nga ndarja territoriale e vendbanimit të vendosur nga pushteti vendor me propozim të DA. Pra, në këtë këndvështrim, dispozitat normative bien në kundërshti me ligjin (Neni 17, pika ii), pasi përftuesit e shërbimit, në këtë rast nxënësit e bashkë me ta edhe prindërit e tyre, nuk mund të ushtrojnë të drejtën e zgjedhjes së lirë.

mënyre ato shërbejnë si valvula shfryrjeje për shtrëngesën e fondeve. Kjo sjell që të gjitha dallimet ndërmjet grupeve të ndryshme në shoqëri të pasqyrohen edhe në edukim: ‘hirrë’ për disa dhe ‘krem’ i cilësisë së parë për disa të tjerë, thotë një nga pedagogët më të njohur. Situata bëhet akoma më dramatike po të kihet parasysh fakti që edhe shumë nga shkollat private të hapura në vend shpesh janë për të qarë hallin.

Së pari, sepse mungon kontrolli nga institucionet përkatëse, shpesh për shkak të mungesës së personelit, shpesh sepse ne të gjithë e dimë sa të thjeshtë e kanë ‘inspektorët’ për të bërë sikur inspektojnë (sigurisht jo të gjithë!).

Së dyti, sepse një shkollë që funksionon si një organizatë fitimprurëse, niset më shumë nga motivi i fitimit se nga plotësimi i nevojave që ka shoqëria për qytetarë demokratikë. Aty ku interesat e fëmijës bien ndesh me ato të biznesit, prevalojnë interesat e biznesit. Për të mos harruar faktin që, falë kapitalit financiar që ka, propagandon e promovon shpesh edhe vlera false.

Problemi “si t’u sigurojmë të gjithë fëmijëve një arsim të përshtatshëm” që në kontekstin tonë përkthehet jo vetëm sa të drejtë kanë prindërit për të zgjedhur një shkollë të përshtatshme publike për fëmijën, por edhe nga duhet të anojë peshorja, nga privatja apo publikja, hap debat në të gjitha vendet. Por në rastin tonë, nisur nga të ardhurat e pamjaftueshme të pjesës më të madhe të popullsisë për t’u dhënë arsimin e duhur fëmijëve, zgjidhje nuk janë shkollat private dhe mburrja sa shumë kemi, por përmirësimi i shkollave publike në sistemin arsimor parauniversitar, edhe nëpërmjet mekanizmit të konkurrencës ose ‘zgjedhjes’ së lirë! Është një mënyrë për të rritur indirekt edhe shkallën e përgjegjshmërisë së mësuesve e drejtuesve të shkollave

përpara prindërve. Një arsyetim i tillë, metodologjikisht shumë i rëndësishëm për jetën e shkollës dhe të fëmijëve, mund të pasurohet me një shembull nga ShBA: afro 40 shtete e kanë pranuar si pozitive ‘regjistrimin e hapur’, që do të thotë mundësinë e regjistrimit të fëmijës edhe në një shkollë, që jo detyrimisht është pranë vendbanimit, shoqëruar sigurisht me specifikime përkatëse që lidhen me madhësinë e shkollës, infrastrukturën apo llojin e saj etj.

E rëndësishme është se duhet të fillojmë të mendojmë ndryshe, të kuptojmë rolin e vendin që ka tregu e privati në shoqëri, pa e fetishizuar. A është vërtet ekonomia e tregut kaq e egër sa e zbatojmë ne apo si çdo gjë tjetër edhe këtu më shumë se kuptojmë, klonojmë; më shumë se të merremi me politika ekonomike e sociale, merremi me fushata dhe parulla për konsum ditor.

Gazeta “Shqip”, 15 nëntor 2013

ROLI I NDRYSHUAR I UNIVERSITETEVE SHQIPTARE

Sot, afro 900 vjet nga krijimi i universitetit të parë, universitetet kanë ndryshuar jo vetëm përmasat, por çfarë është më e rëndësishmja edhe rolin e misionin e tyre. Ndoshta pretendimi për të krahasuar universitetet e sotme me ato të shekujve më parë mund të duket tepër *vintage* dhe, për dikë, ndoshta i tejkaluar, sepse krahasimi edhe me vetëm 50 vjet më parë mjafton për të pohuar se universitetet kanë ndryshuar.

Në ditët e sotme universitetet nuk janë më godinat e zymta ku dëgjohet vetëm zëri i akademikëve me mjekër dhe klasa që ndiqen nga studentët me nota më të mira me synimin për të studiuar e raportuar se çfarë ndodh brenda mureve të laboratorit. Larg qoftë! Asnjë nuk do shkonte me dëshirë në një universitet të tillë! Sot universitetet janë shndërruar në mundësi jo vetëm për dije, por edhe për mirëqenie, jo vetëm për aftësi, por edhe për konkurrencë. Pra, përtej gjetjes së zgjidhjeve për çështje të rëndësishme që lidhen me shkencat e natyrës ose me ato ekonomike e sociale dhe informimit të shoqërisë për këto

gjetje, gjithmonë e më shumë universitetet po kërkojnë të informohen se çfarë ndodh në shoqëri, të jenë në simbiozë me të, të japin e marrin jo vetëm programe, por edhe ide e kapital njerëzor.

Sigurisht që është e vështirë të listosh të gjithë faktorët që ndikuan në ‘hapjen’ e universiteteve ndaj ‘halleve’ të shoqërisë, ose të përpiqesh të gjesh se kur ndodhi një ndryshim i tillë në vende të ndryshme të botës. E rëndësishme është të theksojmë se të gjitha universitetet po e zëvendësojnë konservatorizmin ndaj kurrikulës me liberalizmin, pra në favor të një nxënieje më të pasur, më fleksibël dhe në funksion të tregut të punës e së përditshmes; po e pasurojnë profilin e akademikut klasik me atë të një personi me status më heterogjen, me *cv* të pasur me aktivitete të suksesshme që përfshijnë jetën publike dhe/ose private. Sot universitetet kanë hapur dyert për çdo individ nga sektori privat a publik që ka një mesazh për të dhënë, një fabul për të ndarë ose një ideologji për të transmetuar dhe janë bërë më të ndërgjegjshme për rolin që kanë, sepse ndjekin me vëmendje shoqërinë, duke u shndërruar në një lloj barometri social që synon jo vetëm të jetë sinkron me çdo trend të saj, por edhe të parashikojë e shpjegojë zhvillimet e pritshme.

Në Shqipëri sektori universitar pësoi ndryshime të paimagjinueshme pas viteve ‘990. Shfaqja e universiteteve private mund të quhet si një ndër faktorët kryesorë që ndikuan në hapjen dhe, bashkë me të, edhe në ndryshimin e misionit edhe të universiteteve shqiptare. Autonomia, kryesisht financiare, ishte një start i mirë për secilin prej tyre. Ato ofruan gjithçka që kërkohej tek universiteti shtetëror dhe që mungonte: akses për të gjithë dhe ku të duash, si për

shembull juridik, shkenca sociale, stomatologji, farmaci, psikologji; infrastrukturë dhe shërbim të shkëlqyer; personel akademik dhe administrativ të përkushtuar.

Shpejt a vonë, mirë a keq, ky është një argument tjetër, por themelet e koncepteve tona se kush duhet të shkojë në universitet dhe pse, çfarë duhet të mësojë dhe si, pësuan krisje të rëndë me shfaqjen e “privatëve” në këtë sektor. Një hamendësim mund të jetë se kishte ardhur koha, ose edhe se universiteti shtetëror e kishte nisur, pak nga pak, që më parë, një ndryshim të tillë dhe mjafton të ecej në atë rrugë – por fakt është që me shfaqjen e “privatëve” ndryshimi i misionit të shkollimit në universitet u bë emik: preku çdo degë e çdo lëndë dhe, për më tepër, ndikoi, në kuptimin që mund të përfitonte prej tij, çdo i ri shqiptar që aspironte për më shumë.

Më 2007, shteti shqiptar sanksionoi me ligj rolin e ndryshuar të universiteteve duke kërkuar prej tyre “të krijojnë, të transmetojnë, të zhvillojnë e të mbrojnë dijet” jo vetëm me anë të mësimdhënies e kërkimit shkencor, por edhe me anë të “shërbimit”, si dhe të ndihmojnë “zhvillimin ekonomik në nivel kombëtar e rajonal”.¹ Për herë të parë në historinë e zhvillimit të saj shoqëria shqiptare ka një numër kaq të madh institucioneve të arsimit të lartë: plot 49. Të pohosh se të gjitha universitetet që operojnë në Shqipëri ecin në trendet e mësipërme, sigurisht që duhet të jesh ose naiv, ose të punosh në Ministrinë e Arsimit, sa kohë që vazhdohet të jepen licenca për institucione të arsimit të lartë kur nuk jemi ende në gjendje të identifikojmë se çfarë

¹ Ligji nr. 9741, datë 21.5.2007 “Për arsimin e lartë në Republikën e Shqipërisë”, ndryshuar me ligjin nr. 9832, datë 12.11.2007, me ligjin nr. 10307 datë 22.7.2010. “Përmbledhje legjislativi për arsimin.” Botim i Qendrës së Publikimeve Zyrtare, tetor 2010.

shkon mirë dhe jo në këto që kemi, cila është patologjia e tyre dhe si të ndërhyjmë! Pra, çfarë bëhet në këto institucione, çfarë ofrohet dhe si, nga kush dhe përsëri si, që e përkthyer në gjuhë akademike: A është misioni i këtyre universiteteve, tashmë në termin “identitet personal”, në përputhje me kërkesat që shtrun ligji dhe shoqëria? Një faktor tjetër që ka ndikuar negativisht në mirëpërmeshjen e misionit të universiteteve është mungesa e një filozofie të përshtatshme shkollimi, filozofi që t’u përgjigjet të gjitha kategorive të dijeve me të cilat regjistrohen studentët në vit të parë. Kështu, ndonëse jemi të ndërgjegjshëm se Matura Shkollore, megjithë synimin e mirë për të cilën u krijua, paraqet defekte serioze sa i takon korrektesisë së certifikimit të dijeve, përsëri ne pranojmë në universitet, duke i marrë si të mirëqena, përfundimet e saj.

Për më tepër, pavarësisht mesatares së notës me të cilën studentët hyjnë në universitet, cikli i studimeve quhet i mbyllur për të gjithë njëloj (përjashtojmë rastin se çfarë ndodh gjatë rrugës, po hipotekojmë teorikisht): pra cikli i parë, për shembull, zgjat 3 vjet si për atë që di ‘shumë’ dhe për atë që di ‘hiçasgjë’, domethënë nuk jemi në gjendje të gjejmë një ekuilibër ndërmjet dëshirës për të vazhduar shkollën e lartë dhe mundësisë për ta realizuar atë, sepse ‘hiçasgjëja’ do vazhdojë të jetë ‘hiçasgjë’ edhe për 3 vitet në vijim, për më tepër me hiçmosgjënë e tij pengon dhe ul stekën edhe për atë që dinte “shumë”.

Një filozofi e përshtatshme shkollimi do të thotë pranim për të gjithë, por kohë shkollimi selektive: nëse ‘hiçasgjë’-së duhen 5 vjet, le t’i themi se “ti bëhesh për 5 vjet, por ama bëhesh” dhe nuk gënjejme as atë dhe as veten. Ose mund të ecet me shembullin e kolegjeve, si për shembull në

ShBA. Të gjitha universitetet (përfshirë edhe ato që kanë thjesht statusin e institucionit të arsimit të lartë) duhet të vlerësohen dhe të rankohen në bazë të çdo programi, si e ofrojnë mësimdhënien, sa i shërbejnë transferimit të dijeve, sa i përmbahen kërkesave që shtrun ligji për arsimin e lartë. Shqipëria është nga vendet e pakta në botë, në mos i vetmi, që ka agjencitë për vlerësimin e institucioneve të arsimit të lartë, por nuk ka listën, që ka ideologjinë, por nuk vë në lëvizje levat për zbatimin e saj. Sigurisht që më të humburit dalin prindërit, që në mungesë të një busulle orientimi se kush është universiteti më i mirë, hallakaten në labirinthe të çmimeve dhe të reklamave dhe çojnë dëm jo vetëm paratë, por edhe edukimin e të ardhmen e fëmijëve.

Gazeta “Mapo”, 16 korrik 2013

SHKOLLIMI NË ERËN GLOBALE

Deri në fillim të viteve '990 misioni i shkollës në sistemin arsimor parauniversitar shqiptar ishte formuluar për të qenë i suksesshëm vetëm brenda `një shtrirjeje gjeografike të kufizuar: vetëm në territorin e Shqipërisë. Pothuaj 100% e të diplomuarve në përfundim të këtij cikli shkollimi përgatiteshin, ose për të vazhduar studimet e larta në universitetet që gjendeshin brenda kufijve kombëtarë, ose për të qenë pjesë e forcës së punës që jetonte e punonte në qytetet a fshatrat e po këtij territori. Përgatitja me një platformë të tillë fillonte që në vitet e para të edukimit dhe gjente zbatim me mbarimin e ciklit të studimeve: ishte nga Tirana dhe duhej të mësoje fëmijët e Mirditës, apo ishte nga Puka dhe duhej të punoje për hidrocentralin e Sarandës. Në një përmbledhje shumë koncize, të dyja rastet përmbledheshin në formulën “Ku ka nevojë atdheu!” Me apo pa dashje, me apo pa vetëdije, problemet e hapjes së individit dhe të përshtatjes së tij ndaj traditave a zakoneve të zonave të ndryshme të vendit ishin pjesë e realitetit të përditshëm. Sigurisht, sa e aftë ishte shkolla dhe sistemi

arsimor i asaj kohe t'i përgatiste bijtë e vet për këto sfida kërkon hulumtime të shumta.

Hapja e Shqipërisë ndaj botës dhe e botës ndaj saj shtroi nevojën e një filozofie të re shkollimi, ose e thënë në pak fjalë, konceptimin e një misioni të ri të shkollës, në gjendje të kapërcente kufizimet e hartimit vetëm për një shtrirje gjeografike të caktuar e të mbyllur. Të parët që trokitën në dyert e shkollave me kërkesën për një shkollim më formues, modern e global, ishin prindërit. Për shumë prej tyre, shkollimi në universitetet shtetërore shqiptare apo punësimi në kompanitë lokale të fëmijëve të tyre nuk ishte më arritja më e madhe. Këta përbënin atë pjesë që planifikonte t'i arsimonte fëmijët e tyre për studime jashtë vendit dhe që ushtronin presion të vazhdueshëm për reformimin e shkollimit, me një theks të veçantë në mësimin rrjedhshëm të të paktën një gjuhe të huaj, kryesisht anglisht, një fenomen sa shqiptar ashtu edhe botëror. Shqetësimi ynë është nëse sot, në erën globale, kur kufijtë gjeografikë të studimit apo punësimit shkojnë në Europë e Amerikë dhe më tej, në Kinë e Indi, duhet të vazhdojmë të mësojmë anglisht, apo ka ardhur koha ta zëvendësojmë këtë gjuhë me një tjetër!

Pse akoma anglisht?

Sot në botë fliten afro 6900 gjuhë të ndryshme. Gjuha që flitet nga më shumë njerëz në të gjithë botën është gjuha mandarin (që ne shpesh i referohemi si kinezçe): kjo gjuhë flitet nga më shumë se një miliard njerëz. Në vend të dytë janë anglishtja, spanjishtja dhe hindishtja, me afro gjysmë

miliard njerëz që e flasin secilën. Ndonëse numri i njerëzve që kërkojnë të mësojnë mandarin dhe spanjisht është gjithmonë në rritje, sipas British Council, kjo situatë pritet të ndryshojë në dy dekadat në vijim: deri në fillim të viteve 2030 numri i njerëzve që do të flasin anglisht do të jetë në vend të parë, me afro 2 miliard, ose 30% të popullsisë së botës, ose 5 herë më shumë se numri i njerëzve që e kanë anglishten si gjuhë amtare.

Arsyet që rreshtohen janë të shumta. Së pari, mënyra dhe niveli i jetesës në vendet anglishtfolëse të cilat admirohen nga një numër i madh njerëzish. Së dyti, fakti që gjuha e shkencës, e biznesit dhe e teknologjisë është anglishtja. Së treti, universitetet më të mira në shkallë botërore gjenden në vendet anglishtfolëse: nga 100 universitetet më të mira në botë, 83 gjenden në ShBA, Angli, Kanada dhe Australi dhe vetëm 2 janë në Kinë e po aq në Japoni. Më 2007, sipas një raporti të UNESCO-s, ShBA shpenzonin 9600 dollarë në vit për student, kundrejt Indisë, për shembull, me vetëm 400 dollarë në vit për student. Nga ana tjetër, mbarimi i studimeve në një universitet të mirë, do të thotë siguri në tregun e punës dhe, sigurisht, edhe të ardhura më të mira.

Për arsyet e mësipërme, jo vetëm tek ne, por në pjesën më të madhe të botës, mësimi i anglishtes si gjuhë e huaj kryesore në shkollat e ciklit parauniversitar është në vëmendje të politikëbërësve. Në shumë prej tyre, për të pasur një formim sa më të plotë, kurrikula plotësohet me historinë dhe letërsinë e vendeve anglishtfolëse dhe, sigurisht, me investime të shumta në para, njerëz e programe për të siguruar një performancë sa më të mirë akademike. Nëse bëjmë një histori shumë fragmentare të reformimit të shkollës në vendin tonë sa i takon mësimin

të anglishtes, ajo lidhet kryesisht me uljen e moshës së fillimit të mësimi të saj, duke ruajtur pak a shumë po ato orë mësimi/javë. Për më tepër, nuk mund të flitet për programe të rregullta shkëmbimi ndërmjet shkollave tona me ato në vendet anglishtfolëse me synim sigurimin jo vetëm të përvetësimit më të mirë të gjuhës, por edhe të zgjerimit të përvojës së jetuar, shoqëruar me një rritje të ndërgjegjësimit ndaj kulturave të tjera apo nevojës për të pranuar e mirëpritur diversitetin. Panorama bëhet akoma më e zymtë për gjuhën e huaj të dytë dhe akoma më e zymtë për mësimin e të dyja gjuhëve të huaja në fshatra apo qytete të largëta të vendit. Rrjedhojë është se përsëri, si kur fillonte mësimi i anglishtes në klasë të pestë, ashtu edhe tani që fillon në klasë të dytë apo të tretë, në mbarim të ciklit të plotë parauniversitar nxënësit tanë që kanë ndjekur shkollat publike, sipas kësaj kurrikule ekzistuese dhe këtyre instrumenteve, në përgjithësi, nuk e flasin anglishten rrjedhshëm. Pra, në këta 20 vitet e fundit, ndonëse kemi folur, investuar e promovuar mësimin e anglishtes, në shkollat publike përsëri ka shumë për të bërë.

Fillimi i mësimi të një gjuhe tjetër në vend të anglishtes apo krahas saj, që të shndërrohet në realitet, nëse ecim përsëri me këto reforma dhe fonde, kërkon kohë të zbatohet, sikundër mësues të përgatitur apo skema efikase që t'u përgjigjen kërkesave specifike. Nuk besoj se është e përshtatshme, nisur nga arsyetimet e mësipërme por jo vetëm, që gjuha mandarin të mësohet në të gjitha shkollat e nivelit parauniversitar. Sigurisht, duke lënë mënjane kulturën e jashtëzakonshme kineze, pse duhet të fusim gjuhën mandarin në shkolla? Nga arsyetimet e faktet e mësipërme, një argument mund të

jetë regjistrimi i të rinjve tanë në universitetet kineze. Sigurisht në universitetet më të mirë, por që janë shumë pak: vetëm dy dhe me numër të limituar pranimi sa i takon studentëve që mund të regjistrohen. Për këtë, një të riu shqiptar do i duhet të konkurrojë me bashkëmoshatarët e tij kinezë apo nga vende të tjera dhe, sigurisht, shanset janë pothuaj të papërfillshme për shkak të konkurrencës së jashtëzakonshme në numër dhe cilësi. Rasti tjetër, gjithmonë me doza të larta hipotetike, është që një i ri i diplomuar në një universitet shqiptar dhe që në shkollë të mesme ka “mësuar” gjuhën mandarin, të kërkojë të punësohet në një kompani të madhe kineze! Sigurisht që në fokus mund të sillet edhe nevoja e komunikimit në zhvillimin e marrëdhënieve tregtare, por për shumë nga ne është e qartë sa i kufizuar është një fjalor i tillë dhe sa shpejt që mësohet (sikundër tregtarët që bëjnë tregti me Turqinë kanë mësuar atë fjalor të kufizuar turqisht tregtar dhe sigurisht jashtë bangave të shkollës). Pra, ja vlen që për dy a tre, sikundër edhe për disa, të bëjmë investime kolosale dhe të nxjerrim me qindra “kinezë analfabetë”?

Në diskutimin që është hapur këto ditë për gjuhët e huaja, një fenomen tjetër që mund të sillet në vëmendje dhe me shumë rëndësi të rishikohet janë emigrantët që po kthehen këto kohë dhe si do i “fusim në punë” njohuritë që po sjellin, veçanërisht sa u takon gjuhëve që flasin. Më të shumtët në numër janë ata që vijnë nga Greqia dhe në argumentin gjuhë e huaj, greqishtja pothuaj perfekte që flasin këta fëmijë. Pavarësisht problemeve fillestare që mund të ketë përshtatja e këtyre fëmijëve në shkollat shqip, që gjithsesi është e përkohshme, më shqetëson se çfarë do bëjmë me greqishten e tyre, që në fund të fundit është një investim i

jashtëzakonshëm që ne e kemi gati: do e lemë të humbasë në kërkesat e kurrikulës së përgjithshme kombëtare apo do e riinvestojmë dhe do e bëjmë pjesë të formimit të tyre të përgjithshëm? Përpara se këta fëmijë t'i bëjmë problem se nuk flasim mirë shqip, le t'i bëjmë shembull se dinë shumë mirë një gjuhë të huaj. Me shumë pak fonde dhe me shumë më tepër dëshirë e vullnet për të vënë në shërbim të shkollimit këtë instrument që kemi, mësimi i greqishtes si gjuhë e huaj në disa shkolla të vendit, mund të jetë një ide shumë e mirë dhe frytdhënëse, në funksion të një vizioni afatgjatë: shumë prej tyre, të diplomuar në shkollat shqip dhe me një greqishte perfekte që kanë vazhduar ta mësojnë në shkollën shqipe, mund të rikthehen përsëri në vendin që i priti në vogëli si qytetarë të nderuar e të kulturuar shqiptar, që kërkojnë të vazhdojnë studime të mëtejshme, të punësohen në kompani serioze, të hyjnë në marrëdhënie tregtare apo thjesht të bëjnë pushime.

Përpara disa kohësh bisedoja me dy prindër që ishin kthyer nga Gjermania së bashku me fëmijët mbas një qëndrimi 14 vjeçar atje. Fëmijët kishin ndjekur rregullisht ciklin e plotë të studimeve në sistemin arsimor parauniversitar gjerman (nga Shqipëria ishin larguar në moshën dy vjeçare), që do të thotë se gjermanishtja e tyre ishte e njëjtë me atë të një gjermani autokton. Në përpjekje për të rregulluar jetën e tyre këtu, ndërsa vetë arritën të hapin e të ngrenë një biznes të suksesshëm, vajza e tyre pësoi zhgënjimin e parë: kishte aplikuar për të ndjekur studimet e larta për gjermanisht pranë UT, por nuk e pranuan sepse nuk e kishte mesataren e përgjithshme shumë të mirë! Një të riu shqiptar që flet shkëlqyeshëm gjermanisht, që ka jetuar në Gjermani për katërmëdhjetë vjet, i refuzohen

studimet për gjermanisht nga një universitet në Shqipëri. Si ka mundësi të jemi indiferentë ndaj dijeve të saj, sikundër edhe përvojës e kulturës që sjell, të investuara nga një shtet tjetër, me një sistem arsimor shumë më të mirë se i yni – për të cilën të gjithë besoj se jemi dakord? Gjetja dhe përdorimi i skemave të përshtatshme të shkollimit për grupe konkrete formimi apo interesash, duhet të bëhen pjesë e synimeve për një shkollim global.

Gazeta "Mapo" 12 shkurt 2013

SHKOLLAT E SHEKULLIT XXI. FAKTORË QË NDIKOJNË NË FORMATIMIN E POLITIKAVE ARSIMORE

“Politikat shtetërore”, lokale apo kombëtare, luajnë një rol shumë të rëndësishëm në formësimin e asaj që ndodh çdo ditë në shkolla e kolegje, apo në përvojat që përjetojnë të gjithë ata që punojnë e studiojnë në këto institucione.¹

Ndryshimet në ekonomi, zhvillimet teknologjike dhe intensifikimi i lëvizjeve urbane po rrisin, përditë e më shumë, trysinë e publikut për shkolla sa më cilësore, pasqyruar në debate të shumta apo materializuar në modele të reja shkollimi. Nga ana tjetër, dimensionin njerëzor i arsimit e komplikon procesin e përshtatjes apo të pasqyrimin të këtyre ndryshimeve, zhvillimeve dhe lëvizjeve, pasi shkollat janë institucione komplekse, shpesh me inerci shumë të madhe. Vizioni ynë është që një shkollim i mirë duhet të ndikojë pozitivisht në modernizimin dhe zhvillimin e shoqërisë, në reduktimin e papunësisë, në rritjen e të ardhurave personale të

¹ Bell L. & Stevenson H., 2006. “*Education policy: process, themes and impact*”, Routledge: Oxon, f. 8.

individit, në zgjerimin e lirive reale që gëzojnë njerëzit, në krijimin e një bote më të sigurt, më të shëndetshme e më të begatë.²

Nëpërmjet arsimimit, të mësuarit dhe formimit profesional, njerëzit, me kalimin e kohës, mund të bëhen shumë më tepër produktivë, gjë e cila kontribuon, në një masë të madhe, në procesin e zgjerimit ekonomik.³

Shpresa jonë është që shkollat do të mund t'u shërbejnë synimeve të tilla. *Mundësitë dhe perspektivat tona varen, përfundimisht, nga institucionet që kemi dhe mënyra si funksionojnë.*⁴ Arsimimi është procesi i përvetësimit të atyre normave morale e sociale që i kemi vlerësuar si të drejta, të atyre koncepteve që i kemi gjykuar si të nevojshme dhe të atyre aftësive që fëmijët tanë duhet të jenë në gjendje t'i përdorin. Kuptohet, jo të gjithë biem dakord për masën e mënyrën e përvetësimit, për metodat e përdoruara apo sasinë e viteve të shkollimit që kërkojnë. Për më tepër, jo të gjithë jemi të qartë se në ç'mënyrë shkollat do të mund t'u përgjigjen realisht kërkesave tona, por për dy gjëra të gjithë biem dakord: shkollat duhet të ofrojnë shanse të barabarta për të gjithë dhe të jenë cilësore. Vetëm në këtë gjykim të integruar do të mund të shqyrtojmë dhe vlerësojmë drejt institucionin shkollë!

Shanse të barabarta dhe cilësi

"Shanse të barabarta" lidhet me faktin se në demokraci të gjithë qytetarët "duhet të jenë në gjendje të përfitojnë nga mundësitë për arsim, krijuar në funksion të plotësimit të nevojave themelore për të nxënë",⁵ për t'u bërë qytetarë aktivë dhe të ndërgjegjshëm, duke nënvizuar këtu faktin se barazi nuk do të thotë që të gjithë fëmijët duhet të mësojnë saktësisht të njëjtat gjëra dhe në të njëjtën mënyrë. Barazi do të thotë që diferencat në interesa dhe në synimet e shkollimit të pasqyrohen në diferenca në dije dhe aftësi, jo si burim pabarazish, por si synim për gjithëpërfshirje. Nga ana tjetër, cilësia në arsim është **angazhim**, nëpërmjet të cilit fëmijët arrijnë të përvetësojnë shprehitë kryesore në të shkruar e të folur dhe të formojnë bazat e një të menduari kritik dhe krijues; është **synim** për ta shtrirë të mësuarin përgjatë gjithë jetës.

Për këto na duhen politikëbërës mendjehapur, të gatshëm të rishqyrtojnë organizimin dhe kurrikulën e shkollave, "shprehur në programe të reja që u adresohen nevojave të nxënësve që vijnë nga familje me origjinë të ndryshme, kryesisht ato në nevojë apo të nxënësve me aftësi të kufizuara dhe atyre me probleme me mësimnxënien",⁶ na duhen kushte të reja nxënieje si dhe rikonceptim i vetë procesit të nxënies, duke e kuptuar më shumë se veprimtaria

² Konferenca Botërore "Arsim për të gjithë", Jomtien Tailandë, 1990. (cituar: Nathanaili V., 2011. "Reforma dhe legjislacioni në sistemin arsimor parauniversitar". Tiranë: Albanian University Press, f. 36.

³ Sen A., 2011, "Zhvillimi si liri". Tiranë, Albanian University Press, f. 325.

⁴ *Ibid*, f. 157.

⁵ Konferenca Botërore "Arsim për të gjithë", Jomtien Tailandë, 1990. (cituar: Nathanaili V., 2011. "Reforma dhe legjislacioni në sistemin arsimor parauniversitar". Tiranë: Albanian University Press, f. 37.

⁶ Elmore R., 2011. "Reforma shkollore nga brenda jashtë. Politika, praktika dhe performanca", përkthet V. Nathanaili, Tiranë: Albanian University Press, f. 29.

e përfuturit të disa dijeve, duke e çuar përtej perceptimit të shumatores së disa aftësive dhe duke e vlerësuar në sisteme koordinatash që nuk kanë vetëm boshtin e standardeve.

Formatimi i politikave arsimore

Pyetjes “sa shkollim duhet të kenë fëmijët dhe cilat duhet të jenë drejtimet kryesore të tij?” mund t’i japësh përgjigje nga më të ndryshmet, në varësi të kriterit të analizës. Nëse gjykojmë në termat e vendimmarrjes, përgjigja është se fillimisht kanë qenë çështje familjare: prindërit kishin ekskluzivitetin e zgjedhjes jo vetëm të llojit të arsimit për fëmijën e tyre, por edhe të viteve të shkollimit. Me zhvillimin e shoqërisë, sisteme të ndryshme e kaluan arsimin ose nën drejtimin e fesë, ose të shtetit, duke vendosur, për më tepër, një parakusht të rëndësishëm që lidhej me ndjekjen e detyruar të disa viteve të caktuara shkollimi, pa pyetur tani më për vullnetin a dëshirën e prindërve.⁷ Por, pavarësisht autoritetit drejtues në krye të arsimit, në pjesën më të madhe të vendeve apo në shumicën e kohës, arsimi është parë si një instrument për instalim pushteti dhe forcim autoriteti. Pak vende mund të thonë se politikatat arsimore i kanë pasur ose i kanë të pandikuara nga ideologjitë apo propagandat e kohës. Hartimi dhe zbatimi i politikave arsimore është problem i të gjithëve, në radhë të parë i

⁷ *Shënim:* Ndonëse është jashtë analizës së këtij artikulli, duhet pasur në vëmendje roli i prindit në shumë aspekte të tjera të vendimmarrjes që lidhen me arsimimin e fëmijës së tij. Sipas *Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut, Protokollin nr.1, neni 2*, “Shteti, në ushtrimin e funksioneve që merr përsipër në fushën e edukimit dhe të arsimit, respekton të drejtën e prindërve për të siguruar këtë edukim dhe arsim në përputhje me bindjet e tyre fetare dhe filozofike”.

atyre që janë të lidhur direkt me të. Agjencia njerëzore luan një rol shumë të rëndësishëm:

Të gjithë ata që punojnë shkolla dhe kolegje, që përballen me zbatimin e këtyre politikave, duhet të ndërgjegjësohen për kontekstin e tyre politik, të jenë të kujdesshëm në kuptimin e mesazhit, interpretimin dhe zbatimin e tij: çfarë duan të thonë, çfarë kërkojnë të arrijnë dhe çfarë pasojash sjellin. Në vend që të qëndrojnë pasivë, duhet të përfshihen në formësimin e politikave kombëtare që në fazat fillestare, ndoshta nëpërmjet pjesëmarrjes në grupe interesi, në shoqatat e profesionistëve ose forume të ndryshme.⁸

Në ditët tona, faktorët kryesorë që ndikojnë në formatimin e politikave arsimore në fushën e arsimit janë të shumtë. Ato mund të shtrihen që nga kushtet lokale “të tregut”, deri në ndikimin që ka ekonomia globale.⁹ Në këtë artikull, këta faktorë janë ndarë në disa kategori. Nga ana tjetër, duhet pasur në vëmendje se analizohen vetëm në rolin që luajnë në formatimin e politikave si produkte, si rezultate, pa u interesuar pse janë këto politika apo kush janë aktorët që i hartuan.

1. Ekonomikë. Ndryshimi i sistemit, e thënë ndryshe, ndryshimi i formës së shpërndarjes së të mirave materiale dhe shërbimeve, është shoqëruar gjithmonë me ndryshimet përkatëse në vlera e dije, si dhe në kërkesa për identifikimin

⁸ Bell L. & Stevenson H., 2006. “*Education policy: process, themes and impact*”, Routledge: Oxon, f. 8.

⁹ Ibid, f 7.

e legjitimitetit të tyre. Ristrukturimi i ekonomisë bën apel për krijimin e një sistemi arsimor shumë më tepër përgjegjës ndaj nevojave të tregut të punës, nëpërmjet ndryshimeve thelbësore në atë që mësohet dhe si mësohet. Në periudha të ndryshme të zhvillimit, na është dashur herë pas here të rishikojmë a korrektojmë sistemin tonë arsimor. Një shembull i thjeshtë është ndryshimi në strukturën institucionale të shkollave. Elmore (2011, U.F.O Press) mbështet mendimin se ndryshimet në arsim duhen parë nga pikëpamja institucionale.

Kështu, në periudhën pas Luftës së Dytë Botërore lindi nevoja për shkolla profesionale, si një mekanizëm që do të afronte shkollat më shumë me ekonominë si dhe do të siguronte një kurrikul më të përshtatshme për një kontigjent të caktuar nxënësish; disa vite më vonë, në vitet '950, lindi nevoja për kopshte për fëmijë, duke kontribuar në këtë mënyrë në zgjatjen e periudhës së kohës që fëmijët kalonin në shkollë dhe gërshtetuar marrëdhëniet shkollë-familje në nivele shumë të rëndësishme.¹⁰

2. Teknologjikë. Edhe ndryshimet teknologjike kërkojnë rishikimin e politikave arsimore dhe, në veçanti, të përparësive të ndryshme vendosur në kurrikul apo të stileve pedagogjike të të mësuarit. Dalja e teknologjive të reja ka ndryshuar modelet tona të stilit të përditshëm të jetesës, ka ristrukturuar në mënyrë pothuaj të pabesueshme punën dhe zakonet tona të përditshme, ka ristrukturuar klasën dhe mjedisin ku mësohet: dërrasat e zeza po zëvendësohen

¹⁰ Elmore R., 2011. "Reforma shkollore nga brenda jashtë. Politika, praktika dhe performanca", Tiranë: Albanian University Press, f. 28 - 29.

nga videoprojektorët, detyrat e shtëpisë shpesh dërgohen *online* dhe vetë notat, vlerësimet dhe frekuentimet e nxënësve mund të shihen nga prindërit në *web*. Shqetësimet e nxënësve tani bëhen objekt i një mase të pafund njerëzish – mjafton një postim në një faqe sociale, pak anglisht dhe nuk ka më të fshehta apo probleme lokale. Për të qenë i suksesshëm, më shumë se nota të mira në shkencat e sakta, të duhet të njohësh e zotërosh teknologjinë e duhur. Nga ana tjetër, pikërisht për shkak të kësaj teknologjie, mësuesit e dinë se nuk janë më i vetmi burim i besueshëm dijes, por më shumë një *guidë* e marrjes së tyre. Mësuesi autoritar po zëvendësohet me mësuesin e hapur ndaj ideve dhe mendimeve të reja. Nga ana tjetër, nëse keni mbaruar shkollën dhe jeni në kërkim të një vendi pune, do të shihni edhe si teknologjia ndikon në cilësitë që kërkohen për një vend të caktuar pune.

Mjafton të hidhni një vështrim përreth dhe do ta keni të lehtë të shihni se teknologjia redukton numrin e aftësive që kërkohen për një punë të veçantë, po në atë masë që rrit shkallën e aftësive të nevojshme për atë vend pune. Për ta bërë situatën më të thjeshtë, po sjellim shembullin e arkëtarit të dyqanit, i cili me një skaner në dorë kalon, sot, të gjitha mallrat e blera nëpërmjet barkodit të tyre, që do të thotë se, për të punësuar një punonjës të tillë sot, do t'i kërkonit të tjera njohuri matematike nga ato që kërkoheshin 50 vjet më parë, kur, për të përpiluar faturën, i duhej të bënte shumatoren e të gjitha vlerave të blera, të zbatonte taksën apo edhe uljen e çmimeve (sigurisht, kur kishte të tilla).¹¹

¹¹ Pierce M. & Stapleton D., 2011. "Drejtori i shkollës i shekullit XXI", Përktheu V. Nathanaili, Albanian University Press: Tiranë, f. 85.

Pra, edhe nëse përdorte një makinë llogaritëse, përsëri dijet e tij në matematikë duhej të ishin shumë më të mira e të avancuara se kolegu i tij sot, për të mos folur përpara 70 vjetësh, kur nuk ekzistonte fare ai aparat aq i vyer.

3. Socialë dhe kulturorë. Regjimet politike arsimore ngrihen në koherencë me ndryshimin e vlerave morale dhe vetë arsimit, si institucion social e ideologjik, vepron gjithmonë në sfondin e një strukture të dhënë sociale. Politikat arsimore nuk lindin nga hiçi. Pra, ndryshimet në strukturë, ndonëse ngadalë, mësojnë të pasqyrohen edhe në thelb.¹²

- **Ndërgjegjësimi i shoqërisë.** Një numër gjithmonë e më i madh aktorësh kërkojnë të përfshihen në hartimin e politikave arsimore; gjithmonë e më pak njerëzit po i lënë politikat vetëm në duart e politikëbërësve. Shoqatat e mësuesve e të prindërve, shoqatat e grupeve në minorancë apo njerëzve me aftësi të kufizuara, institutet e ndryshme në funksion të zhvillimit profesional, media dhe përdorimi i saj si instrument për referimin dhe diskutimin e çështjeve që na shqetësojnë, janë shembuj shumë të mirë të këtij ndryshimi. Akoma më tej: standardizimi i kurrikulës dhe centralizimi i saj janë në gjendje të na krijojnë një hartë të qartë të përfshirjes ose jo të fëmijëve në procesin e nxënies, gjë që mundëson edhe procesin e monitorimit të zbatimit të këtyre politikave nga një numër më i madh të interesuarish në këtë fushë. Në

¹² Elmore R., 2011. “Reforma shkollore nga brenda jashtë. Politika, praktika dhe performanca”, Përktheu V. Nathanailli, Albanian University Press, Tiranë: f. 28-29.

projektligjin “Për sistemin arsimor parauniversitar”, neni 25, pika 6, pohohet detyrimi që ka Ministria e Arsimit dhe e Shkencës për të publikuar raportin e arritjeve të sistemit arsimor parauniversitar për çdo vit shkollor dhe, në nenin 62 të po këtij projektligji, nga po kjo ministri kërkohet të sigurojë pjesëmarrjen e Shqipërisë në testime ndërkombëtare.

- **Hapja gjithmonë e më madhe e vendeve dhe shkëmbimet kulturore.** Aderimi i vendeve në konventa e marrëveshje të ndryshme përfshin edhe arsimin e, bashkë me të, edhe politikat e tij, pasi vë përballë vlerat globale me ato lokale, atë që kërkojmë të gjithë të arrijmë me atë që jemi mësuar të arrijmë. Zgjerimi i arsimit bazë, sipas Sen, ndikon në përmirësimin e debateve publike, ndërkohë që, zgjerimi i arsimit femëror, mund të reduktojë pabarazinë gjinore në shpërndarjen brenda familjes dhe, gjithashtu, në uljen e normave të pjellorisë apo të vdekshmërisë foshnjore. Këto arritje instrumentale mund të jenë thellësisht të rëndësishme ...¹³
- **Lëvizjet demografike.** Lëvizjet nga një qytet në tjetrin dhe përqendrimi i tyre në zonat urbane solli, për rrjedhojë, rritjen e numrit të nxënësve në klasa (kujtoni klasat me 50-55 nxënës). Me synimin për t’i mbajtur adoleshentët larg rrugës dhe tregut të punës, politikat e kësaj kohe përqendrohen në krjimin e shkollave të mëdha dhe në mundësitë për akomodimin e një numri sa më të madh nxënësish në

¹³ Sen A., 2011, “Zhvillimi si liri”. Tiranë, Albanian University Press, f. 329.

mjediset e tyre, përdorimin e kujdesshëm të fjalorit nga ana e mësuesve për të mos krijuar konflikte etnike apo gjetjen e përdorimin e metodave më të përshtatshme mësimdhënieje e nxënieje. Mësuesit, shpesh të paorientuar, rrjedhojë e mungesës së përvojës apo rezistencës ndaj ndryshimit, gjenden përpara zgjedhjeve të vështira se çfarë është e drejtë dhe e gabuar apo si duhet t'i këshillojnë dhe orientojnë nxënësit.

- **Stilet e reja të jetesës**, shoqëruar me ndryshime të theksuara në mënyrat tona të të sjellit ndaj autoritetit, ka rritur trysninë për ndryshime në arsim. Një dukuri e tillë vihet re veçanërisht tek të rinjtë, përqendruar kryesisht në zona të zhvilluara urbane, të rritur në familje ku rolet prindërore dhe raportet fëmijë/prind janë larg normave të ngurta e autoritare të këtyre marrëdhënieve. Këto raporte pasqyrohen edhe në marrëdhëniet që kërkojnë të krijojnë në shkollë. Për më tepër, mësuesi nuk është i vetmi i rritur me të cilin ata ndërtojnë kontakte gjatë një dite shkolle. Rritja e numrit të lidhjeve të krijuara shoqërohet me një zbehje të autoritetit klasik të mësuesit, me një konceptim të ri të disiplinës apo edhe mënyrës së bindjes ndaj saj.

Shkolla më të mira, do të thotë një arsimim më i mirë. Duke e vendosur fokusin në politikat që e bëjnë një shkollë dhe shkollim sa më cilësor, ne kërkojmë që roli i tyre të shkojë përtej atij të formimit të kapitalit njerëzor si mjet për prodhimin e të mirave materiale, duke i dhënë

zhvillimit karakter social: falë një arsimimi më të mirë, është e natyrshme të presim që edhe arritjet e një personi të jenë më të mira, mundësitë për të drejtuar jetën e tij më të shumta, zgjedhjet më të mirinformuara dhe, duke vazhduar me gjuhën e Sen, fjala e tij merret më seriozisht nga të tjerët.¹⁴

Studime sociale, vëll. 6, nr. 3, 2012

¹⁴ Ibid, f. 326.

MENDIME PËR PROJEKTLIGJIN E RI “PËR SISTEMIN ARSIMOR PARAUNIVERSITAR”¹

Projektligji për sistemin arsimor parauniversitar që pritet të miratohet së shpejti, është, pa dyshim, shumë më i plotë dhe gjithëpërfshirës se ligji aktual, nr. 7952 (i ndryshuar), është më i strukturuar dhe vjen tamam në kohë – edhe pak na ndajnë nga fillimi i vitit të ri shkollor. Është një projektligj që përpiqet t’i përgjigjet më së miri realitetit shqiptar: me shkolla private e publike, shumë nga të cilat në rikonstruksion, të tjera gati për të hapur dyert e të tjera akoma projekt në letër; me mësues e nxënës që zhvendosen nga një qytet a shkollë në tjetrën; me prindër, në dilemën e zgjedhjes së shkollës dhe arsimimit më të mirë për fëmijët e tyre dhe me vendimmarrës që, ndoshta nuk kanë asnjë lidhje direkte me shkollën, po që hera e solli të jenë në anën e atyre që hedhin firma në projektligje që shndërrohen në ligje, që me shpresën tek zoti (të më falin besimtarët) do të zbatohen. Sidoqoftë, realiteti më sipër nuk është vetëm shqiptar. Nevoja themelore për të nxënë dhe mënyrat e plotësimit së saj diskutohen e ndeshen

¹ *Shënim:* Tani njihet si ligji “Për arsimin parauniversitar” nr. 69/2012 dhe gjendet në web.

në të gjithë botën. Në një botë në ndryshim, në mënyrë të pashmangshme, perceptimet tona kanë nevojë të ripërtërihen, gjykimet t'i nënshtrohen analizave që pasqyrojnë realitetet e reja dhe teoritë, në garë me teknologjinë, të zgjerojnë vizionet. Interneti ka ndryshuar përgjithmonë mënyrat tona të komunikuarit e të jetuarit: teorikisht dhe virtualisht ne jemi në gjendje, për intervale jashtëzakonisht të vogla të kohës, të mësojmë rreth njerëzve, vendeve e kulturës së tyre. Por, pavarësisht vendit a kulturës, të gjithë konvergjojmë në të njëjtin objektiv: që të gjithë fëmijët, të rinjtë e të rriturit, kanë të drejtën të marrin një arsim që përmbush nevojat e tyre themelore për të mësuar në kuptimin më të mirë dhe të plotë të termit, një arsim që përfshin mësimin për të ditur, për të bërë, për të jetuar dhe qenë së bashku; një arsim, që zbulon dhe nxit talentet dhe potencialet e çdo individi, që zhvillon personalitetet dhe është në gjendje, në këtë mënyrë, të ndihmojë në përmirësimin e jetës dhe transformimin e shoqërisë ku jetojnë (Pjesë nga deklarata botërore “Arsim për të gjithë”, Jomtien, 1990).

Është për t'u theksuar se në krahasim me ligjin aktual, projektligji zgjeron dhe pasuron misionin e sistemit arsimor parauniversitar, në përkrahje të barazisë dhe mundësive për të gjithë; fokusohet në nxënie dhe vlerësimin e arritjeve, duke i dhënë një vend të veçantë provimeve shtetërore dhe atyre të ndërmjetme në nivele të ndryshme të shkollimit; shumë nga aktet nënligjore të nxjerra në zbatim të ligjit, kanë zenë vend në projektligj; trajton më seriozisht detyrat e të drejtat e mësuesve dhe drejtuesve, duke u dhënë këtyre të fundit një status plotësisht të përcaktuar.

Duke qenë në fazën e diskutimit, mendoj se disa çështje, nga mënyra si janë trajtuar dhe nga rëndësia që mbartin, kanë nevojë të riformulohen, pa anashkaluar këtu edhe një

detaj “të vogël”: projektligji duhet riparë edhe një herë nga pikëpamja gramatikore!

1. Në nenin 3, “Përkufizime”, pika n, jepet përkufizimi i nxënësve me nevoja të veçanta: “nxënës me nevoja veçanta do të thotë nxënësi, i cili, si rezultat i dëmtimeve të ndryshme fizike, mendore, shqisore, të sjelljes ose të kombinuara, mund të pengohet të marrë pjesë në mënyrë të plotë dhe efektive në shkollë dhe në jetën e përbashkët”.²

Por, një përkufizim i tillë është vetëm në termat e dëmtimeve, të mungesës apo të paafetësisë (fizike, mendore, emocionale etj). Përkufizimi që jep projektligji mund të përshkruajë pothuaj mirë nxënësit me aftësi të kufizuara, ndërkohë në deklaratën e Salamankës, Spanjë, 10 qershor 1994 (dalë nga konferenca “Arsim për të gjithë”), në nxënës me nevoja të veçanta, përveç rasteve të listuara në projektligjin tonë, përfshihen, gjithashtu, edhe nxënësit që:

- paraqesin vështirësi, të përkohshme ose të përhershme, në shkollë
- shfaqin mungesë interesi ndaj mësimit ose janë të pamotivuar për të nxënë
- janë të detyruar të punojnë
- jetojnë në rrugë
- banojnë shumë larg nga shkolla
- jetojnë në varfëri ose vuajnë nga kequshqyerja
- janë viktime të luftës ose të konflikteve të ndryshme

² Në ligjin e aprovuar, përkufizimi është riformuluar dhe ka marrë këtë formë: “Nxënës me aftësi të kufizuara” është personi, i cili ka dëmtime afatgjata fizike, mendore, shqisore, të sjelljes ose të kombinuara, që, në ndërveprim, mund ta pengojnë të marrë pjesë në mënyrë të plotë dhe të barabartë në arsimimin e tij dhe në jetën shoqërore.

- vuajnë në mënyrë të vazhdueshme nga dhuna fizike, emocionale apo abuzimi seksual
- thjesht nuk ndjekin shkollën, pavarësisht arsyes.

Të gjithë këtyre fëmijëve, për shumë arsye, objektive e subjektive, u mohohet ose u zvogëlohet mundësia, në krahasim me bashkëmoshatarët e tyre, të mësojnë e të marrin njohuri. Për rrjedhojë, të gjithë këta fëmijë janë me nevoja të veçanta: mësojnë shumë më pak, janë shpesh të pangrënë dhe të shtyrë diku, në skajin më periferik të vëmendjes e kujdesit. Kuptohet se, origjina e vështirësive të tyre nuk gjendet tek vetë ata, por tek mjedisi social në të cilin jetojnë. Për t'i bërë edhe këta fëmijë pjesë të misionit të sistemit arsimor parauniversitar, kërkohen ndryshime në terminologji, të cilat të mund të pasqyrohen në ndryshime në politika dhe praktikë. Për rrjedhojë, koncepti i nxënësve me nevoja të veçanta duhet të zgjerohet, ku të përfaqësohen të gjithë fëmijët që, për një arsye a tjetër, nuk arrijnë të përftojnë nga shkolla. Më tej, pjesë e detyrës sonë është të identifikojmë mënyrat me të cilat shkolla, si pjesë e mjedisit social, do të jetë në gjendje të krijojë mundësitë më të mira për të mësuar për të gjithë fëmijët.

Pra, kuptimi që i jep projektligji ‘nxënësit me nevoja të veçanta’ është shumë i vjetër dhe ka mospërputhje ndërmjet emërimit dhe përshkrimit. Në vitet ‘980, “nxënës me nevoja të veçanta” përkufizohej nxënësi me “shance të kufizuara ose të munguara për të marrë pjesë në jetën normale në shkollë në nivele të barabarta me të tjerët, si rezultat i barrierave sociale dhe fizike”. Por, shumë shpejt, u hoq dorë nga një kuptim i tillë pasi kishte paqartësi në kuptimin e ‘jetë normale’. Një përkufizim më i plotë mund të jepet në

trajtën: “nxënës me nevoja të veçanta është nxënësi që ka një ndërveprim negativ me mjedisin”. Sigurisht që po aq drejt duhet kuptuar edhe koncepti lidhur me mjedisin, si: tërësia e qëndrimeve, legjislacionit, sistemit e shërbimeve sociale, produkteve natyrore apo atyre të krijuara nga dora e njeriut. Duke dhënë një përkufizim të tillë, kreu XII: “Fëmijët me nevoja të veçanta” tenton të përfshijë e marrë në mbrojtje të gjithë fëmijët që kanë nevojë për të.

2. Në nenin 26, “Funksioni i Këshillit Kombëtar i Arsimit Parauniversitar”, pika 1, shkruhet: Këshilli Kombëtar i Arsimit Parauniversitar (më tutje “KKAP”) është organ këshillimor i Ministrisë së Arsimit dhe Shkencës dhe i Këshillit të Ministrave për politikën e zhvillimit të Sistemit Arsimor Parauniversitar dhe, pika 4: KKAP-i përbëhet nga 23 anëtarë, si më poshtë vijon: Ministri i Arsimit dhe Shkencës, përfaqësues nga njësitë arsimore vendore, përfaqësues nga ministritë, përfaqësues i shoqatës së bashkive, përfaqësues i shoqatës së komunave, përfaqësues i shoqatës së këshillave të qarqeve dhe anëtarë të tjerë, personalitete të mirënjohura për kontribute të shquara në jetën publike. KKAP-i kryesohet nga Ministri i Arsimit dhe i Shkencës.³

³ Në ligjin e aprovuar është neni 29 “Këshilli Kombëtar i Arsimit Parauniversitar”. Në pikën 4, Këshilli Kombëtar i Arsimit Parauniversitar kryesohet nga ministri dhe përbëhet nga katërmëdhjetë anëtarë, me këtë përbërje: a) përfaqësuesi i Ministrit të Financave; b) përfaqësuesi i Ministrit të Brendshëm; c) përfaqësuesi i Ministrit të Çështjeve Sociale dhe Shansëve të Barabarta; ç) një përfaqësues i shoqatës së bashkive me numrin më të madh të bashkive; d) një përfaqësues i shoqatës së komunave me numrin më të madh të komunave; dh) dy përfaqësues nga partnerët socialë; e) një përfaqësues i shoqatës kombëtare të prindërve; ë) gjashtë personalitete të njohura për kontribute në fushën e arsimit, shkencës dhe në jetën publike, të cilët zgjidhen me konkurrim publik. Po t’i mbledhësh, bashkë me Ministrin e Arsimit dhe të Sportit bëhen 15 anëtarë, jo 14! Lapsus!?

Ngritja e institucioneve të ndryshëm këshillimor, në ndihmë të vendimmarrjes së titullarit, është një praktikë që ndeshet pothuaj në të gjithë vendet evropiane. Një këshill i tillë gjendet në Spanjë, nën emërtimin "Këshilli Arsimor Shtetëror"; në Francë si "Këshilli Arsimor Superior"; në Austri si "Këshilli i Reformës Shkollore". Por, nëse nga vendi në vend, funksionet janë pothuaj po ato, politikat dhe strategjitë që lidhen me përbërjen (pika 4 në nenin tonë) kanë pothuaj të gjitha të përbashkët përfshirjen e mësuesve. Në Itali, Këshilli Kombëtar i Arsimit përbëhet nga 74 anëtarë, nga të cilët 47 janë mësues të të gjitha niveleve (ose afro 63%).* Në Këshillin tonë Kombëtar të Arsimit, sipas përkufizimit të projektligjit, nuk ka asnjë mësues, asnjë drejtor shkolle ose asnjë punonjës shkollor pra, asnjë person që është i lidhur direkt me shkollën dhe jetën e saj, me problemet e përditshme, me sukseset e dështimet, me nxënësit që mungojnë, me tekstin që ka probleme, me rezultatet e ulëta në testin përfundimtar, me mësuesin që nuk ka ardhur në mësim dhe nuk ka lajmëruar ende, me klasën pa ngrohje. Vini re se nuk kam përdorur asnjë fjalë të tillë si kurrikul, politikë, përgjegjshmëri, përgjegjësi, plan, program etj. Por janë mësuesit e drejtorët e shkollave që përballen me produktet e këtyre politikave, planeve e strategjive e janë ndoshta të vetmit të aftë e të interesuar për të na bërë me dije se çfarë ndodh atje poshtë, në shkollë, ku kërkohet e pritët që të gjithë këta elementë të shndërrohen në produkte, në rezultate e performancë të matshme. Do të ishte mirë që në përbërje të KKAP-së, të shtohet edhe pjesëmarrja e mësuesve, drejtuesve të

* Shënim: Golemi, B., prof. dr., "Komisioni Kombëtar për arsimin", *Administrimi & Menaxhimi i Arsimit*, Botues ISP, Nr. 3, 2002, f.57-80.

shkollave ose përfaqësuesve të universiteteve që kanë fakultete edukimi. Nëse vendoset që përbërja e këtyre të fundit të jetë në masën 50%, atëherë numri i anëtarëve të KKAP-së shkon në 46.

3. Neni 66, "Emërimi dhe lirimi nga detyra i drejtorit të institucionit arsimor", pika 2, b) shprehet se "drejtori mund të lirohet nga detyra pa përfunduar mandatin kur arrijtjet e nxënësve, në provimet e arsimit bazë ose të maturës shtetërore, për dy vite shkollore të njëpasnjëshme, janë në 10% e fundit në renditjen e shkollave në nivel kombëtar".⁴ Fillimisht duhet të përgëzohen hartuesit e projektligjit për statusin që u kanë dhënë drejtorëve të shkollave. Të shpresojmë se nuk do të ndryshohen më sa herë ndryshojnë drejtorët e drejtorive arsimore, që do të thotë sa herë ndryshojnë ngjyrat e partisë në pushtet. Tani, çfarë ndodh jo me drejtorin pasi shkolla ka dështuar, por me vetë shkollën e dështuar? Logjika thotë se do të vijë një drejtor tjetër. Arsyetimi më pesimist është që edhe nën drejtimin e këtij drejtori, përsëri të plotësohen kushtet për lirim të tij nga puna pa përfunduar mandatin për të njëjtën arsye, sikurse edhe paraardhësi. Do të thotë që shkolla dështon për katër vjet rradhazi në testet që masin performancën e saj. Arsyetimi mund të vazhdojë me të njëjtin pesimizëm edhe më tej. Çfarë parashikon ligji? Asgjë! Çfarë pasojash kemi? Asnjë! Vetëm drejtori që lëviz nga një shkollë në tjetrën (sepse përsëri ligji nuk thotë asgjë edhe për këtë drejtor). Do të vazhdojë kjo shkollë të punojë me

⁴ Në ligjin e aprovuar është neni 55 "Emërimi dhe shkarkimi i drejtorit të institucionit arsimor", pika 3: "Titullari i njësisë arsimore shkarkon drejtorin e institucionit arsimor publik për shkelje të dispozitave të këtij ligji dhe akteve të tij nënligjore, shkelje të etikës e të sjelljes në institucion, si dhe për mosrealizime të institucionit."

të njëjtin plan, me të njëjtën kurrikul, me të njëjtët mësues, me të njëjtat fonde sikundër edhe shkollat e tjera që në provimet e arsimit bazë ose të maturës shtetërore, për dy vite shkollore të njëpasnjëshme, janë në 10% e parë në renditjen e shkollave në nivel kombëtar? Nuk kemi përgjigje. Sigurisht, në një shkollë të tillë do të duhet shumë më tepër punë që në vitin pasardhës, kur t’i nënshtrohen të njëjtit test që i nënshtrohen edhe shkollat e suksesshme, të arrijnë rezultate të mira. Por ligji nuk parashikon ndonjë plan për korrigjimin apo rehabilitimin e saj, nuk flet për objektiva përmirësimi, për ndryshimin e statusit të shkollës në krahasim me shkollat e tjera, për ndërtimin e ndonjë strategjie ndërhyrjeje që do të lehtësonte e ndihmonte punën e të gjithë komunitetit shkollos apo për modelim të fokusit të punës, duke e orientuar në cilësinë akademike dhe performancën e nxënësve. Ligji parashikon vetëm masa për individin, dhe kaq! Trysnia për të rritur përgjegjshmërinë e shkollës nuk duhet të kufizohet dhe të mbetet vetëm tek drejtori. Problemet e përmirësimit të shkollave janë komplekse dhe shkojnë përtej lëvizjes së një drejtori. Sepse vetë përmirësimi është proces, jo rezultat. Do të ishte më shumë se naive të mendonim që lëvizja e drejtorit do të zgjidhte situatën.

4. Kreu XI, “Nxënësit, prindërit”, neni 75, “Prindërit”, pika 3, a), shprehet se prindërit duhet të kujdesen që fëmija i tyre të ndjekë rregullisht institucionin arsimor dhe të arsyetojnë ose paralajmërojnë çdo mungesë të fëmijës së tyre në veprimtaritë e institucionit arsimor⁵ dhe, në kreun XV, “Kundërvajtjet

⁵ Në ligjin e aprovuar është neni 62 “Të drejtat dhe detyrat e prindërve”. Pika 3 është riformuluar: a) të kujdeset që fëmija i tij të ndjekë rregullisht institucionin arsimor dhe të mësojë rregullisht; b) të njoftojë për ndryshime të shëndetit dhe të sjelljes së fëmijës së tij;

administrative”, neni 86, “Mungesat”, shkruhet: Mungesa e nxënësit në mësim, në moshën e arsimit të detyrueshëm, për më shumë se 25 për qind të orëve mësimore gjithsej, gjatë një viti shkollos, që nuk arsyetohen nga prindi i tij, vlerësohet si rast i neglizhencës prindërore dhe trajtohet në përputhje me ligjet përkatëse të Republikës së Shqipërisë.⁶

Në shoqërinë tonë, mbas burgjeve e spitaleve publike, shkollat janë institucionet sociale më patologjike. Por, përpos kushteve ekonomike, sociale e politike, në zgjidhjen e shumë problemeve, një ligj i shkruar me kujdes, është një aleat shumë i mirë. Ligj i mirë është ai që jo vetëm tregon se çfarë duhet bërë, por edhe *si* duhet bërë, shtjellon mënyrat, përcakton burimet e financimit, zgjeron vizionin, tregon partnerët. Mësuesit bëjnë atë që dinë të bëjnë dhe, ajo që dinë të bëjnë, jo gjithmonë është më e mira; shpesh prindërit duan, por nuk dinë dhe nuk kemi arsye të kërkojmë sa kohë nuk u kemi treguar mënyrat e funksionimit. Prindi duhet të kujdeset që fëmija të ndjekë shkollën, por cila është masa e kujdesit? Në rastin e mungesave, kujdes do të thotë asnjë mungesë pa arsye? Por çfarë mund të themi për prindin që mbarimi apo vetë regjistrimi në shkollë i fëmijës nuk është në listën e gjërave që duhen bërë? (Apo që nuk ka listë fare!) Në mungesë të një drejtimi a udhëzimi, mësues e prindër do të vazhdojnë të bëjnë atë që kanë bërë gjithmonë. Dhe ne, si gjithmonë, do të vazhdojmë të raportojmë për mungesa pa fund që bëhen në shkolla apo për braktisjen e saj dhe analfabetizmin që po kthehet në një shqetësim real. Ligji i kujdesshëm nuk pret që të mbarojë viti shkollos dhe ta çojë prindin në gjykatë për neglizhencë

⁶ Në ligjin e aprovuar, në thelb ka të njëjtën formë. Në ligjin e aprovuar është neni 68 “Ndjekja e arsimit të detyrueshëm”.

prindërore (në Shqipëri unë nuk di ndonjë rast të tillë), por përmban të gjitha sistemet dhe procedurat e kërkimit të llogarisë, të bashkëpunimit shkollë-prindër, të fazave të këtij bashkëpunimi, u jep rol të qartë autoriteteve vendore. Që një nxënës të mungojë më shumë se 25 për qind të orëve mësimore dhe të gjitha të jenë të pajustificuara nga prindi, më e pakta për të cilën mund të akuzohet shkolla është papërgjegjshmëri.

5. Në nenin 88, “Hapja e institucioneve arsimore private në kundërshtim me ligjin”, shkruhet: Hapja e institucioneve arsimore private dhe e institucioneve arsimore private plotësuese në kundërshtim me kriteret e përcaktuara në dispozitat e këtij ligji përbën kundërvajtje administrative. Kundërvajtësit në çdo rast dënohen me gjobë, përkatësisht, 500 000 lekë dhe 200 000 lekë, deri me ndërprerje të veprimtarisë së filluar. Patjetër që duhet të riformulohet.⁷ Hapja e një shkolle private, në shkelje të kërkesave të ligjit, duhet të përbëjë vepër penale dhe të dënohet, jo vetëm me gjobë, por edhe me heqje lirie. Këtë masë jep ligji anglez “Për arsimin dhe aftësitë 2008”, për këdo që hap ose drejton një shkollë në kundërshtim me ligjin: neni 96 konsideron se ka kryer vepër dhe e dënon jo më pak se 51 javë burg dhe gjobë. Politika e faktit të kryer nuk duhet të funksionojë me shkollat.

Hartimi i një ligji të ri për sistemin arsimor parauniversitar është i një rëndësie tepër të veçantë, që

⁷ Në ligjin e aprovuar është riformuluar. Është neni 69. Ka marrë trajtën: Kundërvajtësi dënohet me dënim administrativ kryesor gjobë, në vlerën nga 500 000 deri në 1 000 000 lekë, dhe me dënim administrativ plotësues “ndërprerjen e menjëhershme të veprimtarisë”. Pra, është shtuar fjala ‘kryesor’ që do nënkupton se mund të ketë edhe forma të tjera dënimi, sikundër është rritur edhe masa e gjobës.

duhet të shqetësojë jo vetëm punonjësit e sistemit arsimor e prindërit që kanë fëmijët në shkollë, por të gjithë shoqërinë. Është një nismë që duhet përshëndetur e përkrahur, sepse lidhet me shpresën tonë për mësues më kompetentë, për drejtues më me vizion, për një shkollë që u mëson fëmijëve çfarë duhet të dijnë dhe për çfarë duhet të jenë të aftë, për një arsimim më të mirë.

“Optime” nr. 3, korrik 2011

“Reforma dhe legjislacioni në arsimin parauniversitar.

Çështje, praktika & politika. Rasti shqiptar.”

Autor Valbona Nathanaili U.F.O Press,

dhjetor 2011, f. 221–6.

SFIDA TË SHOQËRISË CIVILE

Është bërë pothuaj e natyrshme në ditët tona përdorimi i termit shoqëri civile. Ne i drejtohem shoqërisë civile sa herë e kemi të pamundur të gjejmë zgjidhjen e një problemi, me bindjen se me njerëzit e mençur që ka do të ofrojë zgjidhje po aq të mençura, bindje e krijuar në vitë të tëra punë me pasion e sakrifica.

Termin shoqëri civile e hasim që në lashtësi, si nga filozofët grekë, ashtu edhe ata romakë, duke nënkuptuar me shoqëri civile vetë shtetin. Më vonë termi merr kuptime të shumëfishta, por esenciale është ndarja që bën me shtetin. Në këtë divorc me shtetin të shpallur për herë të parë nga Hegel, fillimisht shoqëria civile u përkufizua si një grup njerëzish të mbledhur rreth një ideje apo dëshire që punojnë vullnetarisht për realizimin e saj.

Sot, në kohën e demokracisë dhe globalizimit, shoqëria civile e zgjeron gjithmonë e më shumë rrezet e rrethit, duke përfshirë në të edhe shoqatat e ndryshme që punojnë në fushën e të drejtave, sindikatat, organizatat e ndryshme joqeveritare etj.

Shoqëria civile bëhet veçanërisht e fuqishme në vendet e ish-bllokut komunist në vitet '90 ku shteti, me apo pa dashje, ruante elementë të theksuar diktatorialë, duke demonstruar paaftësi të dukshme në realizimin e detyrave të tij karshi qytetarëve. Sa më i dobët është shteti, aq më e fuqishme duhet shoqëria civile, pasi shndërrohet në të vetmen hallkë në gjendje të luftojë për kauza të ndryshme.

Sidoqoftë, shoqëria civile në asnjë mënyrë nuk duhet të identifikohet vetëm me organizatat e ndryshme joqeveritare që veprojnë në gjirin e saj. Pa dashur të ul vlerat e këtij sektori, po sjell shembullin e një projekti të hartuar nga një prej këtyre organizatave. Thelbi ishte pak a shumë ky: fëmijët që kishin braktisur shkollën do të ktheheshin në të duke ju dhënë familjeve të tyre ndihma ushqimore. Çfarë ndodhi? Fillimisht ideja funksionoi, për sa kohë kishte mbështetje financiare. Pastaj të dyja palët nuk kishin më interes. Nga njëra anë prindërit praktikë e mësuan shumë shpejt leksionin: më jep ushqime gratis që ta çoj fëmijën në shkollë, përndryshe e hoqa! Unë nuk jam e sigurt se deri ku shkon dashuria e prindërve të tillë për shkollën, por e di se nevoja për të ushqyer fëmijët e për t'i rritur është më e rëndësishmja. Kur nuk pati më ndihma ushqimore, fëmijët u kthyen përsëri në rrugë, në punë e në shtëpi. Nga ana tjetër, edhe përgjegjësit e këtij projekti janë në rregull me donatorin: ne e bëmë punën ... mijëra dollarë për një kothere bukë.

Edhe një projekt tjetër i ngjashëm, realizuar po nga një organizatë jo-fitimprurëse. Thelbin e këtij projekti e dëgjova disa ditë më parë, në një tavolinë të rrumbullakët organizuar për fëmijët e ngjuar. Një nga pjesëmarrësit, jo pa krenari deklaroi se kishte realizuar një projekt që çonte

ndihma ushqimore tek çdo familje e ngjuar, se kishte statistika të familjeve të ngjuara në veri të vendit, fotografi të grave të veja e fëmijëve të mbetur jetimë. Sigurisht që gjithkush është gati të ndihmojë një familje në nevojë – është humane të kesh një ndjenjë të tillë, prandaj ekzistojnë organizata të tilla si ajo e Kryqit të Kuq apo të tjera me natyrë filantropike, por vetëm kaq nuk mjafton.

Të dy shembujt sugjerojnë se koncepti i besimit që kemi ndaj këtyre organizatave nuk i përjashton nga përgjegjësia, sikur edhe vetëm morale, që kanë ndaj nesh. Vërtet që gjendja është shumë e vështirë në shumë zona të vendit, por nuk mund të shërbejë si shkak për të legjitimuar çdo lloj projekti e ideje apo për ta reduktuar rolin e tyre në atë të një ndërmjetësi.

Shoqëria civile është më shumë se bamirësi e çastit, e cila vetëm largon vuajtjen, por nuk e zgjidh atë. Shoqëri civile do të thotë qytetarë të mbledhur së bashku që përpiqen të fitojnë hapësirën e të drejtave të tyre të kufizuara pa të drejtë nga shteti apo struktura të tjera; do të thotë zgjidhje e problemit ose propozim për zgjidhje, që me instrumentat e veta, përfshirë por jo kufizuar në ndërgjegjësimin e pjesës tjetër të shoqërisë, i imponohen shtetit për të ndërmarrë hapa konkretë.

Gazeta "Shekulli"

HISTORIKU I ARSIMIT SPECIAL NË SHQIPËRI

Histori dhe legjislacion

Deri më vitet '980 historia e arsimit special në Shqipëri nuk ka pothuaj asgjë për të thënë: fëmijët dhe, në përgjithësi, individët me aftësi të kufizuara, mbaheshin larg syve të shoqërisë. Mundësitë që ofroheshin nuk ishin shumë: mbylleshin ose në shtëpi, ose në institucione të specializuara, që administroheshin nga Ministria e Shëndetësisë. Në të dyja rastet, kujdesi kufizohej vetëm në pikëpamje fizike. Nuk mund të flitej për programe të mirëfillta arsimimi, për zhvillim social apo integrimin e tyre në mënyrë të specializuar. Për më tepër, duke qenë se numri i këtyre institucioneve ishte shumë i vogël, pjesa më e madhe e këtyre individëve, kryesisht ata që vuanin nga shëndeti mendor, mbylleshin në spitale psikiatrike.

Më 1983, Këshilli i Ministrave vendosi hapjen dhe funksionimin e katër shkollave për fëmijët me paaftësi të lehta mendore. Këto shkolla funksiononin pranë shkollave normale, ishin të ngjashme në strukturë me to, vetëm se

numri i fëmijëve për klasë ishte më i vogël, kishin nga dy mësues si dhe kishin përshtatur disa metoda speciale.

Përpjekjet e shumë prindërve, avokatia që i bënë çështjes së fëmijëve të tyre, çuan në krijimin e qendrave të ndryshme ditore dhe, më 1994, kalimin e varësisë dhe administrimit nga Ministria e Shëndetësisë, tek ajo e Punës dhe e Çështjeve Sociale. Ndryshimi i varësisë u shoqërua me një varg ndryshimesh pozitive: krahas doktorëve, pjesë e stafit u bënë edhe psikologët, terapistët dhe arsimtarët, që do të thotë akoma se, krahas kujdesit shëndetësor, një rëndësi e veçantë i kushtohet edhe zhvillimit social dhe emocional të individit, më shumë kontakte me familjarët etj.

Ndryshimet shoqërore çuan gradualisht edhe në zgjerimin e konceptit për fëmijët me aftësi të kufizuara, duke e zgjeruar rrethin e përfshirjes dhe, në të njëjtën kohë, duke kërkuar zgjidhje jo vetëm mjekësore, por edhe sociale, pra, duke i kthyer sytë nga shkollat dhe mësuesit. Ideja e një shkolle përfshirëse po bëhet nga dita në ditë mbizotëruese edhe në vendin tonë, sikundër në shumë vende të botës.

Më 1995, në ligjin nr. 7952, datë 21.06.1995, “Për sistemin arsimor parauniversitar”, në kreun III, i kushtohet një vëmendje e veçantë arsimit special publik. Kështu, në nenin 39.1 shkruhet: Arsimi special publik është pjesë përbërëse e sistemit arsimor publik në Republikën e Shqipërisë dhe, në nenin 39.2, shkruhet: Arsimi special publik synon që nëpërmjet përdorimit të formave dhe metodave të veçanta të sigurojë zhvillimin sa më të plotë të mundësive të personave që paraqesin paaftësi fizike, mendore ose emocionale, në përputhje me nevojat e tyre

dhe kërkesat për një jetë sa më dinjitoze. Kreu për arsimin special publik përmban edhe tri nene të tjera, ku theksohet arsimimi falas i kësaj kategorie fëmijësh, si dhe kërkohet përgatitja e një kuadri mësues sa më të kualifikuar.

Edhe ligji i ri “Për sistemin arsimor parauniversitar”, i kushton vëmendje këtyre fëmijëve në kreun XI (nenet 63, 64, 65) dhe duket se ka bërë një hap më përpara, pasi nuk flet vetëm për shkolla speciale publike, por edhe për përfshirje, ndonëse lë ekuivoke. Përkatësisht, në nenin 63, pika 2, kërkohet: “Përfshirja e fëmijëve me aftësi të kufizuara në institucionet arsimore të specializuara për ta është përgjithësisht e përkohshme. Përfshirja dhe integrimi i fëmijëve me aftësi të kufizuara në kopshtet dhe shkollat e zakonshme të arsimit bazë është parësore”, ndërkohë që në nenin 64, pika 2 thuhet se: “Nxënësi me aftësi të kufizuara qëndron në shkolla të specializuara deri në moshën 19 vjeç.”

Integrimi, vlerësimi dhe aftësimi i tyre. Konceptet e reja të integrimit

Në shumë dokumente ndërkombëtarë bëhet apel për përfshirjen e këtyre fëmijëve në klasat e zakonshme të shkollave publike. Parimi i përfshirjes kërkon, sigurisht, angazhime të mëdha, jo vetëm nga mësuesit, por nga gjithë sistemi, kërkon ndryshimin e vetë konceptimit tonë për të mësuarin: nga mësimdhënie për të gjithë nxënësit dhe të së njëjtës përmbajtje, në mësimdhënie për secilin dhe në përputhje me nevojat individuale. Nxënësi të ndryshëm kanë interesa të ndryshme, manifestojnë nevoja dhe sjellje

të veçanta, reagojnë emocionalisht ndryshe; disa kanë nevojë për më shumë ndihmë, për më shumë mbështetje; disa janë të tronditur apo janë viktimë të dhunës. Detyra jonë është përshtatja emjedisit të nxënies në përputhje me nevojat dhe aftësitë e çdo nxënësi.

Aspektet kryesore ku duhet të fokusohemi lidhen me: nxënësin, kornizën, synimet, përmbajtjen, metodat dhe organizimin, vlerësimin, komunikimin dhe kujdesin. Nëse aspektet e para lidhen me kurrikulën klasike, dy të fundit, komunikimi dhe kujdesi, lidhen me frymën e re që kërkon arsimi special. Me pak fjalë, kemi nevojë të rikonceptojmë objektivat, mësimdhënien dhe kurrikulën nëse duam të zbatojmë një qasje përfshirëse. Duhet të kuptojmë se shkollat dhe qendrat e shtrenjta speciale jo vetëm nxisin ndarjen dhe izolimin, por nuk janë në gjendje të plotësojnë nevojat për arsim dhe trajnim të të gjithë fëmijëve me nevoja të veçanta.

Komunikimi, dialogimi, ndërmjetësimi dhe kujdesi i veçantë janë fjalët çelës në teoritë dhe kërkimet shkencore për arsimin special. Teoricienë të ndryshëm theksojnë se fëmijët nxënë përmes ndërveprimit me bashkëmoshatarët, të rriturit dhe me mjedisin në të cilin jetojnë. Për rrjedhojë, komunikimi është një nga mjetet më të mira në zhvillimin e proceseve konjitive. Komunikimi dhe teoritë e ndërmjetësimit, nëse do të jenë në qendër të kurrikulës, do të ndikojnë pozitivisht tek individët e vetë klasa. Fëmijët paraqesin shpesh vështirësi, pikërisht sepse kanë vështirësi në komunikim.

Një pyetje tjetër, që shoqëron kërkesën për përfshirje, është sa mundësi do të kemi të organizohemi në një klasë të tillë, kaq heterogjene në nevoja, aftësi e komunikim? Si

mund të sigurohemi se jemi aq sa duhet fleksibël në punën tonë, aq sa të kemi plotësuar nevojat e të gjithë fëmijëve?

Trendet e reja në arsim

Qasja tradicionale	Qasja përfshirëse
Arsim për disa	Arsim për të gjithë
Statik	Fleksibël
Mësimdhënie kolektive	Mësimdhënie individuale
Mësim në mjedise të veçuar	Mësim në mjedise të përbashkëta
Theksi vihet tek mësimdhënia	Theksi vihet tek nxënia
Mësimdhënie me qendër mësuesin	Mësimdhënie me qendër nxënësin
Diagnostik/përshkrues	Holistik
Mundësi që kufizohen nga përjashtimi	Barazimi i mundësive për të gjithë

Arsimi special është gjetja e zgjedhjeve më të mira, e situatave më të pranueshme, është investim në bashkëpunim, ndërgjegjësim, solidaritet. Është një sfidë ndaj traditës së genit të zgjuar dhe trashëgimisë, është një angazhim profesional.

“Reforma dhe legjislacioni. Arsimi parauniversitar.

Çështje, praktika & politika. Rasti shqiptar.”

Autor Valbona Nathanaili. Dhjetor, 2011, U.F.O Press.

BASHKËMATËSIA E SISTEMEVE SHKOLLORE

Një nga detyrat e shkollës, e thënë shumë thjesht, është të mos lejë asnjë fëmijë jashtë dyerve të saj. Më tej, një shkollë e mirë është në gjendje t'u përgjigjet nevojave të të gjithë fëmijëve, pak ose shumë të zhvilluar, me prirje në muzikë ose në shkencat e natyrës, të shkathët ose të ndrojtur. Por nëse aftësitë janë tërësisht personale, të ndryshme nga një fëmijë në tjetrin dhe askush nuk mund të thotë se janë atribut i shoqërisë, ajo çfarë ndodh në shkollë është padyshim atribut i saj. Dhe duhet të jetë tërësisht e matshme.

Frika për të matur e vlerësuar të gjitha aspektet e punës që kryhet në shkollë, shoqëruar me një lloj skepticizmi dhe justifikuar me pyetje të llojit: “A ndikojnë aftësitë e përmirësuara matematikore të popullsisë në rritjen e prodhimit të brendshëm bruto të një vendi? Ose: A ekziston ndonjë lidhje direkte midis rezultateve të standardizuara shkollë të testit dhe mirëqenies së një kombi?” është krejtësisht e merituar. Sikur edhe vetëm për këtë arsye, e denjë për t'u marrë në konsideratë e diskutuar.

E parë në këtë prizëm, nisur nga pyetjet e mësipërme, në përgjithësi ne kërkojmë t'i vlerësojmë shkollat vetëm në funksion të së mirës së çastit që gjenerojnë ose kombinimeve të ndryshme të saj. Një pikëpamje e tillë është kryesisht produkt i traditës utilitariste, me të cilën dashje ose padashje operojmë të gjithë. Në jetën e përditshme matjet tona janë shumë homogjene dhe të kuantifikuara. Dhe japin siguri! Për shembull, ne jemi të sigurt që masim mirë kur numërojmë. E keni vënë re sa herë i numërojmë paratë? Disa herë! Dhe, shpesh, edhe shumë herë, derisa të sigurohemi që matja ishte e saktë. Askush nuk guxon të thotë se kjo e mirë është e pamatshme. Për më tepër, janë të bashkëmatshme: i konvertojmë paratë në monedha të ndryshme, në varësi të vendit ku zgjedhim të bëjmë pazar ose të kalojmë pushimet. Ose një shembull tjetër: shkallën e mirëqenies së një vendi e përcaktojmë në bazë të prodhimit kombëtar bruto. Një traditë e tillë e bën të dyshimtë çdo matje që nuk ka të bëjë me numërimin ose me identifikimin në çast të produktit. Duke u kthyer në rastin e shkollës, sa kohë që në shkollë kërkojmë të masim shkallën e arritjeve të nxënësve në disiplina të ndryshme, veçanërisht në shkenca, çdo gjë është e thjeshtë dhe aspak e koklavitur. Por mbimatja vetëm e disa aspekteve të produktit të shkollës në dëm të të tjerëve, e deformon matjen dhe bëhet shkak për devijime në qëllim.

Ajo që e bën të vështirë matjen e punës së shkollës dhe, më tej, krahasimin e rezultateve të saj me shkolla të tjera, ose bashkëmatjen e sistemeve të ndryshme shkollore, është se na duhet të dalim jashtë skemave të ndryshme të vlerësimit me të cilat jemi mësuar të operojmë. Dhe jashtë listës së objekteve që jemi mësuar të vlerësojmë. Në shkollë

na duhet të vlerësojmë një nxënës sa i aftë është të zgjidhë një tip të caktuar ushtrimi në matematikë, sikundër edhe sa i përgjegjshëm është si qytetar i ardhshëm i këtij vendi. Për të bërë matjen e parë mjafton edhe një test i thjeshtë; për të bërë të dytën, e kemi vështirë të japim një rezultat sepse është funksion jo vetëm i shkollës, por edhe i individit dhe i shumë kushteve të tjera që lidhen specifikisht me të. Matja e dytë, edhe pse del jashtë skemës së zakonshme, vërtetë është shumë më e vështirë, por jo e pamundur! Për më tepër, është e nevojshme për të ecur përpara, sepse nëse kemi frikë ose dyshojmë në aftësinë tonë për të gjykuar edhe aftësitë e nxënësve, krahas arritjeve, nuk do të dimë se ku jemi dhe çfarë *steke* të vendosim. Detyra kryesore e një qasje që kërkon të masë edhe aftësitë, është të vendosë, në një gjykim krahasues, atë që është produkt i shkollës, nga ajo që është produkt i familjes. Dhe nga anon peshorja!

Ekzistojnë shumë sisteme vlerësimi që përpiqen të na japin një informacion sa më të gjerë, në një aspekt tepër përfshirës dhe informues rreth këtyre dy aspekteve kryesore: arritjeve dhe aftësive të nxënësve. Përpos të tjerave, edhe në funksion të mungesës së vazhdueshme të kapitalit njerëzor të aftë të kryejë një punë të tillë. Për shembull, sa e vështirë është të vlerësosh të gjitha aspektet e punës së shkollës në zona të largëta të vendit, ku rrallë shkel këmba e inspektorit.

Të reflektosh rreth një procesi vlerësimi, përfshirë edhe vlerësimin që u bën sistemeve shkollore në shumë vende të botës PISA, është e vështirë. Ne nuk kemi arsye të reduktojmë të gjitha gjërat që vlerësojmë në shkollën tonë, në ato që ofron PISA, por të paktën duhet të zhdukim çdo ndenjë mosbesimi a dyshimi ndaj saj.

Shkollat duhet të pranojnë se shumë prej matjeve të kryera nuk i afrohen saktësisë së dëshiruar, por t'i japësh rëndësi të tepërt disa prej treguesve të suksesit dhe jo aq sa duhet të tjerëve, mund të çojë në minimin e efikasitetit dhe të efektivitetit që kërkojmë prej tyre. Kryerja e matjeve, ndonëse e redukton disi problemin e matjes së suksesit të shkollës, nuk mund të eliminohet asnjëherë.

Gazeta "Mapo", 16 dhjetor 2013

SI TË NDRYSHOJMË PERCEPTIMET

Me këmbë të mbarë thotë populli

.....

Si të ndryshojmë perceptimet

.....

Kuq e blu

.....

Hapësirë-koha në modernitetin giddensian

.....

Uniforma shkollore, zgjedhje apo zgjidhje

.....

Përtej horizontit

.....

ME KËMBË TË MBARË THOTË POPULLI

Njëzet vjet më parë, pak kush nga ne mund të perceptonte një rrugë më të gjatë e të vështirë të shndërrimit të demokracisë nga një term në një funksion. Entuziazmi i fitimit të shkallëve të reja të lirisë të pashijuara më parë, si dhe dëshira për të qenë pjesë e së tërës europiane zinin vendin kryesor në retorikën e asaj periudhe. Mirë a keq, me më shumë a më pak, “demokracia” na solli përsëri në stacionin e radhës: një raund i ri zgjedhjesh! Sigurisht që kush do i fitojë këto zgjedhje është shpejt të parashikohet, por të flasësh rreth tyre është në fokus të analizave të përditshme. Dhe e drejtë e çdo votuesi!

Segmentimi i “tregut” të votuesve

Në ditët tona shoqëria shqiptare paraqet një diversitet të gjerë nevojash. E vogël në numër, por e copëzuar dhe shpërndarë në zona me histori e nivele të pakrahasueshme zhvillimi, të kuptosh se çfarë kërkojnë grupe të ndryshme të saj, sikundër

çfarë i “kënaq” apo cilat janë prioritetet e tyre, si dhe t’i bindësh se për kë duhet të votojnë, më shumë se strategji “gju më gju me popullin” është strategji tavoline, që do të thotë strategji e mbledhjes, analizimit dhe segmentimit të këtyre “copëzave” në nivele sa më të vogla, mundësisht mikro, pikërisht në varësi të asaj që për to është e rëndësishme, vlen. Sigurisht që një qasje e tillë i jep procesit zgjedhor atributet e një tregu, por e shndërron në një marrëdhënie të thjeshtë e të kuptueshme nga të gjithë, ku vendi i kërkesë-ofertës, blerësit e shitësit, me të njëjtat tipare e funksione vetëm se me emërtesa të ndryshme zëvendësohet, përkatësisht, me votuesit (konsumatorët) që me votën e tyre kërkojnë dhe blejnë pikërisht atë që për ta është vlerë dhe me partitë, që me programet e tyre përpiqen të ofrojnë vlera, bazuar në një parim shumë të rëndësishëm: të dyja palët gëzojnë të drejtën e zgjedhjes. Në funksionimin e demokracisë të dyja zgjedhjet janë shumë të rëndësishme, ndërkohë që për vlerësimin e mirëfunksionimit të saj një aspekt pozitiv është shkalla e ndërgjegjësimit dhe qartësisht të votuesit rreth asaj çfarë kërkon e pret. Nga ana tjetër, duke krijuar një skenar të tillë, është me vend të theksohet rëndësia që kanë tregjet për ekonominë, sepse vetëm kështu mund të justifikojmë denjësisht jo vetëm përdorimin e gjuhës, por edhe rëndësinë e funksionimit normal të tij për një shoqëri vërtet demokratike.

Aftësia për të zgjedhur

Nëse segmentimi i “tregut” të votuesve deri në kërkesa mikrogrupi e bën gjuhën politike më të kuptueshme dhe programin e partisë më konkret, zgjedhja në numrin e madh

të partive që ofrojnë “mallin” e tyre se cila është më e mira, më e përshtatshme, ajo që përmbush kërkesat e standardet e tua është proces më vete. Dëshirës për t’u orientuar në këtë ballafaqim programesh e idesh, i duhet bashkangjitur një vëmendje e veçantë. Sa më të vëmendshëm të jemi ndaj asaj që “shitet”, sa më të formuar dhe të aftë të jemi në vlerësim, aq më shumë gjasa ka të jemi në gjendje të kontrollojmë “çmimin” në treg, në kuptimin që ajo që është gjizë të blihet për gjizë dhe ajo që është djathë të blihet për djathë, pra të bëjmë zgjedhje të tilla të cilat të mund të ndikojnë në aksionet e asaj që është në shitje, të bëjmë zgjedhje që ne i vlerësojmë si të mira, pasi zgjedhje të mira do të thotë më shumë mirëqenie, më shumë motivim dhe më shumë përfshirje.

Gazeta “Mapo”, 18 shkurt 2013

SI TË NDRYSHOJMË PERCEPTIMET

Nga shkencat e natyrës dimë se ajo që shohim varet nga pozicioni ku ndodhemi. Falë Galileut, jemi në gjendje të themi se, ndonëse Hëna dhe Dielli duken nga Toka me të njëjtat përmasa, një gjë e tillë është thjesht “një perceptim subjektiv, jo realist”, kushtëzuar ose limituar nga perspektiva pozicionale që në fizikë njihet si sistem referimi.

Sa më sipër, është e thjeshtë të abstraktojmë se sfondi social ose paragjykimet që kemi, ndikojnë mënyrën tonë të të arsyetuarit rreth përkatësisë politike, ose besimit ndaj saj, ose e thënë ndryshe meqenëse jemi në fushatë, në atë se për kë do të votojmë. Pra, pavarësisht nëse jetojmë në qytet a në fshat, jemi të rinj a të vjetër, gjykimi ynë për një politikë të caktuar influencohet shumë nga faktorët e mësipërm, në gjendje të përthyejë sipas një këndi personal perspektivat që hapin dhe shqetësimet që ngrenë forca të caktuara politike, justifikimet që parashtrojnë ose atë çfarë i motivon dhe i vë në lëvizje udhëheqësit e tyre. Ajo që perceptojmë varet nga pozicioni ku jemi dhe nga ajo që shpresojmë të shohim.

Nevoja për të transheduar kufizimet që të jep perspektiva pozicionale, në funksion të përmirësimit të vendimmarrjes, është një shtysë e mirë për të ngritur pyetjen: sa nga ne, mbas kaq dite fushate, kanë krijuar ide të qarta se çfarë do të bëhet me sistemin arsimor, me shëndetësinë dhe pensionet, me emigrantët dhe politikat për mbrojtjen dhe përfshirjen e tyre, me papunësinë apo vetë sigurinë në punë, nisur nga perspektiva e partive që po bëjnë fushatë?

Nëse kryefjala e fushatës është rruga, vlerësimi që kemi për rrugët e bëra nuk mund të veçohet nga vlerësimi që kemi për varfërinë në të cilën jetojnë shumë njerëz apo nga vlerësimi që kemi për sistemin shëndetësor. Të barazosh zhvillimin me rrugën është një gjë dhe të ndash zhvillimin nga mirëqenia e përgjithshme është një gjë tjetër, konkretisht jo e ndershme dhe aspak etike. Rruga është një mjet për zhvillim, mirëqenia e të gjithëve është synimi i zhvillimit. Ideja e identifikimit të një nevoje të vetme për të gjithë popullsinë është shumë pesimiste. Për më tepër krijon një asimetri, atë ndërmjet grupeve të ndryshme që e shohin veten të papërfaqësuar në diskursin politik. Ajo që po përpiqen të na servirin protagonistët e kësaj fushate zgjedhore deri më sot është thjesht një demagogji e pastër, që mund të tejkalohet nëpërmjet evidentimit jo vetëm të një vlere, por të disa vlerave dhe parimeve më të gjera, jo vetëm të problemeve, por edhe të rrugëve për zgjidhjen e tyre.

Të jesh në pushtet është më shumë se të zbatosh një kontratë sociale që ke me popullin tënd, pasi vetë fjala kontratë do të thotë një marrëveshje nga e cila përfitojnë të dyja palët, do të thotë reciprocitet dhe simetri. Kontrata që presupozohet se pushteti “lidh” me popullin të cilit i

shërben, edhe në rastin më të mirë kur raportohet se është zbatuar tërësisht a pjesërisht, nuk mund të shërbejë si bazë për arsyetim politik, pasi nuk ka simetri, është diçka e ngjashme me *in loco parentis* që ka shkolla me nxënësit. Nga ana tjetër, fakti i të qenit më i pushtetshëm se pjesa tjetër e popullsisë, nuk duhet parë si mundësi për të përfituar apo si rast për t’u shpërblyer për militantizmin ekstrem. Të jesh në pushtet, është më shumë! E përkthyer në fjalor politik, të jesh në pushtet, do të thotë të marrësh përsipër detyrën ose detyrimin për të bërë diferencë në jetën e njerëzve, pasi vetë pushteti të jep mundësinë të bësh gjëra që një njeri i zakonshëm nuk mund t’i bëjë. Asimetria e pushtetit e bën edhe detyrimin asimetrik: ta kuptosh këtë është thjesht njerëzore, ta zbatosh, ne i themi demokraci.

Gazeta “Mapo”, 12 qershor 2013

Nëse duam të kuptojmë si funksionon bota ku jetojmë, shprehet Franklin Henry Giddings në librin e tij “The Elements of Sociology”, na duhet të kultivojmë zakonet e identifikimit të gjërave që janë të ngjashme në grupe, shtresa e klasa. Por së fundmi, për shoqërinë tonë, mund të shtonim edhe “në parti”, pasi politika e derisotme, me të gjitha mjetet e instrumentet e mundshme dhe të pamundshme, reale dhe virtuale, të drejta ose jo të tilla, të moralshme ose jo të tilla, na ka polarizuar e ndarë kaq shumë, sa do mund të shërbenim si një shembull perfekt për teorinë e mësipërme, ndonëse e shkruar 100 vjet më parë. Je si ne? Ke punë, para, pushtet, famë, emër. Mendon si ne? Je i mirë, i ndershëm, i ditur. Diferencat në ngjashmëri, që në një gjuhë të thjeshtë mund të shprehen si diferenca në ide e pikëpamje, do të thonë diskriminim, papunësi, indiferencë, pamundësi për të fituar nëpërmjet një konkurrimi të ndershëm një vend pune në administratën publike. Ku? Në një vend aq të vogël sa kur kollitesh në jug, të thonë “Shëndet!” në veri.

Në një vend të varfër ekonomikisht, me një histori të brishtë demokracie që e fillojmë me vitin 1991 dhe e mbyllim shumë shpejt pasi nuk kemi më çfarë të tregojmë, është shumë e thjeshtë të abuzosh me pushtetin. Dhe e pafalshme! Pavarësisht justifikimeve që mund të pretendohen ose të vërtetave që mund të serviren. Sot kur është konfirmuar fitorja e Ramës dhe e grupimit të tij, është koha për të apeluar se ndarjet e rindarjet nuk do të jenë shkak për dasi, por për diversitet, nuk do të jenë shkak për të vërteta të ndryshme, por për realitet të larmishëm.

Një shoqëri normale nuk mund të bëjë kompromise me dogmat themelore: nuk mund të pranojë, për shembull, dy të vërteta. Për më tepër, asnjë nuk mund të thotë se zotëron ekskluzivitetin e së vërtetës. Nëse grupimi blu thotë që është e vërtetë, nuk ka një të vërtetë tjetër që është ajo e grupimit të kuq. E vërteta është e vërtetë në të gjitha sistemet e referimit, thotë një aksiomë e vjetër që vjen që nga koha e grekëve të lashtë dhe u ka mbijetuar dhjetëra e dhjetëra viteve zhvillimi, dhe “të gjitha ngjyrave” mund të themi ne sot. Pra, pavarësisht të sotmes dhe të djeshmes, pavarësisht asaj që ishte dhe asaj që është, e vërteta është vetëm një: e djeshmja prodhoi një sistem që dallohej për papërgjegjshmëri të institucionalizuar dhe demagogji vulgare, që karakterizohej nga paaftësia për të prodhuar politika që do të gjallëronin traditën e mirë qytetare dhe lartësonin vlerat sociale. Kanalet e standardeve u bënë aq të ngushtë sa nuk mjaftonte vetëm pohimi “kam të njëjtën ngjyrë” për të rrjedhë në të; kodet e politikave, të idealeve e besimeve u bënë aq pragmatiste, sa mund të konkurronin ndjeshëm me ato të biznesit, shpesh edhe duke i zëvendësuar; idetë për rishpërndarjen e së mirës për rritjen

e mirëqenies së përgjithshme u zëvendësuan me ato për rishpërndarjen e saj brenda një kaste të caktuar të grupit.

Nëse dëshira për të fituar është një fakt objektiv, jemi përballë faktit që “grupimi blu”, megjithë dëshirën e këmbënguljen, nuk ia doli! Nëse niveli i fitores është një fakt subjektiv, pasi varet nga idetë e synimet, “grupimi blu” fitoi aq sa ofroi në këta tetë vjet. Në këtë periudhë reflektimi pse humbi dhe si, e vetmja gjë që “grupimi blu” ka mjaftueshëm është koha: në radhë të parë për të nxjerrë pësime nga mësimet, ndonëse pësime të këtyre lloj grupimeve kanë kosto të lartë sociale pasi bien edhe jashtë tij, bien mbi të gjithë popullin. Akoma, për të kuptuar se demokracia, ndonëse ne e zbuluam vetëm para 20 vjetësh, nuk mund të zbatohet “ashtu si e di ai”, por ashtu si është, me të gjitha strukturat e levat e saj. Demokracia finalizohet në kutitë e votimit, thotë Amartya Sen, por është më shumë se kaq, demokracia është qeverisje ndërmjet diskutimit. Mendoj se ka ardhur koha të mos dëgjojmë monologë, por të jemi pjesë e dialogut.

Gazeta “Mapo”, 27 korrik 2013

HAPËSIRË-KOHA NË MODERNITETIN GIDDENSIAN

*Refleksione rreth librit “Pasojat e modernitetit”,
autor Anthony Giddens Botues UET Press*

Për shumë nga ne që pretendojmë se kemi një farë njohurie rreth shkencave të natyrës, diskutimin rreth kohë-hapësirës dhe marrëdhënieve ndërmjet tyre, zakonisht e zhvillojmë duke vënë përballë pikëpamjet e Aristotelit me ato të Njutonit, ose të Ajnshtajnit me ato të Hawking. Por pavarësisht faktit se në debat mund të sillen gjithmonë argumenta të shumëllojshme, si dhe ndërgjegjësimit se secili prej katër personazheve historikë të cituar më lart kanë jetuar në kohë dhe hapësira të ndryshme (bëjnë përjashtim Njutoni e Hawking që distancohen vetëm në kohë), thelbi pak a shumë ka qenë gjithmonë ky: A janë hapësira dhe koha një skenë statike ku zhvillohen ngjarjet dhe e pandikuar nga ajo që ndodh aty, apo një skenë dinamike në të cilën, jo vetëm veprimi i forcës apo ndodhia e ngjarjes ndikon në konfigurimin e kohë-hapësirës, por edhe vetë kohë-hapësira ndikon në mënyrën e veprimit të forcës apo ecurisë së ngjarjes.

Përpyekjet tona për të shpjeguar natyrën ndërthurren me ato për të shpjeguar shoqërinë dhe vetë konceptet, si

pjesë e refleksionit nga një lloj dije në një tjetër, të trajtuara në perspektiva të ndryshme a të ngjashme, bëhen pjesë e njësimi të tyre. Për Anthony Giddens, autorin e “Pasojat e modernitetit” sjellë në shqip nga UET Press, koncepti hapësirë-kohë është po aq i rëndësishëm sa për shkencat e natyrës, por në një vizion të ri.

Në shkencat e natyrës, e ardhmja dhe e kaluara nuk kanë asnjë dallim në të gjithë boshtin ‘kohë’ (kohë imagjinare). Kështu, ne jemi në gjendje jo vetëm të parashikojmë të ardhmen, për shembull, të llogarisim deri në të mijtat e sekondës se kur do të ndodhi eklipsi i radhës së diellit ose të hënës, por edhe sa herë të tjera ka ndodhur e do të ndodhë.

Për më tepër, në fizikë ne i lidhim gjithmonë bashkë hapësirën me kohën. Për kushte fillestare të dhëna, jemi në gjendje, në boshtet karteziiane të kohë-hapësirës, të parashikojmë zhvillimin e një ngjarjeje në një vend të caktuar të hapësirës dhe në një çast (ose interval) të caktuar të kohës.

Në ndryshim, në shkencat shoqërore ne kujtojmë vetëm të kaluarën (atë që është mbrapa dhe gjendet, në gjuhën e fizikës, në pjesën 0, - ∞ të boshtit të kohës), ndërkohë që të ardhmen (atë që është përpara dhe gjendet, në gjuhën e fizikës, në pjesën 0, $+\infty$ të boshtit) vetëm mund ta përfytyrojmë ose të shpresojmë se mund të ndodhë!

Për Giddens-in kalimi nga shoqëritë para-moderne në ato moderne mund të shpjegohet nëpërmjet kohë-hapësirës dhe marrëdhënies së re që krijohet ndërmjet tyre.

Në shoqëritë para-moderne askush nuk mund të tregonte kohën e ditës pa iu referuar shenjave të tjera socio-hapësinore: “kur” në mënyrë universale lidhej ose me “ku”,

ose identifikohet nëpërmjet ndonjë fatkeqësie natyrore ...¹. Sa më e distancuar të jetë koha nga hapësira, aq më e zhvilluar është shoqëria.²

Në mbështetje të këtij argumenti, autori inventarizon të gjitha kushtet fillestare: shpikjen e kalendarit dhe të orës, zhvillimin e postës dhe të hartave, lindjen e internetit dhe të bankave e u jep kuptim të ri, tregon se si, secila prej tyre ndikoi që jeta sociale, me koordinata të lidhura kohore e hapësinore në shoqëritë para-moderne, të mund të planifikohej dhe të zhvillohej në hapësira të papërcaktuara, si dhe të nxisë marrëdhënie ndërmjet të tjerëve “në mungesë”, lokalisht në distancë nga njëri-tjetri dhe pa mundësinë më të vogël të një ndërveprimi ballë për ballë. Pra, këto singularitete ndanë kohën nga hapësira dhe çuan në lindjen e modernitetit.

Në të njëjtën kohë, autori synon t’a riorientojë objektin e studimit të sociologjisë jo vetëm drejt *çfarë*, por edhe *pse*, duke qenë, në të njëjtën kohë, sociolog e analist, filozof e teknik. Duke perifrastuar Wittgenstein, Giddens nuk kujdeset “vetëm për gjuhën”, por qëndron në linjën e klasikëve të shekujve shtatëmbëdhjetë e tetëmbëdhjetë, pasi e vendos bazën e veprës së tij mbi parimet e shkencave të sakta, në përpjekje për të bërë atë që Ajnshtajni bëri në fizikë: të ndryshojë perceptimet tona.

Sipas Giddens, ne po lëvizim sot drejt periudhës së “modernitetit të zhvilluar”. Duke kërkuar të trajtojë një teori sa më të plotë mbi modernitetin, autori një vend të rëndësishëm i kushton edhe pasojave që ky rend i ri solli në

¹ *Shënim:* Si në shkencat e natyrës

² *Shënim:* Në ndryshim nga shkencat e natyrës.

marrëdhëniet dhe institucionet shoqërore, në çrrënjosjen dhe dinamizmin e shpërndarjes së tyre.

Autori vazhdimisht u referohet klasikëve të mendimit sociologjik në perspektiva krahasuese duke shprehur, në të njëjtën kohë, edhe mendimin e tij pro ose kundër. Është një libër i shkruar për t'u kuptuar jo vetëm nga një grup i vogël profesionistësh a filozofësh, por edhe nga publiku i gjerë.

*Botuar në anglisht "Sociological Analysis", Vol. 7,
Number 1, Spring 2013 (ISSN 1097-7147)*

UNIFORMA SHKOLLORE, ZGJEDHJE APO ZGJIDHJE

Për shumicën e fëmijëve shkolla është përvoja më e madhe me botën jashtë shtëpisë. Rreth një të tretën e ditës e kalojnë në të dhe pjesën më të madhe të kohës së mbetur duke punuar për të. Mësuesit, shokët, librat ... janë çështjet kryesore me të cilat merren. Së fundi edhe veshjet. Çfarë do të vesh nesër në shkollë? A jam modern? Janë pyetjet që bëhen zakonisht dhe që shpesh kthehen në shqetësim të vërtetë edhe për vetë prindërit, që po të kemi parasysh edhe sa të shtrenjta janë, jo rrallë na japin dhimbje koke! Sa shumë shpenzime. Bluza që vishen vetëm disa muaj dhe pantallona që sezonin tjetër nuk bëjnë pasi 'nuk janë më në modë'. Këpucë me taka e shalle me ngjyra e madhësi të ndryshme. Problemi bëhet më i vështirë veçanërisht për moshën e adoleshencës. Adoloshentët vrasin njëri-tjetrin me rrobat që veshin – thotë Bill Clinton.

Kostoja e këtyre veshjeve si dhe e konflikteve që i shoqërojnë ato, ka bërë që shumë prindër të kërkojnë e gjejnë zgjidhjen tek uniforma shkollore. Dhe jo vetëm si mjet për të shpëtuar sadopak portofolin familjar ose si

mënyrë për t'i shpëtuar andrrallës “çfarë do të vesh” ose ankthit nëse rrobat janë të vjetra a të reja, të kohës a jo. Uniforma nuk shpëton vetëm lekë. Uniforma shpëton kohë. Në mëngjes, sa hap e mbyll sytë nuk ke nevojë të mendosh se çfarë do të veshë fëmija sot. Nga ana tjetër, edhe shumë shkolla e kanë gjetur politikën e mbajtjes së uniformës si një zgjedhje të mirë. Për mësuesit uniforma është disiplinë, është rregull dhe mënyrë e lehtë për të verifikuar nëse filan fëmijë është nxënës shkolle a jo.

Qëndrimi ndaj uniformës dhe vetë stilimi i saj ka ndryshuar nga vendi në vend e nga koha në kohë. Për herë të parë uniformat shkollore u përdorën në shek. XVI, në Angli. Me uniformë visheshin fëmijët e varfër që ndiqnin disa shkolla të veçanta pa pagesë, për t'u dhënë edhe atyre mundësinë për t'u arsimuar. Po në këtë shekull, uniforma shkollore filloi të përdorej edhe në shkollat fillore publike. Më vonë, rreth shek. XIX, uniformat u adoptuan në shkollat private si një mënyrë që nuk lejonte fëmijët, veçanërisht djemtë, për t'u mburrur para njëri-tjetrit për veshjet e shtrenjta që kishin, shpesh plot ngjyra e aspak komode. Uniformat shkollore morën ekskluzivitetin e shkollave private e të shtrenjta. Sa i takon stilimit, djemtë e shkollës fillore në Angli mbanin pantallona të shkurtëra, gjatësia e të cilave rritej me rritjen e moshës së fëmijës. Në uniformë ishin parashikuar të gjitha: nga këpucët e çorapet, deri te lloji i kapeleve e ngjyrës që duhet të kishte. Po ashtu, për raste të ndryshme visheshin uniforma të ndryshme - kishte uniformë të veçantë për ditën e parë të shkollës, njëlloj sikundër kishte uniformë të veçantë për ditën e fundit të saj.

Me kalimin e kohës një përvojë e tillë u përhap në të

gjitha kolonitë e Anglisë, për të vajtur deri në Australi. Por edhe Europa nuk mbeti mbrapa adaptimit të politikës së uniformës shkollore. Në Francën e shek. XIX, qeveria e asaj kohe përshtati uniformën si një mjet që do të reduktonte sa më shumë të ishte e mundur dallimet sociale e klasore. Po ashtu, edhe në Itali uniforma përdoret gjerësisht. Amerika i rezistoi tundimit të uniformës duke e shmangur përdorimin e saj për shumë kohë. Për herë të parë në shkollat publike amerikane uniformat filluan të përdoren vetëm nga mesi i viteve '980, kryesisht në ciklin e ulët.

Në vendin tonë erdhi modeli që përdorej në vendet e Europës Lindore, përparëse e zezë me jakë të bardhë. Vajzat e vishnin nga klasa e parë deri në përfundim të arsimit të mesëm, ndërsa djemtë kryesisht deri në përfundim të ciklit fillor. Në shkollë fillore vajzat mund të vishnin edhe një përparëse të bardhë përsipër, ku e vetmja garë për t'u mburrur para njëra-tjetrës konvergonte në sasinë e fjongove që përdoreshin.

Edhe në vitet e demokracisë shkollat publike shqiptare vazhdojnë të përdorin përgjithësisht të njëjtën uniformë. Karakteristikë është mungesa e përgjithshme e dëshirës për t'u veshur. Në verë mund të vishen, gjithsesi, ndonëse mbajnë shumë vapë për shkak të ngjyrës, ndërsa në dimër kthehen shpesh në një bezdi të vërtetë, thjesht sepse shkollat janë pa sistem ngrohjeje dhe vishen mbi një a dy triko të trasha. Pak ndryshime kanë bërë në këtë drejtim shkollat private.

Sidoqoftë, çështja nëse uniforma shkollore është zgjedhje apo zgjidhje sigurisht që nuk është vetëm problem i mësuesve dhe i prindërve. Për psikologët e politikëbërësit e shkollës problemi nuk është vetëm ekonomik apo thjesht

disiplinë. Është edhe çëshje aleancash e argumentash pro e kundra dhe vetë përcaktimi se nga anon balanca nuk është i lehtë.

Një artist e ka të vështirë të pranojë uniformitetin. Për të uniformiteti çon në ndrydhje: fuqia e urdhërit shtyp të drejtën e shprehjes. Duke i dhënë urdhër fëmijës se çfarë do të veshë ose çfarë ngjyrash do të përdorë, ne indirekt i mësojmë se nuk ka rëndësi individualiteti i tyre dhe se të drejtat për t'u shprehur janë të parëndësishme.

Ndërkohë, argumentat pro thonë se, duke veshur e përdorur uniformën në shkollë, vlerësimi i fëmijëve nuk bëhet në bazë të statusit ekonomik, por në bazë të të dhënave individuale e arritjeve personale. Për më tepër, shkollat janë vendi ku përgatiten mjekët, avokatët e gjyqtarët e ardhshëm, puna e të cilëve përfshin edhe një veshje të caktuar. Fëmija nëpërmjet uniformës merr mesazhin se në ambiente të veçanta, veshja sipas një kodi të përcaktuar qartë ka vlerat e veta. Në këtë mënyrë, shkolla ndihmon në krijimin e perceptimeve të drejta. Dhe nuk është aspak gabim që fëmijës në shkollë t'i japim një mesazh të tillë.

Gazeta "Shekulli", 7 shtator 2004

PËRTEJ HORIZONTIT

*Refleksione rreth librit "Si qytetar global paqedashës. Dashuri, paqe botërore",
autor Reverendi Sun Myung Moon, Botues
Federata e Familjes për Paqe Botërore dhe
Bashkim & U.F.O Press*

Afro shtatë muaj më parë pata kontaktin e parë me dy nga përfaqësuesit shqiptarë të Federatës së Familjes për Paqe Botërore dhe Bashkim, zotërinjtë Gani Rroshi dhe Sokol Rexhepi. Qëllimi ishte ky për të cilin jemi mbledhur: botimi në shqip i librit "Si qytetar global paqedashës". Që nga ajo ditë, takimet u bënë periodike, për të diskutuar dhe monitoruar të gjithë procesin e botimit. Me synimin për t'i qëndruar sa më besnikë jo vetëm kopjes anglisht, por edhe perceptimeve të autorit apo këndvështrimit me të cilin ai e sheh botën, zgjodhëm gjuhën dhe terminologjinë që do të përdorej, formatin e librit apo deri edhe letrën me të cilën do të shtypej, detaje që të gjitha së bashku japin procesin e bukur të botimit të një libri. Jam krenare që jam pjesë e kësaj iniciative! Dua t'i falënderoj për bashkëpunimin e frytshëm dhe, akoma më shumë, për rezultatin: kemi në dorë një titull shumë të mirë shqip, që transmeton vlera ndryshe.

Përmes këtij libri autobiografik, reverendi Moon jep misionin e jetës së tij: dashuri dhe paqe globale, gjë e cila

duket që në titullin e librit. Në fakt, tema është sa e re dhe e vjetër, por në gjuhën e autorit, në kujtimet që sjell, në mënyrën si e transmeton tek lexuesi, tingëllon ndryshe. Ai ka dashuri për njerëzit që e rrethojnë, për bashkëpunëtorët, për familjen, për natyrën, për bimët e kafshët, ndërkohë që paqja e Moon është më shumë. Perceptimi i tij për paqen fillon në vitet e para të jetës, e thjeshtë dhe e kuptueshme për një fëmijë, që sikundër shprehet në f.3 të librit është një ndërthurje e lirisë me sigurinë; kur në shpinë të të atit, ndjen, për herë të parë, siguri totale dhe liri në zemër, si dhe një harmoni me natyrën dhe çdo gjë përreth. Paqja që ofron Moon zgjerohet nga faqja në faqe, thellohet nga rrjeshti në rrjesht dhe është dinamike. Në mënyrë simbolike udhëtimi i Moon nis në shpinën e të atit, për të vazhduar në të katër anët e globit, një udhëtim pothuaj një shekullor (mos harroni se aktualisht është mbi 90 vjeç) për t'i bërë synimet e veta synime të të tjerëve, për ta shndërruar misionin e tij në mision të të tjerëve në përpjekje për të hedhur bazat e një paqeje globale dhe për të falur dashuri. Në botën e shekullit të njëzet e një këto duhet të jenë dy karakteristikat dalluese të qytetarëve të saj.

Idesë së paqes si jetë në harmoni, siguri dhe liri, Moon i kthehet vazhdimisht. Duke qenë me origjinë nga Korea e Veriut është tepër konkret në mënyrën e perceptimit të kësaj ideje. Pasi merr në analizë ngjarjet kryesore që kanë ndodhur në vende të ndryshme në këta dhjetëvjeçarët e fundit, në Europë, Amerikë e Azi, në një pjesë të mirë të librit do të gjeni përpjekjet për bashkimin e Koresë së Veriut me atë të Jugut.

Nga shkencat e natyrës dimë se ajo që shohim varet nga pozicioni ku ndodhemi. Pra, pozicioni ku gjendemi ndikon

besimin dhe zgjedhjet tona. Të ndryshosh vendndodhjen është një mënyrë e mirë për të parë gjërat ndryshe, për të zbuluar të fshehtat, për të zgjeruar e thelluar vëzhgimin dhe, mbi bazën e tyre, për të ndryshuar zgjedhjet e besimin. Duke lëvizur nga një shtet në tjetrin, duke takuar personalitete dhe njerëz të thjeshtë në të katër anët e botës, Moon na jep një perspektivë të re, duke u përpjekur që atë që shihet ai, ta fusë në optikën e syve tanë.

Autori ka arritur të kuptojë nevojën për të shkruar përtej kufizimeve që të imponon shkalla e ulët e njohjes, duke na dhënë një pamje tjetër, më të gjerë, më të bukur, më shpresëdhënëse dhe duke na ftuar, në të njëjtën kohë, për të qenë pjesë e saj, ndoshta edhe duke na vënë në dukje shpirtin pragmatist të tij: është themeluesi i gazetës Washington Post dhe ka biznese në shumë vende të botës. Në f. 314 - 315 kalon në këshilla praktike sa i takon mënyrave që duhen zbatuar për zgjidhjen e varfërisë.

Në tragjedinë “Mbreti Lir”, diku, mbreti i thotë shërbëtorit të tij besnik se një njeri duhet ta kuptojë si funksionon kjo botë edhe kur është i verbër. Në mënyrë figurative, në f. 277, autori shprehet: “Të zgjuarit duhet ta rreshtojnë veten në anë të ligjeve dhe të ritmit të universit” dhe, disa rrjeshta më tutje: “Peshqit kanë shtigjet e tyre dhe kohë të caktuara kur kalojnë në to. Nëse nuk i dimë këto rrugë, nuk mund t'i kapim. Vetëm fakti që ka ujë, nuk do të thotë se ka peshq”. Kjo është ajo që propozojnë shumë ekonomistë: zgjedhjet e njerëzve duhet të kenë doza të theksuara racionaliteti, duke u përpjekur për të krijuar një lidhje logjike ndërmjet atyre që kemi arsye për t'i zgjedhur dhe atyre që janë racionale nga ne për t'i zgjedhur. Në këtë frymë, Moon propozon zgjidhje të ndryshme për mjedisin,

për lirinë e besimit dhe për vetë konceptin e bamirësisë.

Në mënyrë simbolike libri mbyllet me idenë e ndërtimit të autostradës së paqes botërore. Si do të ndërtohet kjo autostradë? Sigurisht me punë. Në f. 343 Moon shprehet: “Ka ardhur koha t’i kthejme shpatat në plugje dhe heshtat në drapinj”.

Në punën tonë, kur botojmë një libër, një nga psetë që duhet t’i japim përgjigje është: Kujt i duhet libri? Kush është lexuesi i tij? Përgjigja fillon zakonisht me klasifikimin e lexuesve sipas interesave, grupmoshave, edukimit ose profesionit. Në rastin e librit që keni në dorë, po ofroj një klasifikim të ri: për të gjithë. Kjo për të vënë në dukje një element tjetër të rëndësishëm në ndihmë të të kuptuarit të librit dhe të interesit për ta lexuar atë. Në jetën e përditshme njerëzit udhëhiqen nga motive të ndryshme, motive që shpesh gjenden përtej interesave të ngushta private ose vetjake, si: humanizmi, bujaria, drejtësia, shpirti dhe dëshira për të punuar për të tjerët, bashkëpunimi. Për ne, nuk është shumë e vështirë të pranojmë se njerëz të tillë, ekskluziviteti i motiveve të të cilëve është jashtë sferës së interesave vetjake, ekzistojnë. Reverendi Moon është një prej tyre. Por edhe më skeptikët duhet të pranojnë se ideja e bashkëpunimit është një normë grupi me përfitime dypalëshe. Reverendi Moon ofron bashkëpunim. Për këto arsye, libri ka të ofrojë për të gjithë.

*Fjala e mbajtur me rastin e promovimit të librit,
datë 31.10.2011*

SALE, ZUCCHERO E CAFFÉ!

I penguari ...

Ish – “21 dhjetori”, përtej nostalgjisë

Jesolo. Aty ku turizmi është shndërruar në art

*Ngjela dhe refleksionet e tij për
“Parkun njerëzor shqiptar, 1991–1996”*

Post panair: Sale, zuccherò e caffè!

Dita e zakonshme e një shkolle publike

In memoriam Prof. dr. Enver Faja

Faleminderit djema

Arsimi në geverisjen e dytë të Ahmet Zogut

“Ca pika shiu ranë mbi qelq”. Kështu fillon një nga poezitë më të bukura të Ismail Kadaresë, shkrimtarit tonë të shquar, një nga më të lexuarit dhe, njëkohësisht, nga më të diskutuarit nga ne, bashkëkombasit e tij. Titulli i poezisë është “Mall”, por veçoj edhe një tjetër, në fakt shumë larg sfondit romantik të së parës, shkruar në një kohë dhe për një kohë që tani quhet ‘e kaluar’ jo vetëm si koncept: “Mësueset e fshatit”. Njëzet vjet pas përmbysjes së asaj kohe dhe, ndoshta, tridhjetë ose më shumë vjet pasi janë krijuar, u rikthehem herë pas here dhe gjithmonë më duket sikur i lexoj për herë të parë. Por nuk mendoj se jam e vetmja. Nuk ka shqiptar, besoj, që nuk di të thotë të paktën disa vargje nga “Mall”, ose të mos bëj ndonjë vërejtje të bukur rreth shiut, sa herë bie shi, duke ju referuar pikërisht këtyre vargjeve; nuk ka mësuese që ka punuar në fshat në kohën e diktaturës, të mos e ketë lexuar të paktën një herë “Mësueset e fshatit”:

Në udhëkryqe, ndanë xhadeve
ditët e shtuna dalin shpesh

dhe zgjasin dorën nga makinat
herë dy nga dy herë veç e veç ...

Në një Shqipëri në diktaturë, “midis dëshirës për të treguar dhe detyrimit për të heshtur”,¹ Kadare zgjodhi të parën. Sigurisht që lista me krijimet e mrekullueshme të Kadaresë mund të zgjatet pa fund, por vlera e Kadaresë-shkrimtar qëndron jo vetëm në ato që ka shkruar, por edhe në ato që ka arritur të frymëzojë: na ka mbushur me optimizëm, na ka ushqyer me patriotizëm e atdhedashuri, na ka nxitur të njohim, duam e vlerësojmë të kaluarën, na ka bërë të guxojmë të ëndërrojmë për më mirë, e ka çuar fantazinë tonë përtej kufizimeve që diktonte koha... Nisur nga vlera e jashtëzakonshme e veprës së tij, me dhe pa të drejtë, jemi përpjekur të ndajmë njeriun nga shkrimtari, udhëtarin e përkohshëm në këtë botë, vdekëtarin, nga krijuesi i një vepre të përvetshme, përkthyer në më shumë se 40 gjuhë të huaja, vepër e cila, përpos sa më lart, ka kontribuar në mënyrë të veçantë në pasurimin e kulturës europiane me vlerat tona dhe të vendit tonë. Akoma, me dhe pa të drejtë, kemi vënë në balancë Kadarenë e censuruar dje, me Kadarenë e lirë sot, duke kaluar në sitë çdo fjalë, çdo gjest, çdo deklaratë e gjykim të tij.

“Dhe thënia e vjetër e Heraklitit, vazhdon Kadare te ‘Mall’, seç m’u kujtua sot për dreq/ të zgjuarit janë bashkë në botë/ kurse të fjeturit janë veç”.

Në një Shqipëri në demokraci, Kadare pohon: “Po të

isha nga një vend tjetër, ndoshta do isha thjesht shkrimtari i dashur dhe i lexuar, sikundër janë shumë nga kolegët e mi në botë, por jam nga Shqipëria, një vend që herë pas here ka bërë zgjedhje të gabuara. Për rrjedhojë, dua apo nuk dua, kam një mision, në mënyrë të natyrshme e të vetvetishme: ndërkohë që bëj letërsi, kërkoj të ndihmoj, sado pak, me mendimin e gjykimin tim, në orientimin drejt një kahe të mbarë të popullit shqiptar”.² Në funksion të këtij misioni, tezat e tij kryesore, të formuluar qartë, pa ekuivoke e alegori tashmë, dalë nga takimet që ka bërë së fundmi (jo vetëm në UET), mund të formulohen në:

1. Duhet të heqim dorë nga debati “Shqipëri europiane ose jo”. Për Kadarenë duket se një debat i tillë ka vetëm një shpjegim: shterpësi. Shqipëria është europiane gjeografikisht, historikisht dhe shpirtërisht: “Duhet të ecim dhe të shikojmë përpara, t’u vëmë kapakun disa debateve të panevojshme dhe kryqin disa llogarive, të mbyllim disa dosje dhe të hapim të reja. Fakti që ne vazhdojmë të kemi ‘nëpër këmbë’ të njëjtat dosje për pothuaj një qind vjet, do të thotë që energjitë tona po shpenzohen në mënyrë të gabuar”.

2. Kosova nuk është një shtet multi-etnik. Për Kadarenë, që Kosova të shpallet shtet multi-etnik, kjo nuk duhet të bjerë në kundërshtim me një parim themelor, mbi të cilin janë ndërtuar shtetet në Europë që pohon se “kombësia zotëruese përcakton kombësinë e shtetit”: “Askush në Europë sot nuk guxon të kërkojë të ndërrojë emrin e shtetit francez ose gjerman, belg ose zviceran, për hir

¹ Kadare, I., 1990. “*Ftesë në studio*”, Shtëpia Botuese “Naim Frashëri”: Tiranë, f. 135

² *Shënim*: Nga takimi me studentë e pedagogë në UET, 2011.

të mbizotërimit të një shumice komunitetesh. Franca ka më shumë komunitete të huaja se Kosova, shumë më tepër; Gjermania po ecën drejt këtij fenomeni; Anglia është duke e arritur atë proporcion. Por askush, e përsëris, askush nuk mund të guxojë të ëndërrojë të shpallë ndonjërin prej këtyre vendeve multietnik. Dhe nuk ekziston as tendenca më e vogël!”³

3. Në Shqipëri nuk ka nacionalizëm ekstrem, që në optikën e shkrimtarit tonë të dashur, “një gjë e tillë e ka pasuruar jetën tonë”, në ndryshim nga Ballkani, që është një “mozaik nacionalizmash të ashpra”.

4. Gjuha shqipe, si një gjuhë tipike indoeuropiane dhe me një zhvillim të natyrshëm sikundër të gjitha gjuhët e tjera, është një gjuhë me autoritet dhe, standardi i saj, nuk duhet vënë në dyshim; për më tepër, standardi i gjuhës shqipe nuk duhet të ngatërrohet me gjuhën letrare ose me gjuhët kryesore të folura shqipe. Në rastin e gjuhës shqipe, ndonëse standardi i saj u krijua në kushte fatkeqe, në kushtet e mënjanimi të kulturës veriore, kryesisht asaj katolike, për arsye thjesht politike, madje meskine, por ky standard nuk është as vepër e Enver Hoxhës dhe as e regjimit komunist: “do të ishte një ngatërrim, e thënë ndryshe, një nder i madh për këtë regjim dhe për këtë njeri të themi që na paska krijuar një gjuhë shqipe”.⁴ Historia e gjuhës shqipe karakterizohet nga një zhvillim pak a shumë i natyrshëm, sepse gjuha shqipe është një nga gjuhët tipike indoeuropiane, një

gjuhë me autoritet shumë më të madh se autoriteti i vetë vendit që i përket. Gjuha shqipe është më e rëndësishme se Shqipëria; historinë e ka më të qartë dhe më të plotë. Kështu shprehen të gjithë shkencëtarët seriozë – nuk dua të merrem me ata që quhen shkombëtaristë. Në sistemin e vjetër gjuhësor të gjuhëve indoeuropiane, shqipja ka vendin e saj të përhershëm, të paprekshëm në asnjë rast. Gjuha shqipe nuk ka asgjë më pak se gjuhët e tjera të Ballkanit, në mos ka më shumë. Shqipja dhe greqishtja janë dy gjuhë autoktone ballkanase. Gjuha jonë jeton, zhvillohet dhe vepron sipas ligjeve të gjuhëve europiane të këtij kontinenti – unë po marr kontinentin europian se nuk ka nevojë të marrim kontinente të tjera, sepse ky është kontinenti ynë. Europa mbetet, sot për sot, kontinenti më i përparuar nga pikëpamja kulturore. Dhe ne nuk kemi pse të kërkojmë të na zërë zilia kot, sepse çdo gjë zhvillohet sipas ligjësive dhe, në këto ligjësi, një nga bazat është standardi gjuhësor.

Standardi, sikundër e thotë vetë fjala, tregon Kur standardi ndërtohet me gjuhën letrare, nuk është më standard ... Standardi është një, ndërsa gjuha letrare është e drejta e krijimit të çdo shkrimtari, në çdo lloj forme të së folmes, qoftë edhe në format e kaluara dhe kjo ndodh në të gjitha vendet e Europës. Nuk ka asnjë vend me një të folur, siç duam ne të jetë Shqipëria! Shqipëria është një nga vendet me gjuhët më homogjene në Europë: ka vetëm dy të folme kryesore.

Standardi nuk vendoset me bindjet hyjnore, as me një evolucion të ngadaltë, as me shumicën e popullsisë së një vendi; nuk ka asnjë model të dhënë për standard. Standardi krijohet në mënyrë thjesht të rastësishme

³ *Ibid*

⁴ *Ibid*

do të thosha, por gjithmonë pasohet me një vendim. Shpesh një krahinë e një vendi vendos standarde; herë të tjera është kryeqyteti ai që vendos dhe, herë të tjera, për çudi, një katund i humbur ose një njeri. Marrim Italinë. Italishtja moderne ka si bazë gjuhën e përdorur nga Dante Alighieri. Pra, nuk ka më ... ose nuk duhet të themi më ... që kemi kaq e aq popullsi të kësaj zone, ose të asaj zonës tjetër, të gjejmë se ku është bërë gabimi dhe hajde ta rikrijojmë standardin.

Është koha që i bën shkrimtarët apo janë shkrimtarët që bëjnë kohën? Dje dhe sot, Ismail Kadare, me një histori 55 vjeçare krijimi e shtrirë në dy sisteme të ndryshme, i nominuar vetëm një herë për çmim Nobel nga ne, bashkëkombasit e tij, është po ai: shkrimtari i dashur dhe misionari i kombit shqiptar.⁵

⁵ *Shënim.* Ka një keqkuptim sa i takon nominimeve për çmim Nobel. Kur flitet për Kadarenë, ne themi që e kemi paraqitur kandidaturën e tij dhe nuk ka fituar, por dosja është aty, ndoshta e merr këtë radhë! Po të hapësh faqen zyrtare të Çmimit Nobel, procedura është që Juria merr në shqyrtim vetëm propozimet që vinë çdo vit. Pra, nëse duam apo ëndërrojmë që një autor shqiptar të mund të marrë një çmim të tillë, protokollin është që çdo vit duhen dërguar emrat e dosjet përkatëse!

ISH -“21 DHJETORI”, PËRTEJ NOSTALGJISË

Kushdo që jeton në Tiranë ka kaluar të paktën një herë nga “21 dhjetori”, thjesht sepse zona ndodhet në një nyje të rëndësishme kalimi dhe është një nga më të populluarat e më me lëvizje të qytetit. Unë kam jetuar në atë zonë nga vitet 1963-1982 dhe në kujtimet e mia, ajo që unë i referohem si “21 dhjetori”, fillon te i ashtuquajtimi sheshi “Mustafa Kemal Atatürk”, aty ku pritet unaza e vogël me rrugën e Kavajës dhe vazhdon në të majtë të unazës, deri te pikëprerja e saj me rrugën “Myslym Shyri”. Zona përfshin tre pallatet nr. 34, 36 & 38 që gjenden buzë rrugës (përballë shkollës “Sabaudin Gabrani”) si dhe ato në brendësi të saj.

‘E kam shtëpinë te 21 dhjetori’ ishte një pikë e mirë orientimi! E dinin të gjithë, sepse sapo hyje në rrugën “Muhamet Gjollës” (nga sheshi sipërpërmendur) dhe kaloje pallatin e parë, nr. 34, në të majtë ishte një rrugë gjithmonë e pashtuar që të çonte te ndërmarrja e ndërtimit “21 dhjetori”, ku punonin me qindra vetë. Origjina e emrit lidhet me ditëlindjen e ish-udhëheqësit të Bashkimit Sovjetik, shokut Stalin, që për brezin e ri është një diktator më shumë që duhet

mësuar në shkollë, por për ne një histori e tërë me pasoja të trishtme, që diktonte jo vetëm emrin rus të ndërmarrjes, por çdo gjë, deri edhe modelin e pallateve, projektuar e ndërtuar sipas ideologjisë komuniste. Pallatet për të cilët bëhet fjalë janë ndërtuar nga të burgosurit dhe apartamentet kanë sipërfaqe e kubaturë përtej modestes, të përbërë nga dy dhoma e një kuzhinë e vogël + një bodrum + një tualet + një ballkon dhe shumë të ulëta. Shtëpi tipike të kohës komuniste që ishin vetëm për të fjetur dhe për të ngrënë e që u shërbenin të gjithëve njëllë, pavarësisht edukimit që kishe, nevojave që paraqisje ose të ardhurave që prodhoje; fantazia më e madhe e përshtatjes, me rritjen e numrit të anëtarëve të familjes, shkonte te gatimi në banjë ose në ballkon dhe shndërrimi i bodrumit në një tip aneksi të vogël për të larë e mbajtur enët. Nuk di se çfarë bëhet tani dhe si kanë mundur t'i përshtasin fqinjët e mi të dikurshëm kërkesat për banim, por nga jashtë asgjë nuk të kujton të kaluarën, ndonëse janë ndër të paktat pallate në Tiranë që nuk kanë bërë shtesa “gjigande” majtas-djathtas & para-mbrapa. Në ata 18 vjet që kam jetuar në atë zonë, ngjarja më e madhe ishte prishja e dy shtëpive të vogla përdhese dhe ndërtimi i dy pallateve të rinj në hapësirën prapa, në një distancë që sot do të quhej kulmi i lluksit: pothuaj sa bulevardi Zogu I. Dhe diçka tjetër: ndërtimi i pallateve të rinj u bë me punë vullnetare, që do të thotë se punën e të burgosurve e zëvendësoi puna pa pagesë, jashtë orarit normal të punës së zakonshme, e “masave popullore”, do me thënë pjesa tjetër e popullsisë, ajo që nuk ishte e mbyllur në burgun me hekura.

Ashtu sikurse shumica e bashkëqytetarëve të mi, edhe unë lëviz nëpër qytet, në pjesën më të madhe të kohës,

me makinë: fillimisht me kënaqësinë e ngarjes; më tej të domosdoshmërisë - të udhëtosh me autobuz duhet ta kesh kohën e lirë pa hesap; dhe, shpesh, edhe për shkak të rutinës ose të motit. Por me çmimin e benzinës që ka vajtur ku s'mban më, si dhe të shtimit të vazhdueshëm në peshë për shkak të pasivitetit që të jep makina, përpiqem ta marr me sportivitet dhe të shkoj në punë në këmbë. Dhe më bie të kaloj përsëri në rrugën që u rrita, nga “21 dhjetori”, por që nuk njoh më jo vetëm asnjë nga banorët që kalojnë aty, por edhe vetë zonën.

Për një periudhë në shpërbërje, sikundër ishte ajo pas viteve '90, që bëri rrëmujë, bashkë me idetë e teoritë tona për zhvillim, edhe qytetet e njerëzit, duket se gjithshka që ishte e mundur dje, është në kufijtë e absurdit sot. Pothuaj të gjitha katet e para janë përshtatur në dyqane - me që ra fjala, pronarët e tyre quhen më fatlumit - bën përjashtim vetëm apartamenti i fundit në pallatin pranë rrugës “Myslym Shyri”. Në të tre pallatet buzë unazës duhet të jenë afro 51 dyqane, me një larmi të jashtëzakonshme në llojin e shërbimeve që ofrojnë, duke filluar nga rrobat e këpucët, deri tek kafenetë e dyqanet e mishit dhe të ushqimeve, një ideologji zhvillimi që, si me copy-paste, gjendet pothuaj në gjithë Tiranën e, në një vështrim më të gjerë, në gjithë Shqipërinë. Meqënëse kaloj në orë të ndryshme të ditës, vështroj dhe kërkoj blerësit e mundshëm, por ndonëse dyqanet janë plot dhe me çmime të ulëta, ka shumë pak blerës. Moda e ofertave ka përfshirë edhe dyqanet e rrugës, por tabelat konkurruese, të tipit “Çdo artikull 1000 lekë” nuk i bëjnë përshtypje njeriu. Kafenetë u shërbejnë më shumë banorëve të pallatit - secila prej tyre ka nxjerrë nga 3-4 tavolina në trotuar dhe muajt e verës duken të jenë

më fitimprurësit; në trotuar, gjatë gjithë gjatësisë së këtyre pallateve, në mëngjes herët deri aty nga ora 14.00, sheh fshatarë që në grupe të vegjël shesin prodhimet e stinës. Në rrugë kalohet ose sepse ke shtëpinë, ose sepse është në rrugën për në shtëpi, ose për punë. Asgjë karakteristike që të tërheqë blerës ose vizitorë të mundshëm nga lagjet e tjera, të mos guxojmë të mendojmë për turistë që vinë nga anë e anës sepse zona ka emrin "21 dhjetori" ose sepse është një dëshmi e "tipologjisë së urbanizmit komunist" dhe ka diçka për të parë, diçka për të mbajtur shënim, diçka për të sjellë si argument! Kush ka pasur kohë në këta 20 vjet të mendojë për gjëra të tilla! Çdo gjë është fryt i nismave individuale të banorëve të kateve të para, që në luftë për të siguruar të përditshmen, me mendjen e tyre janë në rregull: kanë marrë maksimumin nga rrëmuja e përgjithshme! Janë pjesët, por mungon e tëra, në të gjitha kuptimet. Pjesa është në funksion të personales dhe jo të së tërës, sepse e tëra është joekzistente. Vetja më duket si emigrante. Asgjë nuk të kujton se je në një nga lagjet më të vjetra të kryeqytetit. Çfarë bëmë? Fakti që janë disa njerëz që po korrin a shijojnë frytet e investimit të tyre, nuk justifikon, as arsyeton, se e mira e tyre është e mira e të gjithëve, thotë Nietzsche! Për më tepër, na këshillon që të jemi të kujdesshëm.

Me një histori relativisht të shkurtër zhvillimi, që daton vetëm në vitin 1614, Tirana në prag të 400 vjetorit të formimit të saj ka pak të ofrojë: pak histori, pak arritje, pak traditë. Gjithshka me pikatore! Secili sistem mbajti pak, për të mos thënë asgjë, nga ai i mëparshmi: çdo

pushtet pasardhës drejtoi gishtin tek e kaluara dhe quajti të padenjë çdo arritje. Tirana e kohës së turqisë, me ndërtesa të ulëta ndërtuar me materiale rrethanore të paqëndrueshme, u zëvendësua nga Tirana e italianëve; kjo e fundit nga Tirana e komunistëve dhe, për 20 vitet e fundit, nga Tirana e "politikanëve të tranzicionit". Rritja e pakontrolluar e popullsisë, që për fat të keq, në masën më të madhe, u konceptua thjesht si shpërngulje në Tiranë, si ndërrim rezidence, jo si ndryshim në mënyrën e të menduarit dhe të të jetuarit është një nga karakteristikat e periudhës së fundit e cila, për më tepër, nuk u shoqërua me legjislacion të përshtatshëm ose plane konkrete për veprim nga ana e qytetit. Në mungesë të tyre, shtuar edhe mungesën e ndjenjës së përgjegjësisë se qyteti është një pasuri që duhet ruajtur si dhe të rrënjëve e kujtimeve që i lidhnin me të, katrahura që e pamatë. Nga ana tjetër, populli thotë se "rrushi sheh rrushin". Rezultati është ky ku jemi. Më shumë se një qytet komunitar, ku njerëzit interesohen për njëri-tjetrin dhe për të mirën e të tërëve, Tirana ngjason me një kompani biznesi, ku secili individ kërkon të marrë sa më shumë dhe vetëm për vete, ku e drejta dhe e gabuara perceptohet ndryshe dhe normat e vlerat jo domosdoshmërisht janë të përbashkëta.

Mënyra se si po zhvillohet Tirana në përgjithësi dhe lagje ose zona të saj në veçanti, ka mungesë vizioni, mendimi, përshtatje, lidhje të së vjetrës me të renë që do mund të krijonte rrugë ose lagje të afta të rigjeneronin vlera, të ishin atraktive, të prodhonin para jo vetëm për disa familje, por për të gjithë komunitetin, sikundër ndodh në pothuaj të gjithë kryeqytetet e botës. Çfarë do të bëjmë?

JESOLO. ATY KU TURIZMI ËSHTE SHNDËRRUAR NË ART

Është vera e dytë që kalojmë pushimet në Jesolo, një zonë e vogël dhe e mrekullueshme turistike pranë Venecias, buzë detit Adriatik. Vjet u bë shkak një nga të njohurit tanë - nipi i tij, i cili sikundër edhe 400 shqiptarë të tjerë, punon në një nga hotelet e qytetit. Mbas një takimi të rastësishëm, të prekshëm sikundër jemi të gjithë për emigrantët tanë, biseda u zhvillua kryesisht rreth punës, vendit, njerëzve, kushteve në anën tjetër të Adriatikut. Dhe çdo përgjigje e tij, gjithmonë shoqërohej me një “uhahu” admiruese nga ne: ka shumë turistë, kryesisht gjermanë e rusë, njerëzit janë shumë të mirë dhe i duan shqiptarët, mjedisi është i shkëlqyer, ushqimi i gatuar me finesë dhe kryesisht kuzhinë e vendit, pastërti dhe kulturë, ka shumë vende të tjera, përveç plazhit, që mund të shihen dhe argëtime që mund të ndiqen, bëjnë turizëm prej afro 70 vjetësh. Këtej natyrshëm lindi ideja: për pushime në Jesolo?

Fillimisht ishim në mëdyshje. Arsyeja kryesore ishte thjesht sepse qyteti gjendet buzë detit Adriatik dhe, sa herë përmendet ky det, e shoqërizoj me plazhin e Durrësit, ku të

shih syri vetëm rrëmujë dhe nuk funksionon asnjë rregull, përpos zhurmës që nuk të ndahet nga mëngjesi në darkë, në kundërshtim të plotë me synimin për të pushuar. Të mos flasim për mungesën e ujit dhe të energjisë elektrike! Ka vite që shkojmë në plazhin e Durrësit vetëm gjatë periudhës së dimrit, kryesisht për ndonjë drekë me bazë peshku dhe shëtitje të shkurtër buzë detit. Dhe nuk mendoj se jemi të vetmit! Duke pasur në mendje Adriatikun tonë, të paktën edhe për 20 vitet e ardhshme deti Adriatik përjashtohet nga opsionet e pushimeve. Por kurrë mos thuaj kurrë, thotë populli. Kështu shmangëm detin Jon dhe Jugun e Shqipërisë, dashurinë tonë pothuaj të vetme për pushime verore, hapëm hartat dhe kërkuam opsione shtesë për në Jesolo: Venecia dhe ishujt që e rrethojnë si dhe udhëtimi me makinë gjatë gjithë vijës Tiranë-Budva-Dubrovnik-Rijeka-Trieste-Jesolo i shtuan opsionet pro idesë fillestare dhe e zhvendosën përgjigjen drejt po-së. Sivjet jo vetëm që ishim nismëtarët për t'u kthyer përsëri në Jesolo, por shtuam edhe numrin e njerëzve që u bashkuan me ne për këto pushime speciale.

Jesolo – pushime speciale

Jesolo është një qytezë e vogël turistike me një vijë bregdetare afro 13 km dhe me jetë sezonale, nga prilli deri në tetor. Pushimet që të ofrohen janë ato klasike: rërë, diell, det plus komoditet dhe aktivitete. Kohë më parë – flasim për periudhën para viteve '90, kur pushimet e pothuaj të gjithë tiransve vërtiteshin rreth plazhit të Durrësit, u fol se plazhi do të mbyllej se është ndotur – një pjesë e mirë e

kanalizimeve të ujrave të zeza e të bardha që në atë kohë përfundonin në det. Në Jesolo është ndryshe: shfrytëzimi i mirëfilltë i plazhit daton që para Luftës së Dytë Botërore dhe përsëri deti është i pastër dhe rëra kristal. *Benvenuti in Jesolo*, vendi ku më shumë se natyra të mahnit këmbëngulja për shndërrimin e një natyre të zakonshme plazhi në një oaz të mrekullueshëm pushimi e argëtimi!

Brezi i rërës, i pastër dhe i nxehtë, shtrihet deri në një thellësi të caktuar dhe ruhet me fanatizëm. Tabela të ndryshme tregojnë se cila pjesë u takon hoteleve dhe cila pushuesve ditorë që janë të shumtë – për pushuesit ditorë dhe banorët e qytetit është gjithë brezi ranor që fillon nga bregu deri në një thellësi prej afro 15 metrash, ndërkohë që është shumë e thjeshtë të depërtosh nga rruga për në buzë të detit, pavarësisht faktit se plazhet u takojnë hoteleve private; aksesoret e plazhit janë të mirëllogaritur e të vendosur në vendin e duhur: çadra, shezlongë, banja publike, dushe e kioska të vogla për t'u freskuar, ngrënë diçka të thjeshtë apo për të pirë ndonjë kafe speciale. Qetësia është absolute: ndonëse plazhi është i mbushur plot e përplot të duket sikur je vetëm ti! Qetësinë e thyen herë pas here, ose zëri i altoporlantit që lajmëron aktivitetet e shumta që zhvillohen mbasdite vonë apo thërret emrin e ndonjë fëmije që për pak minuta i ka humbur syve e vëmendjes së prindërve, ose afrikanët që, ndryshe nga altoporlanti, me gjysmë zëri dhe të ngarkuar me produkte të ndryshme, përpiqen të të shesin mallra “firmato” me çmime qesharake, për shembull një çantë prada, një peshqir a shall valentino për 10-15 euro. Sigurisht që nuk duhet të gënjeheni dhe të blini - thjesht nuk janë cilësorë, sado të bukur të duken dhe tundues të jetë çmimi - nuk rrojnë më shumë se 4 muaj.

Shmangni edhe masazhoret e ashtuquajtura japoneze ose tajlandaze! Mos i shihni në sy kur kalojnë pranë jush dhe të jeni të sigurt që nuk ndalojnë, për më tepër, qyteti nuk i nxit shitje të tilla dhe ka filluar një fushatë ndërgjegjëzimi.

Nuk e di nëse një pushues gjerman kërkon në një plazh dhe vlerëson si pozitive po ato gjëra që kërkojnë edhe unë, për të konkluduar në “pushime klasike perfekte”. Por, e vetmja gjë që më dallon besoj nga ta është se jetoj në anën tjetër të të njëjtit det, kam bërë 1150 km për të mbërritur deri atje dhe refuzoj të bëj plazh, ose të shpenzoj paratë e mia, në “detin tim”, nga i cili më ndajnë vetëm 38 km! Sigurisht, jo për mungesë patriotizmi! Sjell ndër mend një kushërirën time që ka blerë shtëpi në “plazhin” e Durrësit dhe që për të dalë në plazh ka vetëm dy variante: ose të bëjë me kilometra rrugë në kërkim të një plazhi publik (?), ose të qëndrojë e ulur në rrugicën e vetme publike, pingul me vijën bregdetare, që ndan dy plazhe private, 1.5 metra e gjerë. Nuk shtrihet dot pasi është më e gjatë se 1.5 metra dhe i bie që, ose koka, ose këmbët, të shkojnë në plazhin privat, por që gjendet gjithmonë ndonjë që s’di të flasë as shqip që ta kujton se po shkel në pronë private dhe të çohesh sa më shpejt, ndryshe ...! Sigurisht që nuk jam kundër pronës private, por mënyrës se si administrohet “prona publike” që, edhe buzë detit ku ke vajtur për t’u shplohur, të kujton mbrapshtësinë e gjërave të vendit ku jeton dhe të njerëzve që drejtojnë.

Zona që bëhet plazh nga zona ku fillojnë hotelet ndahet nga një rrugicë afro 3 metra e gjerë, e shtruar e tëra me pllaka, paralel me gjithë vijën bregdetare. Rrugica frekuentohet që herët në mëngjes nga të apasionuarit pas vrapit ose ecjes. Përveç se e njëtrajtshme dhe e shtrirë në gjithë gjatësinë

e plazhit, të tërheq vëmendjen emërtimi i saj, segmente-segmente, sipas disa prej artistëve bashkëkohorë më të njohur italianë, një lloj mirënjohje për punën e veprën e tyre dhe që qyteti i fton çdo vit për të kaluar pushimet. Iniciativa zë fill më 2001, mbas ristrukturimit të plotë të saj, si dhe falë largpamësisë së presidentit të asaj kohe për promovimin turistik të qytetit, z. Amorino de Zotti. Rrugica u quajt “Lungomare delle stelle”, e ngjashme pak a shumë me “Walk of fame” në Hollywood. Në të kanë arritur të gdhendin emrin e tyre Gina Lollobrigida, Alberto Sordi, Mike Bongiorno, Carla Fracci, Nancy Brilli, Christian de Sica, Andrea Bocelli, Katia Ricciarelli, Mara Vernier, Lino Banfi, Sophia Loren e Umberto Veronese. Sivjet i ftuari i nderit ishte Alessandro del Piero dhe shumë shpejt është edhe ceremonia e inagurimit të segmentit të *lungomare-s* që do të mbajë emrin e futbollistit të njohur. Kërkova të kujtoja ndonjë iniciativë të ngjashme të ndërmarrë edhe në plazhin në anën tjetër të Adriatikut, por në mend sillja Kalin e Trojës, peskavica maqedonase dhe fërgesë tirone ...

Çdo gjë duket e mirëmenduar dhe e studiuar. Për të rritur jo vetëm cilësinë e jetës, por edhe të peisazhit ekonomiko-mjedisor si dhe për të siguruar një zhvillim të qëndrueshëm, si një të tërë të qytetit, më 1993 qyteti ftoi një nga urbanistët më të njohur të kohës, Kenzo Tange, që njihet edhe si projektuesi i Japonisë moderne, për të dhënë vizionin për të ardhmen e qytetit dhe për të hartuar masterplanin e tij – informacion që gjendej në ekspozitën fotografike rreth historisë së qytetit të hapur në një nga mjediset e dy kullave që gjenden në “Piazza Drago”.

Hotelet janë nga 2-6 kate dhe me shumë mundësi zgjedhjeje: me vetëm mëngjes, me mëngjes e darkë ose

pension i plotë. Kryesisht janë hotele me 3 dhe 4 yje dhe çmimet për “*all inclusive*” variojnë nga 56 euro/person deri në 165 euro ose më shumë për person.

Qyteti përshkohet mepërmes nga një rrugë me trafik të kufizuar gjatë ditës dhe ku gjatë mbasdites deri në darkë vonë mund të kalojnë vetëm këmbësorë. E gjithë rruga rrethohet nga dyqane pa fund dhe në sheshet e shumtë zhvillohen aktivitete, koncerte e panairë. Një nga panairët më të bukur me prodhime *bio* është ai i “Levandës” (bimës me emrin latin *lavandula*), që zhvillohet për dy-tre ditë në fund të korrikut. Mos humbisni rastin ta vizitoni! E mira është në diellin e pasdites, pasi panorama është shumë e bukur, e përbërë nga vetëm dy ngjyra: e bardha dhe lejlaja, dhe një aromë e jashtëzakonshme që ndjehet që nga larg, por mos përjashtoni edhe mundësinë e blerjes së një a dy produkteve, veçanërisht një lloj vaji erëmirë që prodhojnë për duart.

Rruga ka një bukuri të veçantë dhe merr nuanca të ndryshme gjatë ditës. Në mëngjes herët – deri në ora 8.00, është shumë e qetë. Qyteti zgjohet vonë! Pothuaj të gjithë dyqanet janë të mbyllur, me përjashtim të disa kafeneve dhe dy librarive që shesin vetëm gazeta në këtë orë të ditës. Kafja është një nga kënaqësitë e mëngjesit – të shijon çdo gllënjëkë e saj! Çmimet e kafes variojnë nga 1-2 euro. Edhe dreka e rrugës, nga ora 12.30-16.00 është shumë e qetë dhe me ngjyra të mrekullueshme. Duket sikur çdo gjë merr dritë e shkëlqen. Pothuaj të gjithë dyqanet mbyllen. Shëtitja me biçikletë në këtë orë të ditës është një nga kënaqësitë që nuk duhet humbur. Çdo hotel ka biçikletat e veta që i vë në dispozicion të pushuesve pa pagesë dhe është një mënyrë shumë e mirë jo vetëm për të shëtitur

gjithë qytetin, por edhe për të kontrolluar disi kaloritë e një dreke të bollshme ose për të shmangur dembelinë e pasdrekës. Një mundësi për të shëtitur dhe njëkohësisht për të bërë pak sport në këtë orë të ditës është edhe marrja me qira e një lloj karroceje që pedalohet nga 4-6 persona, me një çmim për 8-10 euro/gjysmë ore deri në 17 euro/orë. Darka është finalja e një dite të zakonshme plazhi: fillon kryesisht pas orës 20.00 dhe zgjat deri vonë pas mesnate. Të gjithë në rrugë! Shëtitja e zakonshme që një herë e një kohë tek ne bëhej buzë detit, në Jesolo bëhet në atë rrugë të bukur, ndërkohë që mund të zgjedhësh për të pirë diku një birrë, për të shijuar një akullore, për të parë një koncert ose për të vizituar ndonjë nga ekspozitat e shumta që hapen në qytet, që nuk duhet lënë pa përmendur edhe ekspozita e skulpturave të rërës, çdo vit me një tematikë të veçantë. Besoj se është një nga pedonalet më të bukura që kam parë ndonjëherë. Sipas nuses së pronarit të hotelit ku qëndronim, në atë pedonale shëtisin çdo vit afro 25 milionë turistë. Ndërkohë bëni kujdes me dyqanet që gjenden në buzë të rrugës dhe mos i shpenzoni të gjitha paratë, pasi një variant shumë më i mirë për të bërë *shopping* është *outlet*-i që gjendet vetëm pak kilometra larg Jesolos, përgjatë autostradës Venecia-Trieste (A4), hartën e të cilit mund ta gjeni pranë çdo hoteli: me çmime të mira dhe shumë cilësore, veçanërisht nëse pazarin e vitit e keni lënë për aty.

Një nga argëtimet më të bukura është vizita në Venecia dhe në dy ishujt pranë saj: Murano dhe Burano, i pari për kryeveprat e punimit të qelqit dhe i dyti për qëndisimat karakteristike. Venecia është një përrallë më vete. Të duket sikur kthehesh prapa në kohë dhe jeton në vitet ‘800. Në çdo çast ka diçka që duhet parë e që të tërheq vëmendjen,

që do ta marrësh me vete si kujtim: një maskë veneciane, një shëtitje në sheshin San Marco dhe në Ponte Rialto, një foto ku në sfond është ura e psherëtimave, pallati duka, gondolat ... Të gjitha lëvizjet bëhen nëpërmjet trageteve të vegjël – autobuzët e linjës. Sa shumë vizitorë! Sa shumë para që shpenzohet nga turistët në atë qytet!

Rruga

Në Jesolo mund të shkohet me avion ose me makinë. Varianti i parë është i shkurtër dhe shumë komod. Në këtë rast shfrytëzohet aeroporti i Venecias dhe më tej zgjidhet me autobus ose me mjete të tjera transporti. Ka vetëm vështirësinë që gjatë ditëve të pushimit lëvizjet do jenë të kufizuara, ndonëse në qytet është linja e autobuzëve dhe funksionon edhe shërbimi taksi. Personalisht preferoj variantin me makinë. Në vajtje ja vlen të nisësh një ditë më parë dhe të shmangësh autostradën – është më gjatë por me një natë fjetje sa më afër Rijekës rikuperon energjitë dhe lodhjen, për më tepër e gjithë rruga është shumë e bukur, veçanërisht nëse e ke për herë të parë. Në kthim është mirë të merret autostrada, në të cilën futesh pothuaj sa del nga Jesolo dhe shkon pothuaj deri në Dubrovnik. Një rrugë e shkëlqyer. Por shmangni sa më shumë qëndrimet dhe kontaktet në Kroaci: njerëzit janë të pasjellshëm dhe aspak të gatshëm të ndihmojnë turistët; nuk ofrojnë asnjë shërbim me euro – të tregojnë gjithmonë derën, që do të thotë se duhet të shkosh në *change* dhe hajde të gjesh ndonjë. Kini kujdes edhe me policinë rrugore – janë më keq se këtu te ne. Sapo kishim kaluar Dubrovnikun dhe

po merrnim një të tatëpjetë të vogël – në pesë automjete që ishim në radhë dhe në distancë konstante nga njëritjetri për minuta të tëra udhëtim, na ndalën vetëm ne që ishim diku në mes dhe me targa të huaja. Biseda me policët mund të përmblihet pak a shumë kështu: 35 euro gjobë sepse jeni me shpejtësi. Me çfarë shpejtësie? 53 km/orë. Pse nuk i ndalni edhe makinat e tjera? Nuk kuptojmë anglisht. Dhe gjoba duhet paguar te polici, në dorë! Një vend që ka hyrë në Europë! Policët të kujtonin krejtësisht policinë tonë: kishin zënë “pusi” me një makinë civile në një vend pothuaj të padukshëm nga rruga dhe me matësin e shpejtësisë brenda në makinë ndalnin kë t’u tekej. Më shumë se për të qarë, ishte për të qeshur. Pak a shumë i njëjti problem edhe në supermarket: asnjë nuk flet anglisht dhe krejtësisht indiferent kundrejt çfarëdo kërkesë që mund të kesh si i huaj – po flasim në shkëmbim të parave! Kujtoj sa të sjellshëm jemi ne si komb, veçanërisht kur kemi të bëjmë me të huaj: çfarë të duhet, do të flasësh në telefon? Fol nga telefoni im sa të duash. Do të shkosh në filan vend, të çoj unë! Jo, në Kroaci nuk dëgjoje asgjë të tillë. Kur kërkoje të bleje me euro sikur lypje lëmoshë dhe do të ta falnin.

Udhëtimi i kthimit zgjat minimalisht 15 orë, por mos harroni të llogarisni edhe kalimet kufitare – janë plot katër shtete që kalohen: Italia, Kroacia, Bosnje-Hercegovina, Kroacia përsëri, Mali i Zi dhe, së fundmi, në mëmëdhe. Një përvojë e bukur!

Gazeta “Mapo”, 10 gusht 2013

NGJELA DHE REFLEKSIONET E TIJ
PËR “PARKUN NJERËZOR SHQIPTAR,
1991-1996”

*Refleksione rreth librit
“Përkulja dhe rënia e tiranisë shqiptare”
Vëll. 3, 2013. Autor Spartak Ngjela,
Botues UET Press*

“Librat, thotë poeti Jean Paul, janë letra të gjata që ndahen mes miqsh”, kështu e fillon esenë e tij Peter Sloterdijk “Rregulla për parkun njerëzor”. “Shkrimi, vazhdon më tej Sloterdijk në të njëjtën esë, jo vetëm që hedh një urë midis miqësish tashmë të lidhura, ndonëse gjeografikisht të largëta, por shpesh merr formën e një joshje - e cila në gjuhën e magjisë së Europës së vjetër quhet *actio in distans* - me synimin për ta ftuar që t’i bashkohet rrethit.” Më duket se nuk mund të gjeja hyrje më domethënëse për këtë analizë rreth refleksioneve të autorit Spartak Ngjela për një prej periudhave më të dhimbshme e, njëherazi më dramatike, të historisë sonë moderne 1991-1996 paraqitur në vëllimin e tretë të librit “Përkulja dhe rënia e tiranisë shqiptare”, sikundër nuk mund t’i shpëtoja ngasjes për t’u bërë pjesë e rrethit!

Së pari, sepse bëhet fjalë për Spartak Ngjelën, karizmatik dhe me kulturë, arrogant dhe i sjellshëm, kryeneç dhe tolerant, por gjithmonë në “këmbë”, dje dhe sot pjesë e lidërshit (formal, por më shumë informal),

me një status të veçantë, që të gjithë i drejtohen me ‘Avokat’, grafika e biografisë së të cilit mund të paraqitet mrekullisht nëpërmjet një “sinusoide”, vlera e amplitudës së të cilës, në rritjet dhe rëniet e saj, në vlerë absolute, rrallë mund të konkurrohet nga ndonjë shqiptar tjetër, bashkëkohas i tij. I lindur në një familje që ishte pjesë e elitës në kohën e diktaturës, edukimi dhe karriera e tij u mbështet nga të gjitha mekanizmat që prodhonte ajo kohë, por që shumë shpejt u ndërpre në mes, për shkak të izolimit për një periudhë afro 15 vjeçare, në një nga burgjet më të tmerrshëm të regjimit. Burgjet e diktaturës, jo vetëm Spaçi, janë shenjat më mbresëlënëse që ngrihen në diktaturë. Sikundër shprehet autori:

“Për pesë vjet kisha ndenjur në një dhomë burgu me tim atë dhe sërish jeta më ishte dukur po e njëllotë, sikur isha vetëm me veten time, edhe pse në fakt afërsia fizike me babanë tënd në një dhomë burgu është një përjetim i veçantë, që shumë pak njerëz e kanë përjetuar” (f. 16)

Së dyti, sepse gjykimi i tij për ngjarjet bëhet nga një këndvështrim *sui generis*, i zhvilluar nga forma të ndryshme politiko-kulturore nga ato të “shumicës nga ne”, që periudhën e regjimit e kaluam kryesisht në bangat e shkollës dhe edukimi e karriera ndoqën trajektoren e zakonshme të pjesës më të madhe të të rinjve shqiptarë. Akoma, gjykimi i Ngjelës për ngjarjet ka rëndësi pasi është pjesë e një gjykimi më të përgjithshëm, që haset pothuaj te të gjithë ata që vuajtën në burgjet e komunizmit dhe që vetë Ngjela i veçon herë pas here nga pjesa tjetër e

popullsisë me emrin “shtresa e të persekutuarve”. Për më tepër, kërkon (*asaj, shtresës*) t’i japë një rol që kurrë nuk arriti ta përmbushë:

Enver Hoxha e kishte detyruar shtresën e persekutuar të Shqipërisë që të jetonte brenda suazës së vet të paditur, të trembur dhe të izoluar. Por, befasisht kjo shtresë kishte dalë në skenën e politikës shqiptare si shtresa që duhej të kishte në dorë kartën morale të së ardhmes së afërt në Shqipëri. Realisht i takonte kjo kartë, sepse regjimi ose sistemi politik që i kishte luftuar deri në krim, tani kishte rënë, dhe shqiptarët në pjesën dërmuese të tyre i kishin dhënë të drejtë kësaj shtrese. Nëntëdhjetë për qind e shqiptarëve të asaj periudhe, ndienin një ndjenjë respekti për shtresën e persekutuar. (f. 280)

Së treti, sepse ky vëllim i tretë i refleksioneve të tij shkruhet afro 15 vjet mbas kohës së zhvillimit të ngjarjeve, gjatë të cilave jo vetëm ka pasur kohë të reflektojë, por e kemi parë edhe të ndryshojë miqtë e armiqtë, të kalojë nga një grup në një tjetër ose nga një bindje në një dilemë. Mbi të gjitha, të bëjë zgjedhjen: t’u japë përgjigje të gjitha pyetjeve “të vjetra” që shumë nga ne kanë për ato kohë apo të devijojë, jo për të dizinformuar lexuesin, as për mungesë sinqeriteti, por për të ruajtur surpriza për një botim të ri.

Lexuesi që merr librin e Ngjelës sot në dorë, pavarësisht moshës e edukimit, ka mundësinë të kthejë vështrimin drejt një periudhe për të cilën pak nga ne janë krenarë. Fakti që ajo periudhë duket totalisht e tejkaluar edhe për Ngjelën, i heq ngarkesën emocionale analizës. Gjithashtu, trajta që ka situata e sotme politiko-kulturore, besoj se

asgjëson çdo iluzion të së djeshmes, pavarësisht burimit që mund të ketë pasur.

Parku ynë human 1991-1996 është nga më të diskutuarit e shqetësuesit dhe “funksionimi e mirëmbajtja e njerëzve në të” shpesh merrte trajtën e një misioni të pamundur. Ngjela ka marrë përsipër të japë ndihmesën, sipas variantit “Ngjela”, në zbardhjen e ngjarjeve të asaj periudhe, me shumë personazhe që vazhdojnë të jenë po personazhe. Me një gjuhë të pasur dhe një retorikë të thjeshtë e të qartë, “letra” nis në vetën e parë njëjës e përfshin vetëm atë dhe përfundon në vetën e tretë shumës e na përfshin të gjithëve ne; hapet me daljen nga burgu, kur i vetëm, në kërkim të miqve apo mundësisë për të patur të tillë, lëviz rrugëve të Tiranës dhe mbyllet me ngjarjet e dhimbshme të vitit të hidhur 1996.

Ngjela *Akuzon*: Ne, shqiptarëve, koha e re, që po vinte, po na gjente të paafte për të rikrijuar veten, edhe tani që kohën e kishim krejtësisht në favor;

Analizon: A do të mund, opozita e re, ta drejtonte Shqipërinë realisht drejt reformave demokratike?

Shtron pyetje të tipit: Liderët e rinj të partive që po lindnin do orientoheshin nga absolutizmi apo pragmatizmi?

Duke përdorur këto argumente, që në pamje të parë mund të duken shumë modeste e pothuaj të lëvruara nga të gjithë, Ngjela është nxënës e mësues, lider dhe pjesë e turmës.

Akoma, e rëndësishme është të theksojmë se projektet intelektuale të Ngjelës gjithmonë hapin debate, pak rëndësi ka se çfarë forme kanë: libër apo bisedë e thjeshtë, letër apo foltore auditori. Libri të fton të reflektosh për dalldinë ç’humanizuese të atyre viteve, bazuar sigurisht

në perceptimet dhe gjykimin vetjak të lexuesit dhe që jo domosdoshmërisht mund të përputhen me ato të Ngjelës, për shembull sa i takon mënyrës së shpërblimit të “*homo inhumanus*”-i të shfrenuar” në ngjarjet e asaj periudhe. Sidoqoftë, në mënyrën si shtjellon ngjarjet duken të përziera ndenja e lirisë me atë të frikës nëse do mund të kapë ritmin; dhe maturia: e ka nisur shtruar, plot 1732 faqe në tri vëllime.

Tema e fshehur jo vetëm e librit, por edhe e vetë ekzistencës së Ngjelës është ftesa për t’u ndarë nga një e kaluar për një të ardhme më të mirë dhe ajo e besimit të fitimit të luftës për njeriun ndërmjet “përpjekjeve për shtazërim me ato për shndërrimin në një kafshë të butë shtëpiake”.

Kërshëria për të lexuar librin e Ngjelës ka edhe një arsye tjetër. Leximet e mira i zbusin zakonet, thotë Sloterdijk. Arsyeja për të cilën vëllimi i tretë i autorit Ngjela vazhdon të ngjallë të njëjtin interes sikundër edhe dy të parët, është pikërisht sepse libri i Ngjelës është një libër i mirë!

POST PANAIR: SALE, ZUCCHERO E CAFFÉ!

Thonë që gjërat e mira vinë andej nga s'i pret! Ndryshe nga sa pritej, panairi i librit i këtij viti të ofronte një mjedis të qetë, ndjellës e komunikues. Vizitorë që shëtisnin nga stenda në stendë në kërkim të autorit apo titullit të preferuar, biseda, aktivitete të ndryshme dhe, me pak fat ose informacion të mirë mund të takoje edhe autorin e kërkuar. Botuesit ishin kujdesur jo vetëm për zgjedhjen e titujve dhe të autorëve, por edhe me paraqitjen e këtyre të fundit në stendë në orare të ndryshme të ditës.

Trendi i zgjerimit të mediave me shtëpi botuese

Botimet e viteve '990 të Shtëpive Botuese private që u shfaqën në tregun shqiptar, ishin kryesisht tituj klasikë e autorë të njohur më parë nga lexuesi, pra tituj që e kthenin shpejt investimin në parë fizike. Në atë kohë ishte e vështirë të bëje profilin e një shtëpie botuese, kaq të larmishëm ishin titujt: në fakt, çdo gjë që shitej, botohej. Sot, afro 20 vjet më

vonë, me një përvojë që nuk mund të thuhet më e re, pothuaj të gjitha shtëpitë botuese shqiptare kanë krijuar fizionominë e tyre. Por përditë e më shumë po bëhet e qartë se puna e botuesit është bërë jo vetëm më e vështirë, por dukshëm edhe konkurruese, pasi forma të ndryshme komunikimi ofrojnë mundësi pa fund për të botuar dhe promovuar një vepër personale, një fenomen që në botë po merr përmasa gjithnjë e më të mëdha. Kështu në ShBA, për herë të parë në vitin 2009, numri i librave të vetëbotuar në *ueb* e tejkaloi numrin e librave të botuar nga botuesit konvencionalë. Nga ana tjetër, në përpjekje për të 'rrembyer' sa më shumë lexues, botuesit promovojnë me të gjitha mënyrat autorët e tyre: në lajme, reklama, gazeta, emisione të ndryshme televizive, rrjete sociale, kudo ku ekziston një potencial për të krijuar opinion, për të ngacmuar ose ngjallur kërshëri. 'Imazhi shet', është një aksiomë që funksionon kudo ku ka marrëdhënie mall-treg. Botimi në analizë të fundit është biznes dhe, si i tillë, kërkon që likuiditetin t'a shndërrojë në para. Falë rolit parësor që luan media në krijimin e këtij imazhi, edhe në Tiranë po vihet re trendi i bashkëpunimit të Shtëpive Botuese me mjedise të ndryshme mediatike, kryesisht me gazeta e televizione dhe, në një vështrim më të vëmendshëm, fenomeni i zgjerimit të mediave vizive e atyre të shkruara edhe me shtëpi botuese, duke e rimodeluar biznesin në funksion të një të ardhme me shumë të panjohura.

Sale, zucchero e caffè

Ky është në fakt titulli i librit më të ri të Bruno Vespës që sapo ka dalë në qarkullim në Itali. Ndoshta jam nga

lexuesit e parë shqiptarë që pata fatin ta kem në dorë kaq shpejt. Mondadori, shtëpia botuese e Vespës në Itali, pati mirësinë të na dërgonte një kopje që mbërriti po atë ditë që Vespa merrte avionin e kthimit në Rinas për në atdhe. Libri e ka marrë titullin nga një periudhë e hershme e jetës së Vespës, kur gjyshja, Aida, sa herë e çonte në dyqan e porosishte: mos harro të blesh kripë, sheqer e kafé. Një zakon, thotë Vespa që e ruaj edhe sot e kësaj dite dhe, sa herë ime shoqe shkon në pazar, e porosis: blej kripë, sheqer, kafé dhe ndonjë gjë tjetër. Libri përshkrohet nga kujtime të ëmbla e të hidhura. Nga tri asortimentet që mbushin çantat e të shoqes së Vespës kur bën pazar, dy prej tyre, kaféja e sheqeri, edhe për mua janë burim emocionesh e ndjenjash të ngrohta. Sa herë shkoja te ime vjehrrë - për fat të keq nuk jeton më -, e dija se më priste një kafé e ngrohtë dhe e mirë. Çfarëdo të ishte duke bërë, i linte të gjitha dhe më thoshte: ty po të prisja për kafënë. E bëj unë, se ti je lodhur, vjen nga puna. Pastaj, ty të pëlqen vetëm nga dora ime. Vërtet, bënte kafënë më të mirë në botë! Sot, sa herë shkoj të shoh time ëmë, të vjetër e të sëmure, më pyet: nuk e di, të vajti mendja të më sjellësh sheqer? Çdo gjë i shijon me sheqer. Dy gra të ëmbla, që secila me mënyrën e saj, më kanë dhënë gjithmonë nga vetja dhe u jam mirënjohëse për dashurinë që më kanë falur.

Me Vespën pata mundësinë të bashkëbisedoja disa minuta në stendë, në boshllëqet e pakta që krijoheshin nga nënshkrimi i një autografi në një tjetër. Përtej të qenit i mrekullueshëm në mënyrën si buzëqeshte, fliste, shkruante e jepte autografe - kishte mësuar të shkruante shqip 'urime' -, erdhi edhe pyetja klishe për një përfundim, që në fakt ishte shtypa e shkrimit të këtyre radhëve: cili është

romani i përkthyer në shqip, më i shitur këtu në Shqipëri?
Nuk dija t'i jepja një përgjigje të saktë!

Përfaqësimi në stendë – me çfarë librash të paraqitemi dhe a duhet të shesim

Kam afro tetë vjet që e ndjek Panairin e librit këtu në Tiranë në mënyrë aktive dhe gjithmonë më ka habitur fakti që të gjithë botuesit, krahas titujve të rinj, ekspozojnë edhe tituj të botuar vite më parë dhe, pse jo, edhe shumë vite më parë. Në panairin e librit në Tiranë mund të gjesh si libra që mbajnë era myk, ashtu edhe nga ata që sapo kanë ardhur nga shtypshkronja e nuk u është tharë mirë boja. Sigurisht që një nga synimet e botuesve është paraqitja sa më dinjitoze në panair dhe pjesë e kësaj paraqitje është mbushja e të gjithë hapësirës me sa më shumë libra, pasi kjo përkthehet në më shumë kërkesa për botim, por a duhet të vazhdojmë të punojmë me të njëjtën filozofi? Gjithsesi, më pëlqen të sjell dy shembuj: Panairin e Librit të Londrës dhe Panairin e librit në Rusi. Sa i takon Panairin të librit në Londër, së pari duhet të regjistrohesh kohë më parë kundrejt një tarife dhe, e dyta, jo vetëm nuk shiten libra, por botuesit vinë vetëm me botimet e reja. Nuk mund të mendohet të përfaqësohet një shtëpi e madhe botuese me tituj të një viti më parë. Në Londër kanë bërë këtë zgjedhje! Ndërkohë në Rusi zhvillohen tre panaire ndërkombëtarë libri: njëri në prill, në St. Petersburg, dhe dy të tjerë në Moskë, në fillim të shtatorit dhe në fillim të dhjetorit. Sikundër te ne, të gjithë panairët rusë janë të hapur ndaj publikut dhe gjithkush mund të blejë librat që u ofrohen me çmim të ulët.

Duke u kthyer në përvojën dhe gjendjen tonë, e ndjeshme se detyrimi i paraqitjes në stendë vetëm me tituj të rinj (sipas modelit të Londrës) do nxirrte jashtë loje shtëpitë e vogla botuese, mund të gjendet një zgjidhje e ndërmjetme: detyrimi për të ndarë botimet e reja në një vend të veçuar brenda stendës, verifikuar nga Shoqata e Botuesve. Jo vetëm u kursejmë kohë vizitorëve të panairit, por edhe jemi në gjendje të krijojmë një ide se çfarë ka ndodhur me tregun e librit gjatë një viti. Rrallë mund të gjesh njeri, në përfundim të Panairit, që të jetë në gjendje të thotë saktësisht se sa ishte numri i titujve të rinj, ose çfarë përkthimesh të reja kishim këtë vit, ose sa ishin shitjet, ose si ishin shitjet e një autori krahasuar me ato të një tjetri, pra të bësh një analizë të situatës reale të librit të ri. Mund të flasësh vetëm me afërsi! Për më tepër, mund të shtohet edhe versioni i pagesës së vizitorëve në hyrje, pasi ndihmon jo vetëm në identifikimin e numrit të vizitorëve – nuk flasim më në tym se sa ishte numri i tyre, por paratë mund të përdoren për qëllime të ndryshme, përfshirë blerjen e librave dhe dhurimin e tyre për shkollat publike.

Sigurisht, ne nuk mund të shpikim a prodhojmë panaire ndryshe nga bota! Detyronë është t'u shërbejmë sa më mirë lexuesve dhe pjesë e këtij angazhimi është edhe vlerësimi i opsioneve të ndryshme, për të zgjedhur më të mirën.

Gazeta Shqiptare, «Milosao», datë 1 dhjetor 2013

DITA E ZAKONSHME E NJË SHKOLLE PUBLIKE

Është një shkollë e vogël diku në periferi të Tiranës, me afro 450 nxënës, nga të cilët më shumë se gjysma i përkasin komunitetit rom. Nga klasa e parë në të tetën ndesh pothuaj të njëjat mbiemra dhe po ashtu edhe të njëjtat probleme: dikush me prindër të divorcuar, dikush me babanë të vdekur e dikush me të dy prindërit pa papunë. Më i pasuri është fëmija i rojes së shkollës. Në ora 7.45 shkolla është gati për mësim. Nën thirrjen e një mësueseje “Rrjeshtohu ore handikapat i dreqit” kalamajtë-nxënës marrin rrugën për në klasë. Më të dashur janë të vegjëlit. Të mësuar të shahen ngado, veshët e tyre duken indiferentë ndaj kësaj thirrjeje. Sidoqoftë, rrjeshti i përsosur formohet dhe duke ngrënë akoma byreqe me gjizë që kullojnë nga yndyra, të blera për 200 lekë të vjetra diku nga fillimi i rrugicës për në shkollë, marrin rrugën për në tempullin e dijes. Por për fatin e tyre të keq në banjën e çunave është thyer një xham ...

Në mbretërinë e 10 lekëshit

Për çdo dëm që bëhet në shkollë duhet të paguajnë të gjithë për ta zhdëmtuar. Zhdëmtimi është financiar. Askush nuk kujdeset të gjejë fajtorin ose të hulumtojë pse ndodhi. Rrugë e gjatë, i bie nga Kina. Më mirë me 10 lekësha. Të gjithë pa përjashtim do paguajnë nga 10 lekë: 10 lekë për xhamin e thyer, 10 lekë për të blerë një vazo për klasën, 10 lekë për të blerë gëlqere se do lyhet palestra, 10 lekë se do blihen topa për orën e fiskulturës, 100 lekë për rojen, 10 lekë për bravën e klasës që u prish gjatë pesë minutëshit pushim dhe, së fundi, edhe 10 lekë për testimin e radhës. Nxënës me lista emërore në dorë që mbledhin e dorëzojnë te mësuesit 10 lekëshat e mbledhur: o zyyyyysh, Xheni ka paguar 100 lekëshin e rojes, por nuk ka paguar 10 lekëshin e vazos O zyyyyysh ...

Mungon zysha

Në shkollë sot mungon një mësuese. Nuk ka rëndësi se çfarë lënde jep, nuk ka rëndësi se për çfarë arsye mungon, njëlloj sikundër nuk ka rëndësi se kush e jep alarmin – vetë mësuesi i “sëmurë” apo roja i shkollës. Është rregull që të lajmërohet në një zyrë që quhet dispozicioni e cila të dërgon një mësues papunë (në pritmëni quhet në gjuhën shkencore) që zëvendëson mësuesin që mungon. Mësuesi i dispozicionit është xhongler i vërtetë. Në orën 7.15 merr lajmin se në shkollën filan mungon një mësues, për

shembull mësuesi i historisë dhe niset. Nuk ka idenë më të vogël se me çfarë klase do të bëjë mësim, sikurse nuk ka idenë më të vogël se çfarë teme do të shpjegojë. Me një siguri për t’u admiruar dhe vendosmëri për të marrë deri më një lekët për faktin se hyri në mësim dhe mbajti nxënësit brenda katër mureve, ai ‘zhvillon’ gjithë orët e mësimit të mësuesit që mungon.

Aktivitete të ndryshme

Mbledh planet edukativë të mësuesve:

Shembulli nr. 1. Shkolla është vendi i edukimit. Edukim artistik: ndeshje futbollit në klasë. Edukim mjedisor: vaditja e luleve të klasës.

Në bashkëbisedimet informale me mësuesit:

Shembulli nr. 2. Mësuesi mburret se në fund të klasës së parë nxënësit e tij dinë të recitojnë ose të thonë ndonjë gjëagjëzë.

Mbas kontrollit operativ në klasë:

Shembulli nr. 3. Një muaj pasi është bërë festa e abetares, në klasë ka akoma analfabetë.

8 vjeçarja të jep zanat

Është në klasën e tretë, më e vogël se fshesa, por është ajo që e bën pastrimin e klasës çdo ditë. E ka caktuar mësuesja. “E bën me dëshirë”, thotë mësuesja. Dhe vërtet, sa herë të shkosh mbas mësimit në klasë, ajo është aty, duke pastruar. Të qesh me shumë dashuri, të përshëndet, pastaj vrapon

të marrë kovën me ujë ose për të gjetur një fshesë të mirë. Asnjëherë nuk ka qëndruar mbas mësimit për të sqaruar diçka që nuk kuptonte nga matematika, ose për të marrë pjesë në ndonjë lodër, ose Mësuesja thotë se shteti më paguan vetëm për orët e mësimit, se gjërat kanë ndryshuar, se kemi një rivlerësim të gjendjes sonë dhe të punës për të cilën paguhemi, se ka ikur ajo kohë kur mund të punonim më shumë se ç'paguheshim ... Është tema për të cilën diskuton më me shumë kompetencë, edhe pa orar. Dhe po kaq kompetente është edhe tjetra, edhe tjetra, edhe tjetra ...
Mirupafshim nesër!

Gazeta "Shekulli" 6 maj 2004

IN MEMORIAM PROF. DR. ENVER FAJA

Libri "Urbanistika" i prof. dr. Enver Fajës që keni në dorë është vepra e fundit e profesorit, rrjedhojë e një bashkëpunimi shumë të gjatë, afro tetë vjeçar, me Shtëpinë Botuese Universitare U.F.O Press. Libri është botuar dhe ribotuar disa herë dhe gjithmonë me ndryshime: herë që lidheshin me mënyrën e formatimit dhe herë si rrjedhojë e kërkesave të vazhdueshme që kishte profesori për përditësimin e materialit me sa më shumë ide e nisma të reja nga fusha e arkitekturës dhe urbanistikës. Sot keni në dorë variantin përfundimtar të librit, ashtu sikundër e konfirmoi profesori pak kohë para se të ndahej nga jeta. Pjesë e librit është bërë edhe studimi që profesori i bashkëgjiti botimit me punimet e studentëve të arkitekturës së Albanian University "Rruga e Kavajës", një vlerësim kronologjik i evoluimit të rrugës dhe historisë së saj nga pikëpamja urbanistike.

Ne jemi shumë krenarë që kemi pasur fatin të bashkëpunojmë me prof. Fajën, arkitektin e shumë prej qyteteve kryesore që gjenden në të katër anët e

Shqipërisë dhe urbanistin që u dha jetë shumë qyteteve të reja. Në këto rrjeshta dua të sjell në vëmendje një përmasë tjetër të profesorit, profesorin-autor, në të cilën ai shfaqej në të gjithë madhështinë e tij: ideator dhe nismëtar, kërkues dhe frymëzues, kritizer dhe mbrojtës pasionant i së resë dhe progresives. Disa takime të shpejta pune, sugjerime, kërkesa, telefonata, ide për një paraqitje të re të materialit të librit dhe mënyrës së sistemimit të tij janë kontaktet e fundit që kam pasur me profesorin. Pastaj erdhi sëmundja dhe shkëputja e tij, në Francë, për t'u kuruar, dhe më pas ndarja nga kjo jetë.

Ribotimi i librit “Urbanistika” nuk është vetëm përmbushje e një misioni të nisur apo realizimi i një synimi. Profesori ka pasur një jetë të mbushur me aktivitete shumë të larmishme dhe, po aq të larmishme, kanë qenë edhe tematikat e botimeve të tij, si në librin “Kush e drejton urbanistikën shqiptare”, përmbledhje artikujsh. Por mbas një periudhe tetë vjeçare përdorimi të librit nga shumë breza arkitektësh, ideja për të vazhduar për të punuar me të njëjtin libër ishte më shumë se dëshirë e jona. Teksti është bërë pothuaj klasik, ku gjejmë vend disa nga parimet kryesore të urbanistikës. Dua të theksoj edhe historinë e shkurtër të urbanistikës me të cilën profesori hap librin. E vetmja keqardhje është vetëm se këtë punë të nisur në bashkëpunim, ta mbaronim po bashkë.

Libri “Urbanistika” i prof. dr. Enver Fajës është pjesë e trashëgimisë kombëtare në këtë fushë. Materialet e paraqitura në libër janë fryt jo vetëm i studimeve akademike të profesorit, por edhe të një përvoje jashtëzakonisht të

gjatë të tij në profesion, kombinuar me një talent dhe dëshirë gjithmonë në rritje për të dhënë më të mirën, më të bukurën, më funksionalen.

*“Urbanistika. Teknika dhe kompozimi”
Autor prof.dr. Enver Faja, f. vii. U.F.O Press,
shkurt 2012.*

FALEMINDERIT DJEMA¹

Faleminderit! Faleminderit djema të Kombëtares që na dhatë një fitore historike ndaj Kampionëve të Europës. Një ndjeshje e mrekullueshme. Një natë e paharrueshme. Nuk kishte rëndësi nga vije, nuk kishte rëndësi çfarë ishte: nëpunës, polic, student, vajzë, djalë, i ri apo i moshuar. E rëndësishme ishte që të gjithë së bashku ishim mbledhur si asnjë ditë tjetër për t'ju mbështetur ju, se si të gjithë ju do të përpiqeshit për të fituar. Dhe ju na e shpërblyet. Fituat!

Faleminderit Strakosha, Murati, Skela, Lala, Aliaj ... Faleminderit Brigel, faleminderit të gjithëve ju, çuna të rinj e plot energji që për herë të parë na bëtë të jemi më të mirët, të jemi fituesit në një garë me shtete të tjera europiane.

Faleminderit që na nxorët të gjithëve së bashku për të festuar në shesh, për të gëzuar. Për të brohoritur së bashku e jo veç e veç për këtë apo atë parti, për këtë apo atë padrejtësi. Për të brohoritur të gjithë së bashku për Shqipërinë tonë, për flamurin tonë, për vendin tonë.

¹ *Shënim:* Bëhet fjalë për ndeshjen “Shqipëri-Greqi”, 2-1, zhvilluar më 4 shtator 2004 në Tiranë, në stadiumin “Qemal Stafa”.

Faleminderit që na bëtë të këndojmë të njëjtat këngë e të kërcëjmë të njëjtat valle. Me fitoren tuaj ju patët aftësinë të krijonit një kor 5 milionësh, që këndoi në të njëjtën kohë shqip, që u gëzua e u emocionua në të njëjtin moment në Tiranë, Prishtinë, Shkup, Athinë, Londër ... në çdo cep të globit ku ka shqiptarë.

Faleminderit që për një natë na nxorët nga stresi i papunësisë apo i pasigurisë. Faleminderit që na bëtë të harronim dështimin e radhës për integrim, konferencat për shtyp e deklaratat politike, e na mbushët me dëshirën e ambicien për të thënë ‘o sa mirë me kenë shqiptar’.

Në 90’ minuata lojë ju bëtë atë që politika jonë zhbëri në pesëmbëdhjetë vjet. Falë jush, falë fitores suaj, ne u bëmë më të mirë me njëri-tjetrin, ne demonstruam dashuri e kulturë. I vetmi dëm në Tiranë, i shkaktuar nga turmat qindramijëshe të tifozëve ishte kabina e shkatërruar e një stacioni autobuzi. Sigurisht, shumë më pak se dëmi që ‘ekipet’ e politikanëve tanë shkaktojnë në seancat parlamentare kur grinden me njëri-tjetrin.

Faleminderit që bashkë me ne arritët të vishnit kuq e zi edhe politikanët, që bashkë me ne bëtë të buzëqeshin edhe udhëheqësit e shtetit dhe liderët e opozitës. Do Zoti ju mbetet kjo buzëqeshje për një kohë sa më të gjatë!

Faleminderit që na bëtë të shihnim të njëjtën ëndërr – atë të një Shqipërie të zonjë e të aftë. Ju na bëtë të besojmë. Të besojmë në një fillim të ri dhe në një vazhdim ndryshe ...

Gazeta “Shekulli”, 7 shtator 2004

ARSIMI NË QEVERISJEN E DYTË TË AHMET ZOGUT

Në periudhën e dytë të qeverisjes së A. Zogut, janar 1925-prill 1939,¹ kemi kalimin e Shqipërisë nga republikë, në monarki.² Me ardhjen përsëri në fuqi, një nga vendimet e para që merr është ajo e shkrirjes së Ministrisë së Arsimit,³ me arsyetimin e distancimit të politikës nga arsimi, por e krijon përsëri vetëm gjashtë muaj më vonë, në qershor të po atij viti, duke caktuar si Ministër të Arsimit Xhafer Ypin. Gjatë procesit të riorganizimit të shtetit dhe të kthimit të tij në monarki, krijohet një administratë e fuqishme. Sipas strukturave të reja të krijuara, në qendrën e çdo prefekturë vepronte këshilli administrativ, kryesuar nga prefekti, por që është me rëndësi të theksojmë se anëtar i këtij këshilli

¹ *Shënim:* Ahmet Zogu zgjidhet kryeministër dhe ministër i brendshëm më 2 dhjetor 1922 – kjo quhet periudha e qeverisjes së parë; dy ditë pas atentatit në parlament, më 25 Shkurt 1924, jep dorëheqjen dhe jeton për disa kohë në ilegalitet, jashtë Shqipërisë.

² *Shënim:* 1 shtator 1928

³ Omari L. et al, 2007. “*Historia e shtetit dhe e së drejtës në Shqipëri*”. Tiranë: Shtëpia Botuese “Luarasi”, f. 360.

ishte edhe përgjegjësi i arsimit për atë prefekturë, sepse na tregon për fillesat e një mirëorganizimi të sistemit arsimor shqiptar.

U arrit profilizimi i shkollës kombëtare në tërë tiparet e saj, veçanërisht mbas reformës Mosi-Ivanaj, duke tentuar drejt një shkolle laike, të njëjtë në të gjitha krahinat e Shqipërisë, me frymë përparimtare edukimi, me ndërgjegje e ideale kombëtare. Në këtë kuadër duhet të shihet edhe lëvizja për mosnjohjen dhe mospërdorimin e titujve të origjinës, si “pasha”, “bej”, “aga” etj., në letërkëmbimin zyrtar dhe brenda administratës shtetërore, caktimi i së dielës si ditë pushimi, ndalimi i përshëndetjes në mënyrë fetare, me duar e me zë apo zëvendësimi i veshjeve popullore qytetare me ato evropiane, përpjekje në emër të shkëputjes totale nga influenza osmane. Shteti laik ndoqi rrugën e shekullarizmit, do me thënë të pakësimit të ndikimit të klerit në disa sfera të jetës shoqërore, përfshirë edhe atë arsimore.

Gjatë kësaj kohe kemi edhe një rritje të numrit të shkollave në shkallë vendi. Vetëm gjatë vitit 1926-1927 funksionin 536 shkolla fillore, ishin të punësuar 830 mësues dhe numri i përgjithshëm i nxënësve kishte vajtur në 26612, që, ndonëse ishte një arritje për vendin tonë, krahasuar me numrin e popullsisë, ishte shumë i vogël. Në arsimin e mesëm kemi këto shifra: në dhjetë shkolla të mesme që ka vendi japin mësim 101 arsimtarë dhe mësojnë 1328 nxënës; shkolla me konvikte janë 6, me 25 arsimtarë dhe 574 nxënës; shkollat femërore janë më të pakëta: pjesëmarrja e vajzave në gjimnaze është në masën 10 %.⁴

⁴ Akademia e Shkencave e Shqipërisë, Instituti i Historisë, 2007. “*Histori e Shqipërisë. Rilindja Kombëtare, Rilindja Kombëtare*”, vëllimi tretë. Tiranë: Shtëpia Botuese Toena, f. 255.

Në Statutin Themeltar të Mbretërisë Shqiptare, datë 1 dhjetor 1928, shkruhej:⁵

Art. 206. Arsimi fillor për të gjithë shtetasit shqiptarë është i detyruar dhe në shkollat e Shtetit jepet falas.

Art. 207. Në përputhje me ligjet dhe brenda parimeve të programit të pranuar prej Shtetit për shkollat e veta dhe kurdoherë nën kontrollin efektiv të Qeverisë, vetëm shtetasit shqiptarë mund të hapin shkolla të ndryshme private.

Të huajt, në përputhje me ligjet, mund të lejohen vetëm për shkolla teknike e bujqësore me programe teorike dhe praktike.

Gjithashtu mund të hapen shkolla fetare dhe prej komuniteteve fetare shqiptare, shkolla fetare me lejen e Ministrisë kompetente e konform ligjeve; numri i nevojshëm i shkollave fetare të çdo komuniteti, po ashtu edhe numri i nxënësve të këtyre shkollave caktohen prej Ministrisë përkatëse me vendimin e Këshillit Ministror.

Në vitin 1930, në kabinetin qeveritar të mbretit Zog, postin e Ministrit të Arsimit e mban Hilë Mosi.⁶ Mision i detyrës së tij bëhet nevoja urgjente për reformimin e shkollës shqipe. Thelbi i reformës të ndërmarrë në këtë periudhë ishte që të gjitha shkollat të punonin me një program të miratuar nga Ministria e Arsimit, i cili do të

⁵ *Shënim:* Kryetar i Asamblesë Kushtetuese ishte z. Pandeli Evangjeli.

⁶ *Shënim:* Nën drejtimin e H. Mosit, më 16 prill 1917, iniciohet, në Shkodër, krijimi i një Biblioteke Kombëtare, e cila më 1920 shpërngulet në Tiranë, në mjediset e Ministrisë së Arsimit. Nga data 10 dhjetor 1922, shpërngulet në një nga ndërtesat më të mira të asaj kohe dhe njihet me emrin *Biblioteka Kombëtare* dhe në momentin e përirimit kishte rreth 6000 vëllime.

kishte shtrirje kombëtare, pra, i detyrueshëm për t'u zbatuar nga të gjithë. Vetëm pasi të zbatonin programin e dërguar nga Ministria e Arsimit, shkollat mund të bënin pjesë të punës së tyre edhe programe të veçanta por, edhe këto, nën mbikëqyrjen e rreptë të ministrisë. Në këtë mënyrë, synohej të kufizoheshin sa më shumë shkollat e huaja, të cilat, pas viteve '920, po lulëzonin në të gjithë vendin, veçanërisht shkollat italiane. Vdekja e parakohshme e Hilë Mosit bën që në krye të Ministrisë së Arsimit të vijë një intelektual tjetër po aq i devotshëm ndaj shkollës shqipe: Mirash Ivanaj (Ministër i Arsimit nga 1932-1935).

Ivanaj kërkon mbylljen e të gjitha shkollave private, përfshirë edhe ato fetare. Reforma me bazë përmbajtjen, e iniciuar nga Mosi dhe e pasuruar me ide të reja nga Ivanaj, miratohet më 14 shtator 1932. Tezat e kryesore të reformës së tij, Ivanaj i parashtron para Parlamentit Shqiptar. Ato përfshinin:

- shtetëzimin dhe kombëtarizimin e shkollës shqip, nëpërmjet mbylljes së të gjitha shkollave fillore e të mesme, private e të huaja, dhe kalimin e tyre në varësi të Ministrisë së Arsimit
- laicizimin e shkollës shqip
- vlerësimin e mësuesve dhe qëndrimin ndaj tyre
- krijimin e një buxheti të veçantë për arsimin
- kritere të reja në planifikimin dhe shpërndarjen e bursave të studimit

Në 11 prill 1933, u ndryshuan disa artikuj të Statutit Themeltar të Mbretërisë Shqiptare; u shtetëzuan shkollat e huaja dhe u vendos një program unik. Në fund të prillit

1933, parlamenti miraton reformën "Ivanaj". Në dekretin e miratuar nga Parlamenti, u ndalohej shtetasve shqiptarë të frekuentonin shkollat e huaja dhe prindërve të dërgonin fëmijët në këto shkolla, të cilët, në rast të kundërt, do të gjobiteshin ose mund të shkonin edhe në burg.⁷ Ministri kalon në një masë ekstreme: kalimin e të gjitha shkollave të mesme profesionale të disa qyteteve kryesore të vendit, si në Shkodër, Berat, Gjirokastrë, Tiranë dhe Korçë, nën varësinë e Ministrisë së Arsimit.

Shkollat publike shiheshin si e vetmja vatër e formimit të njëtrajtshëm kombëtar të brezave. Në vitin shkollor 1933-1934, filloi njësimi i arsimit shqiptar, në të gjitha kategoritë e shkollave. Arsimi i detyrueshëm u vu mbi baza ligjore me dekret-ligjin e vitit 1934. Nga kjo reformë arsimore u mbyllën 85 shkolla të kategorive të ndryshme; ndryshime u bënë dhe në arsimin e mesëm. U mbyll shkolla profesionale italiane në Berat dhe u krijuan shkollat qytetëse 4-vjeçare, me program teorik dhe praktik, sipas nevojave të prefekturës.

Një vendim i tillë ngjalli shumë pakënaqësi, brenda e jashtë vendit. Zëdhënës të kësaj pakënaqësie bëhen edhe At Gjergj Fishta dhe, veçanërisht, minoriteti grek, pasi reforma mbyll dhjetë shkolla private greke që subvencionoheshin nga qeveria greke.⁸ Këta të fundit e çojnë çështjen në Gjykatën e Hagës, e cila në prill të vitit 1935, shprehhet në favor të palës greke. Vendimi shoqërohet me dorëheqjen e Ivanaj dhe rihapjen e shkollave në zonën e minoriteteve.

⁷ Puto, A., 2009. "Shqipëria politike, 1912-1939". Tiranë: Shtëpia Botuese Toena, f. 500.

⁸ Puto, A., 2009. "Shqipëria politike, 1912-1939". Tiranë: Shtëpia Botuese Toena, f. 503.

Për shkak të rrethanave të krijuara, reforma kufizohet në botimin e rregullores “Për shkollat private të minoriteteve” ku, ndërmjet të tjerave, lejohet marrja në punë e mësuesve nga minoriteti, por me aprovimin e Ministrisë së Arsimit. Më tej akoma, arrihet që mësuesit e këtyre shkollave të ishin nënsh tetas shqiptarë, që njihnin shqipen dhe që kishin mbaruar normalen; lëndët do të jepeshin në gjuhën e minoritetit, por me programe e libra të miratuara nga Ministria e Arsimit; shkollat do të mbaheshin me shpenzimet e popullsisë vendase, por kontrolli administrativ dhe i cilësisë së mësimit do të udhëhiqej nga ministria.

Më 1938, gjendja e arsimit të mesëm, në shkallë vendi, ishte si vijon: 3 gjimnaze, një lice, Shkolla Normale, Instituti Tregtar dhe disa shkolla qytetëse, me një total prej 11 shkollash të mesme.⁹ Në një konkluzion të përgjithshëm, mund të flasim për sistem arsimor shqiptar pothuaj të konsoliduar në nivel të ulët dhe në hapat e parë në atë të mesëm.

“Copëza nga historiku u arsimit. Në disa rrethe të vendit.” Përpiluar nga Valbona Nathanaili. Tetor 2012, Albanian University Press.

⁹ O. Shefik. 2008. “Fjalor i pedagogjisë”. Tiranë: Shtëpia Botuese “8 Nëntori”, f. 42.